RAPORT AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I	**PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	1
II.	**HYRJA**	2
	a. Objektivat dhe qëllimi	3
	b. Identifikimi i çështjes	3
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	3
	d. Përgjegjësitë e audituesve	3
	e. Kriteret e vlerësimit	3
	f. Standardet e auditimit	3
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	4
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	6
1	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	8
2	Auditimi mbi planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik	9
3	Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi	10
4	Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, Bank (shpenzimet administrative, blerjet e vogla, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).	28
5	Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.	31
6	Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.	40
7	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit	48
8	Zbatimi i standarteve shtetërore për ujin e pijshëm dhe atë te ndotur.	53
V.	**KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT**	90

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.a. Përshkrimi i shkurtër i projektit.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti -Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat janë materiale dhe të përhapura, në **dëm të mundshëm ekonomik në vlerën 8,183,337 lekë,** dhe efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike **në vlerën 205,216,066 lekë.**

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH", në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 1016/1 prot., datë 13.12.2019, nga data 23.12.2019 deri më datë 21.02.2020, në Shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë për periudhën nga data 01.01.2018 deri më datë 31.12.2019, u krye auditimi "Përputhshmërisë" me përbërje:

1. J.ZH,Audituese e parë/ Përgjegjës grupi,
2. G.K, Auditues i lartë
3. A.L, Auditues i lartë
4. S.H, Auditues i parë
5. M.B, Audituese e parë

a. Titulli: Raport Përfundimtar mbi auditimin e "Përputhshmërisë" në Shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë.

b. Marrësi: Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë, me Administrator A.C.

c.Objektivat dhe qëllimi: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH, është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar përputhshmërinë (pajtueshmërisë) dhe rregullshmërinë e transaksioneve, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë se Institucionit. Auditimi ka për qëllim ***promovimin e transparencës,*** duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore. Gjithashtu, raporti i auditimit ka për qëllim ***promovimin e përgjegjshmërisë,*** ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korrigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi i përputhshmërisë (pajtueshmërisë) dhe rregullshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë *(sipas ISSAI 400, p 18).*

d. Identifikimi i çështjes: Shoqëria duhet të ketë organizimin e duhur, për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiençë dhe efektivitet.

e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:
Shoqëria brenda caqeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion tregtar dhe financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e Shoqërive të reja, si edhe pjesëmarrjen në kapitalin e Shoqërive të tjera jashtë vendit.
Në zbatim të dispozitave ligjore, U.K.K.sh.a. merr masa për:
-Krijimin e kushteve të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës së punonjësve të Shoqërisë.
-Zbatimin e rregullave Higjeno – Shëndetësore në punë.
-Zbatimin e rregullave të sigurimit teknik për mbarëvajtjen në punë.
-Zbatimin e rregullave për mbrojtjen nga zjarri.
-Zbatimin e dispozitave të vendosura në Kontratën Kolektive të Punës.

f. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

g. Kriteret e vlerësimit: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" , i ndryshuar; Ligji nr. 8901, datë 23.05.20012 "Për falimentin", i ndryshuar; Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura" i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës, i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar"; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për Sponsorizimet", i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 "Për arkivat"; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore", i ndryshuar", Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë" ; Ligji 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar; Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 "Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë", i ndryshuar"; VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 "Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UK"; VKM nr. 236, datë 10.5.1993 "Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar", i ndryshuar; VKM nr. 63, 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura", me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 510, datë 10.05.2015 "Për miratimin e

procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit" i ndryshuar; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit"; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 "Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit", i ndryshuar; VKM nr. 781, datë 14.11.2007, ndryshuar; VKM nr. 864, datë 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë"; etj; Metodika mbi vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotur, miratuar me vendim të ERRU nr. 32, datë 21.12.2009; Kontrata e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 04.02.2011 "Për miratimin e modelit të kontratës tip"; Udhëzimi i Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit nr. 3, datë 28.07.2004 "Për administrimin e ujit të pijshëm"; Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"; Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit"; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar; akti i themelimit; statuti dhe rregullorja e brendshme e shoqërisë.

h. Standardet e auditimit:
-ISSAI100– (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*).
-ISSAI400– (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*).
-Kodi etik i KLSH.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;VKM nr. 63, 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura", me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 510, datë 10.05.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial".
-Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas Ligjit nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", është:
-Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;
-Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;
-Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;
-Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;
-Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre;
-Shoqëria duhet të realizojë çdolloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;
-Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, liçensat sipas legjislacionit në fuqi;

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria dhe rregullshmëria e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga 01.01.2018 deri më datë 31.12.2019.
Qëllimi i auditimit është hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të Shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë.
Është audituar aktiviteti i shoqërisë për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar shpenzime për investime, shpenzimet operative, shpërblimet dhe pagat, programimi ekonomik dhe realizimi i tij, zbatimi i standarteve të ujit të pijshëm dhe atij të ndotur, etj. Është audituar vendimarrja e organeve drejtuese, si dhe menaxhimi financiar dhe kontrolli.
Reforma në Sektorin UK e iniciuar në janar 2016, sipas VKM nr. 63, datë 27.01.2016 për riorganizimin e sektorit në përputhje me ndarjen e re administrative territoriale sipas parimit 1 bashki - 1 shoqëri, UK Kavajë ka përfunduar këtë proces. Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Kavaje" Sh.a kryen veprimtarinë me objekt prodhimin, grumbullimin, përpunimin, shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura. Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Kavaje" Sh.a ofron shërbimin e furnizimit me ujë te pijshëm në qytetin e Kavajës dhe në ish komunat, Golem, Helmës, Luz i Vogël, Synej, ndërsa për shërbimin e largimit te ujërave të ndotura nëpërmjet sistemit të kanalizimeve për qytetin e Kavajës dhe zonën Golem Plazh, Qytezë Golem, Mali i Robit Plazh, Synej.
Prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm është me ngritje mekanike, burimet janë ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Uji prodhohet nga, stacioni i pompimit Çermë, stacioni i pompimit Harizaj, si dhe impianti i përpunimit të ujit të pijshëm Maskuria. Stacioni i pompimit të Çermës furnizon depon kryesore që shërben për qytetin e Kavajës dhe depon e Maskurisë gjatë sezonit turistik ku kërkesat për ujë të pijshëm janë të mëdha. Stacioni e Pompimit Harizaj furnizon me ujë të pijshëm depot që shërbejnë për zonën rurale. Furnizimit me ujë kryhet nëpërmjet sistemit kryesore me gjatësi 61.1 km me material çeliku dhe ai i shpërndarjes 110 km me material gize e 59.4 km me material polietileni (plastik).
Për vitin 2018 numri i lidhjeve të raportuara grupit të auditimit është, në total 25,949 nga këto 7911 me matësa 18038 pa matësa, norma e matjes 30%.
Sasinë e ujit nga vëllimi total i ujit të prodhuar që shoqëria nuk arrin t'ja faturojë klientëve quhet "Ujë Pa të Ardhura", ku pjesa kryesore e tyre përbehet nga humbjet administrative (të dukshme) dhe humbjet reale (teknike). Për vitin 2018, sipas të dhënave të raportuara në AKUK, është prodhuar 7,304,300 m^3 dhe është faturuar 3,378,500 m^3, pra humbjet teknike dhe administrative (menaxheriale), "uji pa te ardhura", janë në masën 53.8%. Norma e Arkëtimit është një nga treguesit e performancës së shoqërive, sepse lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj, për vitin 2018 është faturuar ujë i pijshëm në vlerën 155,130 mijë lekë (pa tarifat fikse) dhe është arkëtuar në vlerën 26,124 mijë lekë, pra norma e arkëtimit për ujin e pijshëm është në masën 17%. Në këtë përllogaritje është e përfshirë edhe shitja me shumicë që kryet ndaj shoqërive të tjera.
Për vitin 2019 numri i lidhjeve të raportuara grupit të auditimit është, në total 26,156 nga këto 8121 me matësa dhe 18035 pa matësa, norma e matjes 31%.
Për vitin 2019, sipas të dhënave të raportuara në AKUK, është prodhuar 7,720,700 m^3 dhe është faturuar 3,068,000 m^3, pra humbjet teknike dhe administrative (menaxheriale), "uji pa te ardhura", janë në masën 60%. Norma e Arkëtimit është një nga treguesit e performancës së shoqërive, sepse lidhet direkt me qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë dhe me aftësinë paguese të saj, për vitin 2019 është faturuar ujë i pijshëm në vlerën 112,019 mijë lekë (pa tarifat fikse) dhe është arkëtuar në vlerën 14,163 mijë lekë, pra norma e arkëtimit për ujin e

pijshëm është në masën 13%. Në këtë përllogaritje është e përfshire edhe shitja me shumicë që kryet ndaj shoqërive të tjera.
Shoqëria e "Ujësjellës Kanalizime Kavajë" Sh.a. kryen shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për qytetin e Kavajës dhe zonën e plazhit Golem. Largimi i ujërave të ndotura nga qyteti i Kavajës bëhet me vetërrjedhje dhe për zonën Golem me ngritje mekanike pa presion, për tu trajtuar në ITUP. Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) në Kavajë, është i pari impiant i këtij lloji i ndërtuar në Shqipëri pas viteve 90, ka filluar të funksionojë që nga Tetori i vitit 2005. Vendndodhja e ITUN është në fshatin Qerret, në një distancë 0,6 km larg bregut të detit dhe afërsisht 6 km larg nga qendra e qytetit të Kavajës. Sistemi që shërben për largimin e ujërave të ndotura ka një gjatësi prej 41 km nga këto, 14 km prej material betoni dhe 27 km prej material polietileni.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.
Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti i Auditimit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

I. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

1.Titulli i gjetjes: Mos funksionimin në nivelin e kërkuar të organeve drejtuese/Asambleja e Aksionareve
Situata: Asambleja e Aksionarëve, në rastet që është mbledhur, ka analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë por në opinionin e grupit të auditimit vlerësohet se problematikat e diskutuara nuk janë nxjerrë konkluzione mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë për ta orientuar drejt në zgjidhjen e problematikave, nëpërmjet përshpejtimit të reformave të sektorit siç parashtrohet në VKM nr. 63, 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura".
Kriteri : VKM nr. 63, 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura", me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".
Ndikimi/efekti: Mos funksionimi i duhur i Asamblesë së Aksionarëve.
Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet i riorganizimit të shoqërisë mbi bazën Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë.
Rëndësia: I Lartë
Rekomandimi:

-Asambleja e Aksionarëve, gjatë veprimtarisë së saj të marrë masa për të analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë funksionale të saj.

2.Titulli i gjetjes: Mos funksionimi në nivelin e kërkuar të organeve drejtuese/ Këshilli i Administrimit

Situata: Referuar mbledhjeve të Këshillit të Administrimit për vitin 2018, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk ka një regjistër që të dokumentojë se sa herë është mbledhur Këshilli i Administrimit për periudhën objekt auditimi, por duke u bazuar në vendimet e marra nga Këshilli i Administrimit për vitin 2018, ky Këshill është mbledhur 3 herë referuar 2 vendimeve dhe 1 projektvendimi që ka marrë për këtë vit,veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Këshillin e Administrimit dhe Administratorin e Shoqërisë UKKA SHA Kavajë, për periudhën objekt auditimi.

- Anëtarët e Këshillit të Administrimit me shoqërinë UK Kavajë SHA, nuk kanë lidhur kontratë pune me shoqërinë UK Kavajë SHA me terma të performancës;

-Referuar plotësimit të kuadrit rregullator të Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, për vitin 2018 u konstatua se UKKA SHA Kavajë, nuk ka një statut të miratuar.

-Këshilli i Administrimit, nuk ka monitoruar, shqyrtuar dhe miratuar veprimtarinë organizative dhe funksionale të UKKA SHA Kavajë dhe vendimet e drejtimit të shoqërisë nga Administratori i UKKA SHA Kavajë për periudhën objekt auditimi;

-Është konstatuar se UK Kavajë SHA, nuk ka një strukturë të miratuar dhe të unifikuar sipas nivelit të pagave dhe numër të miratuar punonjësish në UKKA SHA Kavajë, por referuar vendimit nr.768/4, datë 02.08.2017 i Këshillit të Administrimit të UKKA SHA Kavajë, konstatohet se është miratuar struktura organizative e shoqërisë me 152 punonjës, ndërkohë që nga auditimi analitik i strukturës aktuale të shoqërisë UKKA SHA Kavajë rezultojnë të punësuar 305 punonjës;

-Këshilli i Administrimit nuk ka shqyrtuar dhe nuk ka miratuar programe ekonomike për vitet 2018-2019 për shoqërinë UKKA SHA Kavajë;

-Këshilli i Administrimit ka miratuar me vonesë pasqyrat financiare për vitin 2017-2018.

Përsa më sipër për parregullsitë e konstatuara në kundërshtim me VKM nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura",ngarkohet me përgjegjësi Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë UKKA SHA Kavajë, për periudhën objekt auditimi.

Kriteri : VKM nr. 63, 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura", me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 510, datë 10.05.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial"

Ndikimi/efekti: Mos funksionimi i duhur i Këshillit të Administrimit

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet i riorganizimit të shoqërisë mbi bazën Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore, në Republikën e Shqipërisë.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi:

-Këshilli i Administrimit të marrë masa për shmangjen e praktikave me mangësi të trajtuara sa më sipër me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë funksionale të shoqërisë.

-Nga Këshilli i Administrimit të merren masa për të hartuar kontratën e punës me Administratorin e Shoqërisë.
-Këshilli i Administrimit të marrë masa për monitorimin dhe shqyrtimin e vendimeve të Administratorit të UKKA Kavajë SHA, për të plotësuar kuadrin rregullator të shoqërisë duke miratuar statutin e saj, përditësimin e rregullores së brendshme, programet ekonomike, planin e biznesit të shoqërise në funksion të mbarëvajtjes dhe funksionimit të aktivitetit të UKKA SHA Kavajë.

3.Titulli i gjetjes: *Keqinterpretimi dhe mosnjohja e bazës ligjore, tek përpilimi i urdhrave të Administratorit të UKKA SHA Kavajë*
Situata : Për periudhën objekt auditimi Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA kanë ushtruar detyrën 3 Administratorë, dhe gjatë periudhës 2018-2019 janë nxjerrë rreth 300 urdhra me karakter organizativ, disiplinor, urdhra për procedura prokurimi, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së UK Kavajë SHA etj.
Nga auditimi është konstatuar se baza ligjore e përdorur për nxjerrjen e këtyre urdhrave nuk gjen mbështetje në aktet administrative që rregullojnë veprimtarinë e Ujësjellësit, sepse UK Kavajë SHA e kryen veprimtarinë pa pasur një statut të miratuar, një rregullore të brendshme jo të përditësuar.Urdhrat nuk kanë siglimet e duhura që e bëjnë aktin administrativ të rregullt nga ana e procedurës administrative (përshkrimi i sektorit që koncepton urdhrin dhe miratimi i tij).
Janë konstatuar në shumë raste paradhënie të një page apo dy pagash punonjësve pa arsye të mbështetur në ligj dhe pa relacione shpjeguese për punonjësin përfitues, gjithashtu janë konstatuar raste të dhënieve të urdhrave për pushime nga puna që nuk evidentojnë afatet dhe hapat administrative deri në marrjen e masave disiplinore për largimet nga puna.Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi Administratorin e UKKA SHA Kavajë për periudhën objekt auditimi.
Kriteri : Kodi i Procedurave Administrative,Rregullorja e Brendshme e UKKA SHA Kavajë
Ndikimi/efekti: Mosnjohja me legjislacionin dhe procedurat administrative e sektorit ligjor pranë UKKA SHA Kavajë
Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet i procedurave administrative dhe perpilimi i akteve administrative jo sipas kritereve dhe dispozitave ligjore.
Rëndësia: I Lartë
Rekomandimi: Administratori i UKKA SHA Kavajë përpara nxjerrjes së urdhrave, të marrë masa për të garantuar vlefshmërinë e akteve administrative që nxjerr, duke u njohur me kuadrin rregullator të UKKA SHA Kavajë dhe procedurat administrative (përshkrimi i sektorit që koncepton urdhrin dhe miratimi i tij)
Përsa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.1, datë 21.02.2020

II. Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik.

1. Titulli i Gjetjes: Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë, nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata, si edhe nuk ka hartuar plan 5-vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plan të biznesit, nevoja për të ardhura dhe analiza e tarifave/strategjitë e çmimeve në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës – Kanalizime.
Situata: Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë , nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me objektivat e caktuar nga organet drejtuese të saj. Shoqëria nuk ka hartuar plan 5-vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plan të biznesit, në kuadër të

Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës – Kanalizime përcaktuar në Udhëzuesin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, ku të përcaktohen: Deklarata e vizionit dhe misionit, përmbledhje për drejtuesit e lartë, qëllimet strategjike, analiza dhe parashikimi për menaxhimin e kërkesës për ujë, struktura organizative dhe personeli, programi për përmirësimin e performancës, programi pesëvjeçar për investimet kapitale, buxheti 5-vjeçar për operacionet mirëmbajtjen, nevoja për të ardhura dhe analiza e tarifave/strategjitë e çmimeve.

Kriteri: - VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" neni 13, pika 3 (germa ë), neni 18, pika 7 (germa ç, dh dhe i), dhe nenin 20, pika 2 c, ç, dhe d) të

- Rregullorja e brendshme e Ujesjellësit Kavajë sh. A, te miratuar nga asambleja e pronarëve: *pjeset - "Miratimi i Programit te Zhvillimit"*

Ligji nr. 25 dt. 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" Nenin 17 i (Raporti i ecurisë së veprimtarisë), pikat 1, 2

- Strategjia Kombëtare Sektoriale e Shërbimive të Furnizimit me Ujës dhe Kanalizimeve, 2011 - 2017.

Ndikimi/Efekti: Kjo ka sjellë mungesë të programeve dhe të objektivave afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë, mungesë të vizionit, qëllimeve strategjike, analizave për menaxhimin e kërkesës për ujë, programit për përmirësimin e performancës, si dhe për investimet kapitale, duke vazhduar të punojë me humbje të theksuara nga viti në vit.

Shkaku: Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mosimplementimit të Udhëzuesit për Reformën Kombëtare në Sektorin Ujësjellës – Kanalizime.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli Adminsitrativ të Shoqërisë të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planeve afatmesme e afatgjatë, të planit 5-vjeçar për përmirësimin e performancës dhe planit të biznesit, në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës – Kanalizime.

2. Titulli i Gjetjes: UK sh.a. Kavajë, nga kërkesat e përsëritura me shkrim (të shoqëruara me tabelat perkatese të zërave të buxhetit), nuk vuri në dispozicion të grupit të auditimit planin dhe miratimin e buxhetit për shoqërinë për vitet 2018 dhe 2019 dhe as raportimet dhe analizat e zhvilluara në Këshillin Administrativ sipas periudhave, për rrjedhojë nuk ka miratuar planin ekonomik për vitin 2018 dhe vitin 2019.

Situata: UK sh.a. Kavajë, nuk ka miratuar program ekonomik për vitin 2018 dhe vitin 2019 në kundërshtim me VKM nr.63, datë 27.01.2016 dhe rregulloren e brendshme UK Kavajë SHA.Megjithëse nga Drejtoria Tregtare e shoqërisë nuk janë paraqitur projekt buxhetet të planifikuara dhe të miratuara për vitet 2018 dhe 2019, grupi i auditimit është shprehur mbi shpenzimet dhe ardhurat faktike sipas të dhënave të programit të kontabilitetit të shoqërisë,nga ku është konstatuar se shpenzimet sipas zërave të buxhetit të mbartura në programin e kontabilitetit sipas funksionit , nuk janë të njëjta me shpenzimet sipas natyrës,të cilat gjithashtu rezultojnë të mbartura në kontabilitet. Pra konstatohet se njëjti fakt është i ndryshëm në bilancin e shoqërisë dhe në zërat e shpenzimeve sipas buxhetit, për rrjedhojë mosplanifikimi i programit ekonomik ka sjellë tejkalime dhe mosrealizime në zëra të ndryshme të buxhetit të shoqërisë për vitin 2018 dhe 2019.

Kriteri: Neni 13, pika 4, nenin 18, pika 7 dhe nenin 20, pika 2 c) të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërite tregtare" , ndryshuar

Ndikimi/Efekti: Kjo ka bërë që UK sh.a. Kavajë të punojë pa efektivitet dhe ekonomi, pa objektiva vjetorë si në realizimin e të ardhurave ashtu edhe në uljen e shpenzimeve, vjeljen e detyrimeve të papaguara, në relizimin e investimeve, etj. për këto dy vite.

Shkaku: Situata e sipërcituar ka ndodhur si pasojë e performancës së dobët menaxhuese, moszbatimit të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", etj..

Rëndësia: E lartë.

2.1Rekomandimi: Administratori, Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme) të marrin masa për hartimin dhe miratimin në kohë të programit ekonomiko-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, si dhe të marri masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

2.2Rekomandimi: Drejtoria Tregtare të marrë masa në vazhdimësi që raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar, të jenë të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, duke analizuar të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko-ekonomik të shoqërisë; duke raportuar çdo muaj për ecurinë e shoqërisë pranë Këshillit të Administrimit dhe çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme.

Trajtuar më hollësisht tek aktkonstatimi nr.2, datë 21.02.2020

III. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

1. Gjetja: Miratimi i paqartë i strukturës organizative

Situata: Në vitin 2017 me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 768/4 prot., datë 02.08.2017 është miratuar struktura me 152 punonjës, vendim i cili ka qenë në fuqi edhe gjatë vitit 2018-2019, nuk ka listë me pozicione pune dhe emrat bashkëngjitur pozicionit përkatës. Në zbatim të këtij vendimi janë shkurtuar nga puna 79 punonjës të UKKa Sh.a.

Nga auditimi u konstatua se në organogramën e miratuar nga Këshilli i Administrimit është edhe *Auditi i Brendshëm*, por në UKKa nuk ka funksionuar kjo strukturë. *(Organograma e miratuar bashkangjitur në aneks).*

Gjithashtu nga auditimi u konstatua dhe mungesa e specifikimit të numrit të punonjësve për çdo pozicion dhe për çdo sektor duke krijuar konfuzion në mënyrën e mirëfunksionimit të strukturës administrative dhe ndarjes së punës me eficiencë sipas pozicioneve përkatëse.

Kriteri: Sa më sipër është në kundërshtim me pikën c, nenin 18, VKM nr.63, datë 27.1.2016 dhe Statutit të UKKa Sh.a ku citohet: *Administratori harton strukturën e organizimit dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit. Struktura e organizimit të shoqërisë duhet të ketë patjetër një drejtori/departament teknik dhe një drejtori/departament tregtar, drejtuesit e të cilave zgjidhen nga administratori (Drejtori i Përgjithshëm) sipas neneve 19 dhe 20, të këtij statuti.*

Ndikimi/Efekti: Pozicionimi i paqartë krijon diskriminim mes punonjësve për pozicione të ngjashme pune dhe rrit kostot e pagave të shoqërisë

Shkaku: Hartim i pasaktë, i paqartë i rregullores së funksionimit të institucionit

Rëndësia: E lartë

Rekomandime: Të hartohet struktura dhe organigrama e shoqërisë duke specifikuar numrin total të miraturar në strukturë, numrin e punonjësve për çdo degë dhe sektor, pozicionin specifik të çdo punonjësi shoqëruar me organigramën e shoqërisë.
Për veprimet dhe mosveprimet mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.Ddhe Administratori i Shoqërisë z.B.T.

2. Gjetja: Mbi mos/zbatimin e Rregullores së Brendshme
Situata: Rregullorja e brendshme për UKKa Sh.a është miratuar në vitin 2017 dhe gjatë kësaj kohe nuk është përshtatur me ndryshimet në strukturën organizative dhe Statutin e ndryshuar të shoqërisë duke mos ndihmuar në mirëfunksionimin e brendshëm të saj. Nga auditimi rezulton se, në rregulloren e brendshme nuk është përcaktuar lloji i arsimimit për të gjitha pozicionet e punës si dhe nuk janë të përcaktuar qartë përshkrimi i punës për çdo pozicion, duke bërë të vështirë identifikimin e detyrave dhe të drejtave që ka çdo punonjës i shoqërisë. Janë përcaktuar vetëm funksionet apo detyrat e disa pozicioneve dhe jo përshkrimi i punës për çdo pozicion. Gjithashtu, në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar kriteret për procedurat e marrjes në punë, konkurrimin dhe vlerësimin e kandidatëve. Rregullorja e brendshme vazhdon të jetë e njëjta sipas organizimit të mëparshëm të shoqërisë. Nga ana e strukturave drejtuese nuk është marrë asnjë masë për përshtatjen apo hartimin e një rregulloreje të re sipas organizimit të ri në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 *"Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".*

Kriteri: Në kundërshtim me gërma c, pika 2, neni 18 të VKM nr. 63 datë 27.1.2016, *"Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".*ku citohet: "*Administratori...harton dhe rregulloren e brendshme të veprimtarisë së shoqërisë e cila miratohet nga Këshilli i Administrimit".*

Ndikimi/Efekti: Rregullorja e pasaktë/paqartë krijon konfuzion për të drejtat dhe detyrat e punonojësve duke influencuar indirekt mbi mirëfunskionimin e shoqërisë ose duke shtuar kostot operacionale të shoqërisë
Shkaku: Hartim i pasaktë, i paqartë i rregullores së funskionimit të institucionit
Rëndësia: E mesme
Rekomandime: Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore, Këshillli Mbikqyrës dhe Titullari të marrin masa për hartimin e rregullores së re të brendshme të shoqërisë ku të specifikohen qartë detyrat dhe të drejtat për çdo pozicion pune, nivelin arsimor të kërkuar për përmbushjen efiçente të këtyre detyrave si dhe të bëhet vazhdimisht përshtatja e rregullores me ri-organizimin e shoqërisë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.D dhe Ish Administratori i Shoqërisë z.B.T

3. Gjetja: Mbi rekrutimin e punonjësve sipas kritereve të pa përcaktuara.
Situata: Në rregulloren e brendshme të UKKa SH.A nuk ka kritere për mënyrën e rekrutimit të stafit, gjithashtu nga procedurat e ndjekura nuk ka gjurmë për shpalljen e vendeve vakante dhe intervistimin ose testimin e kandidatëve, deri në përzgjedhjen e tyre. Përzgjedhja e punonjësve nuk është kryer si rezultat i një procedure rekrutimi të ndjekur, as të kritereve të pozicionit, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë etj. Çdo rekrutim i punonjësve gjatë periudhës objekt auditimi është kryer me urdhër të administratorit të

shoqërisë dhe asnjë kriter tjetër. Kjo situatë ka ardhur dhe si pasojë e një rregullorje të pa plotë për funksionimin e shoqërisë.

Kriteri: Në kundërshtim me pikën l), neni 18, VKM nr.63 datë 27.1.2016, *"Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"*.Statuti i Shoqërisë: "*Drejton veprimtarinë e shoqërisë, zgjedh dhe mbikëqyr personelin e saj, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e shoqërisë dhe rregullat e miratuara nga Këshilli i Administrimit.*
- Kontrata individuale e punës".

Ndikimi/Efekti: Rregullorja e pasaktë/paqartë krijon konfuzion për përzgjedhjen e duhur të punonjësve të rinj dhe për mirëfunskionimin e shoqërisë duke shtuar indirekt kostot operacionale të shoqërisë

Shkaku: Rekrutimi i punonjësve pa kritere të mirëpërcaktuara

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Të hartohen rregulla dhe procedura specifike ku të specifikohen qartë kriteret e punësimit për çdo pozicion pune lidhur me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë apo trajnimet profesionale të nevojshmë për përmbushjen efikase të detyrave për çdo pozicion pune, duke rritur transparencën e mënyrës së punësimit dhe rekturimit në bazë të meritokracisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.D dhe Ish Administratori i Shoqërisë z.B.T

4. Gjetja: Mbi keq organizimin dhe mbajtjen e dosjeve të personelit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se në rregulloren e brendshme, në kontratat individuale dhe në mungesë të kontratave kolektive nuk specifikohet përmbajtja e dosjes së personelit. Mbi auditimin me zgjedhje të 41 dosjeve të personelit (administrate) grupi i auditimit është mbështetur në listën e dokumentave e kontratave të viteve para periudhës objekt auditimi si dhe në eksperiencat e ngjashme nga ku u konstatua se:

Duke u bazuar në VKM Nr.63 "*Për organizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*.", datë 27.01.2016, neni 18, pika b nga auditimi i dosjes së administratorit konstatohet se z.B.T, i emëruar si Administrator i Ujësjellës Kanalizime Kavajë Sh.a në datën 20.02.2018, nuk është pajisur akoma, me çertifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotur.

Në asnjë nga kontratat individuale nuk specifikohej paga dhe elementet përbërës të saj. Në disa raste mungonte CV e punonjësit, diplomat universitare në pjesën më të madhe të dosjeve ishin të panoterizuara, në disa raste mungonte libreza e punës, mungonte fleta e inventarizimit dhe libreza e sigurimeve shoqërore në të gjitha dosjet. Gjithashtu u evidentuan raste të dosjeve vetëm me kontratën e personit të punësuar dhe asnjë dokumentacion tjetër.

Kriteri:
- Dokument identiteti;
- Kërkesën e Punëmarrësit të shoqëruar me CV;
- Dëftesën ose diplomën të noterizuar;
- Librezën e punës;
- Librezën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- Raport mjekësor për aftësimin në punë;

- Fletë pune të lëshuar nga Zyra e Punës;
- Adresën e vendbanimit dhe;
- Dokumente të tjerë sipas specifikës së vendit të punës.
- Inventarizimi i dosjes

Mbështur në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës ku, *Sektori i Personelit dhe Burimeve Njerëzore, mban dosjet e personelit dhe të dhënat e të gjithë të punësuarve në Shoqëri. Sektori i Burimeve Njerëzore duhet të zhvillojë mundësitë për trajnim, për të siguruar programe të vazhdueshme, të përshtatshme për të kënaqur nevojat e gjithsecilit për sa i përket planifikimit të karrierës.*

Lidhur me hartimin e kontratave individuale, janë në kundërshtim Kodin e Punës, me ndryshime neni 21 "Forma e kontratës së Punës", pika 3, germa h, ku cilësohet: "*Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos elementët përbërës të pagës*"

Ndikimi/Efekti: Mungesa e kontratës së punës, kontrata e punës pa pagë dhe pozicion të përcaktuar lë hapësirë për abuzime me lëvizjet e punonjësve në pozicione punë për të cilën ata nuk janë të arsimuar ose të profesionalizuar. Gjithashtu mungesa e dokumenteve shoqëruese në dosje lë hapësirë për rëktutimin e punonjësve më të kaluar kriminale, duke rritur në këtë mënyrë kostot operative të shoqërisë.

Shkaku: Dosjet e pasakta të punonjësve

Rëndësia: E mesme

Rekomandime: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa të plotësojë të gjitha dosjet e punonjësve dhe sidomos kontrata e punës ku të specifikohet qartë pozicioni i punës në përputhje me nivelin arsimor dhe professional të çdo punonjësi si dhe paga bruto për periudhën e punësimit. Në çdo kohë, në dosjen e punonjësit duhet të figurojnë kopje të të gjithë urdhrave të transferimit në pozicione pune të tjera brenda shoqërisë, për të rritur transparencën në afrimin e pozicioneve të punës me formimin përkatës.**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Ish Përgjegjës z. K.M i Burimeve Njerëzore , e z.B.K, Përgjegjës i Burimeve Njerëzore.

5. Gjetja: Procese gjyqësore, Largime nga puna të pajustifikuara

Situata: Për periudhën objekt auditimi, konstatohet një numër I madh procedura gjyqësore e sekuestro konservative bankare të UKKA, si debitore ndaj OSSHE, Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, Komisionerit për të drejtën e informimit, ERRU dhe punonjësve të larguar nga puna. Gjatë kësaj periudhe, janë larguar nga puna 210 punonjës (*duke përfshirë 79 punonjës së ristrukturimit të datë 02.08.2017)*. Në UKKa nuk ka një dokumentacion të rregullt për numrin e saktë të procedurave gjyqësore për procedurat e zhvilluar/përfunduara dhe procedurat në proces (vlerën monetare të likujduar për secilën procedurë). Vendime e formës së prerë në proceset gjygjësore përgjatë vitit 2018 -2019 për të cilat kërkohet dëmshpërblim kanë **vlerë totale 10,892,567 lekë e cila përbënë efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë.** Për punonjësit është dhënë masa pushim nga puna si pasojë e thyerjes së disiplinës në punë, për mosparaqitje dhe shpërdorim detyre.

Për vitin 2019 nga ana e UKK Sh.a Administratorit të saj janë kryer pushime kolektive nga puna në periudhën Shtator – Dhjetor 2019 ku janë larguar në total 96 veta dhe përkatësisht 21 në Shtator, 27 në Tetor, 22 në Nëntor dhe 26 në Dhjetor. Gjithashtu në vitin 2017 në periudhën Shtator-Nëntor 2017 janë larguar 81 veta nga puna.

Nga verifikimi i procedurave për largim nga puna u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e parashikuara nga Kodi i Punës.

Kriteri: Sa më sipër mbështetur në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Kodi i Punës i*

Republikës së Shqipërisë" pika 3, neni 155 Zgjidhja e menjëhershme e pajustifikuar e kontratës së punës nga punëdhënësi: *Në rastet e zgjidhjes së menjëhershme, të pajustifikuar, të kontratës së punës nga punëdhënësi, gjykata, me kërkesë të punëmarrësit dhe duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos dëmshpërblimin, deri në një vit pagë, që i shtohet pagës që ai duhet të marrë gjatë afatit të njoftimit. Për punëmarrësit në administratën publike, kur ka një vendim të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë këtë vendim.*

Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 148 të ligjit 7961 datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"*i ndryshuar duke mos respektuar pikën 1 të këtij neni i cili citon: *Punëdhënësi, që nuk respekton procedurën e pushimit kolektiv nga puna, të parashikuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, detyrohet t'i japë punëmarrësit një dëmshpërblim deri në gjashtë muaj page, dëmshpërblim i cili i shtohet pagës gjatë afatit të njoftimit ose dëmshpërblimit që merret në rast mosrespektimi të këtij afati, të parashikuar në nenin 143, të ligjit të sipërcituar.*

Veprimet janë gjithashtu në kundërshtim me Neni 27 - Përgjegjësia e punëmarrësit

1. Punëmarrësi përgjigjet ndaj punëdhënësit për dëmin që i shkakton kur shkel detyrimet kontraktuale me dashje ose nga pakujdesia.

2. Shkalla e kujdesit, që duhet të tregojë punëmarrësi në punë, varet nga njohuritë teknike, të nevojshme për të kryer punën e caktuar, duke pasur parasysh aftësitë dhe cilësitë e punëmarrësit, që punëdhënësi i njihte ose duhet t'i kishte njohur. Dëmi, që lidhet në mënyrë të qenësishme me kryerjen e punës, përballohet nga punëdhënësi.

3. Dëmi përfshin dëmin real dhe fitimin e munguar.

4. Gjykata mund të shkarkojë plotësisht ose pjesërisht punëmarrësin nga detyrimi për shpërblimin e dëmit kur:

-punëmarrësi ka vepruar me pakujdesi të lehtë;

-punëdhënësi, në organizimin dhe kontrollin e punës, bën të njëjtin gabim që lidhet me shkaktimin e dëmit;

-detyrimi për të zhdëmtuar plotësisht dëmin s'është i përballueshëm duke pasur parasysh burimet e të ardhurave të punëmarrësit.

Shënim: ***Listat e sakta proceseve gjyqësore të përfunduara/likujduar*** *(vlera monetare e përfituar nga paditësi + tarifën e përmbaruesit e shpenzimet gjyqësore)* ***proceset gjyqësore në procese (****që janë në zhvillim****), të paraqiten hollësisht nga UKKa (****Drejtori Tregtar, P/Financë e D/Ligjore)*** ***së bashku me observacionet përkatëse të Projektraporti***.

Ndikimi: Largimet e pajustifikuara nga puna ndikojnë në rritjen e kostove operative të shoqërisë

Shkaku: Largime nga puna duke shkelur klauzolat e Kodit të Punës dhe kontratave individuale të punës.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për shqyrtimin e **efektit financiar** në vlerën totale **10,892,567 lekë**, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin

e punonjësve nga puna, për evidentimin e përgjegjësive, si dhe nga Sektori Juridik të merren masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit për shmangien e kostove shtese nga proceset gjyqësore në proces të cilat mbartin risk të lartë për efekt negative financiar në të ardhmen.

Shoqëria duhet të marrë masa të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Procedura që zbatohet në largimet nga puna është ajo që përfshin informimin, konsultimin e organizatës së punëmarrësve, dhe në mungesë të saj të vetë punëmarrësve, si kolektiv, por edhe si tërësi individësh të mëvetësishëm, si dhe besimin e ndërmjetësimit te autoriteti publik qendror (Ministria e linjës).

Hapi i parë. Njoftimi paraprak drejtuar organizatës së punëmarrësve (dhe në rast mos-organizimi, njoftimi publik për punëmarrësit) shënon fillimin e procedurës ligjore në rast pushimesh kolektive. Njoftimi nuk duhet të jetë sipërfaqësor, por duhet të trajtojë posaçërisht katër aspekte të kërkuar nga paragrafi i dytë i dispozitës së nenit 148:

- arsyet e pushimit nga puna;
- numrin e punëmarrësve që do të pushohen;
- numrin e punëmarrësve të punësuar normalisht; si dhe
- kohën gjatë së cilës është parashikuar të kryhen këto pushime.

Një kopje e njoftimit i dërgohet edhe Ministrisë së linjës.

Hapi i dytë. Për një periudhë jo më pak se 30 ditë nga njoftimi i sipërpërmendur, mbahen këshillime midis punëdhënësit dhe organizatës së punëmarrësve, dhe në mungesë të saj, punëmarrësve drejtpërdrejt. Synimi i tyre është arritja e një marrëveshjeje, duke parapëlqyer masat për shmangien ose pakësimin e pushimeve kolektive nga puna, dhe në pamundësi për të zbutur pasojat e tyre. Një procedurë e rregullt kërkon që këshillimet jo vetëm të fillojnë, por edhe të zhvillohen intensivisht brenda afatit 30 ditor.

Hapi i tretë. Përfundimi i këshillimeve i njoftohet Ministrisë së linjës, si edhe palës me të cilën është kryer këshillimi (organizatës së punëmarrësve, dhe në mungesë, shpallet ose u njoftohet punëmarrësve të prekur). Në rast mosarritjeje të marrëveshjes midis palëve, Ministria e linjës ndërmjetëson midis tyre për të arritur një marrëveshje. Në këtë rast afati i ndërmjetësimit rregullohet në mënyrë të njëjtë si afati i këshillimit brenda ndërmarrjes, treguar në hapin e dytë të sipërpërmendur. Me gjithë aktivizimin e saj të dobishëm, nuk është në tagrin e Ministrisë së linjës të ushtrojë autoritet për të ndaluar pushimet kolektive.

Hapi i katërt.Në rast se ndërmjetësimi nuk sjell shmangien e pushimeve kolektive, punëdhënësi u njofton punëmarrësve që do të pushohen, zgjidhjen e kontratës. Në këtë rast mbeten të zbatueshme dispozitat ligjore që parashikojnë kriteret dhe afatet (duke përfshirë afatin e njoftimit) për zgjidhjen individuale të kontratës së punës, me përjashtim të nenit 144 (procedura e zgjidhjes).

Sanksioni ligjor. Sanksioni ligjor procedural për punëdhënësin që nuk përmbush në një masë minimale të caktuar nga gjykata, procedurën e treguar në katër hapat e sipërpërmendur, është dëmshpërblim për punëmarrësin deri në gjashtë muaj pagë, i cili i shtohet pagës gjatë afatit të njoftimit ose dëmshpërblimit që merret në rast mosrespektimi të këtij afati, sipas nenit 143.

Përparësia në ripunësim. Pas zbatimit të pushimeve kolektive, në rast se punëdhënësi do të synojë marrjen në punë të personelit të ri, detyrohet nga ligji t'u japë përparësi në punësim ish- punëmarrësve të pushuar më parë në mënyrë kolektive, me kusht që për vendet e reja të punës të kërkohet kualifikim i krahasueshëm dhe që pushimet të kenë qenë mirëfilli kolektive (pra të mos kenë qenë kryer për arsye të lidhura me punëmarrësit).

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.D dhe Ish Administratori i Shoqërisë z.B.T; ish/Drejtori Tregtar, F.Gj, ish/Drejtori Tregtar z.M.M e Drejtori Tregtar F.T; ish P/Financave znj.F.T e P/Financave z.M.M; ish D/Ligjore znj.R. K e D/Juridik znj.E.S

6.Gjetja: Mbi punësimet mbi strukturë.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave për periudhën objekt auditimi 2018-2019 u konstatua një tejkalim i strukturës së shoqërisë nga ajo e miratuar me vendim të Këshillit Administrativ ***deri në 150 punonjës mbi strukturë (gjatë muajve muajve; tetor, nëntor, dhjetor, 2019*** numri total i punonjësve ka aritur mbi 315 punonjës nga 152 punonjës që ka në strukturë e miratuar) duke i shkaktuar shoqërisë për vitet 2018-2019 një **dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi në paga në shumën 79,388,728 lekë** dhe për efekt zinxhir në sigurime shoqërore vlera e efektiti negativ financiar është **10,414,628 leke** dhe e TAP prej **3,180,845 lekë.**

Kriteri:
-Struktura e miratuar nga Këshilli i Administrimit i UKKa SH.A
Pika "b" e Nenit 134, neni 154 "Të drejtat dhe detyrimet" ligj nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"
-Statuti Tip i Shoqërisë së UKKa SH.A, në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.1.2016, *"Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"*.
- Rregullorja e Brendshme e UKKa Sh.a
- Kontratat e punës

Ndikimi: Punësimet mbi strukturë ndikojnë në rritjen e kostove operative të shoqërisë
Shkaku: Punësime mbi strukturë duke shkelur strukturën e miratuar të shoqërisë.
Rëndësia: E lartë.
Rekomandime: Shoqëria duhet të marrë masa për shqyrtimin e **dëmit ekonomik pa mundësi arkëtimi në paga në shumën** në vlerën totale **92,984,201 lekë**, të ardhur si pasojë e punësimeve mbi strukturë, për evidentimin e përgjegjësive, për shmangien e kostove të cilat mbartin risk të lartë për efekt negativ financiar në të ardhmen pasi shoqëria figuron me humbje që prej vitit 2015.

Viti 2018	Nr mbi strukture sipas borderos	Nr në Strukturë	Nr në sistemin tatimor	Nr mbi strukturë sipas sistemit tatimor	Nr mbi strukturë referencë KLSH
Janar	89	152	231	79	79
Shkurt	84	152	229	77	77
Mars	72	152	225	73	72
Prill	72	152	227	75	72
Maj	78	152	236	84	78
Qershor	81	152	234	82	81
Korrik	81	152	240	88	81
Gusht	89	152	242	90	89
Shtator	85	152	243	91	85
Tetor	87	152	245	93	87
Nëntor	88	152	244	92	88
Dhjetor	96	152	247	95	95
					984

Viti 2019	Nr mbi strukture sipas borderos	Nr në Strukturë	Nr në sistemin tatimor	Nr mbi strukture sipas sistemit tatimor	Nr mbi strukturë reference KLSH
Janar	99	152	254	102	99
Shkurt	100	152	255	103	100
Mars	103	152	256	104	103
Prill	104	152	259	107	104
Maj	106	152	261	109	106
Qershor	107	152	263	111	107
Korrik	107	152	264	112	107
Gusht	102	152	268	116	102
Shtator	112	152	275	123	112
Tetor	164	152	287	135	135
Nëntor	158	152	295	143	143
Dhjetor	164	152	292	140	140
					1358

Grupi i auditimit ka marrë në analizë numrin më të vogël të punonjësve mbi strukturë midis diferencës që del nga borderot dhe diferencës që del nga sistemi tatimor sipas tabelës më poshtë. Në analizë nuk janë marrë punonjës të cilët kanë punuar gjatë periudhës më pak se 22 ditë pune.

Për 32 pozicionet e miratuara në strukturë është marrë në konsideratë paga mesatare gjatë vitit 2018 dhe gjatë vitit 2019 ku asnjë pagë nuk është nën pagën minimale dhe është llogaritur dëmi ekonomik për pozicionet mbi strukturë.

Në bazë të numrit mbi strukturë dhe duke marrë parasysh se nuk ka punonjës sezonalë janë llogaritur dëmet e mëposhtme:

Për vitin 2018 **efekti negativ financiar** i pagave mbi strukturë është **33,260,184 lekë**

Për vitin 2019 **efekti negativ financiar** i pagave mbi strukturë është **46,128,544 lekë.**

Si pasojë e marrjes në punë të përsonave mbi strukturë janë paguar gjithashtu më tepër sigurime shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatim mbi të ardhurat personale.

Vlera e sigurimeve shoqërore paguar tepër në total prej **10,414,628 leke** dhe e TAP prej **3,180,845 lekë** për vitet 2018-2019 përbën **efekt negativ financiar.**

Viti 2018	Nr mbi strukturë KLSH	Paga Neto mesatare	Paga bruto	Ndalesa 11.2%	Tatimi
		33.801	**39.594**	**4.435**	**1.358**
Janar	79	2.670.279	3.127.926	350.365	107.282
Shkurt	77	2.602.677	3.048.738	341.495	104.566
Mars	72	2.433.672	2.850.768	319.320	97.776
Prill	72	2.433.672	2.850.768	319.320	97.776
Maj	78	2.636.478	3.088.332	345.930	105.924
Qershor	81	2.737.881	3.207.114	359.235	109.998
Korrik	81	2.737.881	3.207.114	359.235	109.998
Gusht	89	3.008.289	3.523.866	394.715	120.862
Shtator	85	2.873.085	3.365.490	376.975	115.430
Tetor	87	2.940.687	3.444.678	385.845	118.146
Nëntor	88	2.974.488	3.484.272	390.280	119.504

Dhjetor	95	3.211.095	3.761.430	421.325	129.010
		33.260.184	38.960.496	**4.364.040**	**1.336.272**
Viti 2019	**Nr mbi strukturë e KLSH**	**Paga Neto mesatare**	**Paga bruto**	**Ndalesa 11.2%**	**Tatimi**
		33.968	**39.781**	**4.456**	**1.358**
Janar	99	3.362.832	3.938.356	441.096	134.472
Shkurt	100	3.396.800	3.978.138	445.551	135.830
Mars	103	3.498.704	4.097.482	458.918	139.905
Prill	104	3.532.672	4.137.263	463.373	141.263
Maj	106	3.600.608	4.216.826	472.284	143.980
Qershor	107	3.634.576	4.256.607	476.740	145.338
Korrik	107	3.634.576	4.256.607	476.740	145.338
Gusht	102	3.464.736	4.057.700	454.462	138.547
Shtator	112	3.804.416	4.455.514	499.018	152.130
Tetor	135	4.585.680	5.370.486	601.494	183.371
Nëntor	143	4.857.424	5.688.737	637.139	194.237
Dhjetor	140	4.755.520	5.569.393	623.772	190.162
		46.128.544	54.023.107	**6.050.588**	**1.844.573**

Në kushtet e një shoqërie e cila ka një rezultat financiar me humbje prej vitit 2015 deri më 2019, këto punësime mbi strukturë rëndojnë edhe më tepër buxhetin e shoqërisë.

Numri i punonjësve

	Punonjës të përhershëm		**Punonjës me kontratë**		**Punonjës të përhershëm**		**Punonjës me kontratë**	
	Viti 2018		**Viti 2018**		**Viti 2019**		**Viti 2019**	
UKKA Sh.a	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**	**Plan**	**Fakt**
Janar-Dhjetor	ska	ska	ska	100	ska	ska	ska	220

Burimi : Ujësjellës Kanalizime Sh.a Kavajë

Vetëm buxheti i pagave neto i shpenzuar për shoqërinë në vitin 2018, është në shifrën 99,705,923 lekë dhe 33% e tij është **efekt negativ financiar**. Si efekt zinxhir gjithashtu janë rritur shpenzimet për sigurime shoqërore me 27% dhe shpenzimet për TAP me 40%.

Viti	**Humbja fiskale**	**Humbja e akumuluar**
2015	-820.688	
2016	-9.378.538	
2017	-14.177.714	
2018	-8.968.840	-204.203.458

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Këshilli i Administrimit; z. D.H e z.H.C; Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.D dhe Ish Administratori i Shoqërisë z.B.T.

6. Gjetja: Ligjshmëria dhe pa rregullshmëria për përcaktimin e nivelit të pagave

Situata: Nga auditimi i strukturës së shoqërisë rezulton se kjo strukturë është tejkaluar çdo muaj gjatë viteve 2018 dhe 2019.

Janë marrë në analizë borderot e çdo muaji bashkë me numrin e punonjësve të cilët janë të deklaruar në sistemin tatimor, që kanë punuar 22 ditë pune dhe për të cilët paguhen kontribute mujore. Me vendim nr.15/2 datë 20.12.2017 Këshilli i Administrimit miratoi vetëm nivelin e pagave të personelit të menaxhimit administrativ dhe përgjegjësit e sektorëve të degëve të shoqërisë por jo për të gjithë punonjësit e shoqërisë. Në këtë mënyrë i lë hapësirë të lirë titullarit që të vendosi për nivelin e pagave të punonjësve ku, për pozicion të njëjta ka nivele të ndryshme page duke treguar sjellje preferenciale për njerin apo tjetrin punonjës dhe pa ia kaluar për kompetencë organeve kolegiale siç parashikon ligji.

Kriteri: në kundërshtim me nenin 2, pika ç, *"Organet Kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore, shoqërive aksionere dhe të institucioneve të tjera publike" dhe nenin 6, pika 1, ligji nr.10405, datë 24.03.2011 për Kompetencat e organeve kolegjiale, "Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë: a)nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës.*

Ndikimi: Diskriminim i punonjësve

Shkaku: Përcaktime të niveleve të pagave pa pasur kompetencë ligore

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Përcaktimi i nivelit të pagave të kryhet sipas legjislacionit në fuqi nga Këshilli Mbkiqyrës i shoqërisë dhe në çdo kohë pozicione pune të ngjashmë duhet të kenë pagë të njëjtë. Diferencimi mund të kryhet në përformancën e secilit punonjës, në çdo rast e dokumentuar më rezultate konkrete në punë dhe jo vetëm me vendim të titullarit duke favorizuar një punonjës dhe duke diskriminuar një tjetër.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.D dhe Ish Administratori i Shoqërisë z.B.T

7. Gjetja: Mbi mos respektimin e nivelit të pagave dhe diskriminimin në punë.

Situata: Niveli referues i pagave është vendosur me vendim të Këshillit Mbikqyrës pika 3 datë 10.02.2017 dhe për punonjësit me pagë minimale ka ndryshuar referenca në vitet 2018-2019 sipas ndryshimit të legjislacionit në fuqi.

Këshilli i Administrimit ka marrë vendimin nr. 3005/9 datë 19.11.2018 për ndryshimin e pagave për 9 punonjës ku 7 prej tyre paguhen më shumë se pozicionet e ngjashme të miratuara në strukturë. Në këtë mënyrë, favorizimi i këtyre 7 punonjësve ka rritur kostot e pagave në **397,656 lekë** për periudhën Dhjetor 2018-Janar 2020.

Nga auditimi i listëpagesave rezulton se ekziston mospërputhje midis emërimit në kontratë pune dhe emërimit të pozicionit në bordero. Meqënëse struktura nuk është e mirëpërcaktuar disa nivele pagash përgjegjës sektori paguhen si kryetar departamenti. Ka gjithashtu nivele të ndryshme pagash për të njëjtat pozicione. Kjo situatë nxit diskriminimin në punë.

Kriteri: Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kodin e Punës, Neni 115, "Barazia në shpërblim" (Ndryshuar me Ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) *1. Punëdhënësi paguan punëmarrësit në mënyrë të barabartë, për punë të njëjtë ose punë me vlerë të barabartë, pa diskriminuar për ndonjë nga shkaqet e përmendura në pikën 2, të nenit 9, të këtij Kodi. 2. Ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë, sipas nenit 9, të këtij Kodi, në lidhje me të gjitha aspektet dhe kushtet e shpërblimit për punë të njëjtë ose për punë me vlerë të barabartë. Pagë e barabartë, pa diskriminim, është paga, e cila: a) për të njëjtën punë të*

normuar, llogaritet në bazë të së njëjtës njësi matjeje; b) për punë të matur me kohë, është e njëjtë për të njëjtin pozicion pune.

Ndikimi: Diskriminim i punonjësve dhe rritja e kostove operative
Shkaku: Përcaktime të niveleve të pagave sipas preferencës së titullrit
Rëndësia: E mesme.
Rekomandime: Nga Këshilli Administrimit dhe Titullari i UKKa, të merren masa për miratimin e nivelit të pagave, në zbatim të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve". Përcaktimi i nivelit të pagave të kryhet sipas legjislacionit në fuqi nga Këshilli Administrimit i shoqërisë dhe në çdo kohë pozicione pune të ngjashmë duhet të kenë pagë të njëjtë. Diferencimi mund të kryhet në përformancën e secilit punonjës, në çdo rast e dokumentuar më rezultate konkrete në punë dhe jo vetëm me vendim të titullarit duke favorizuar një punonjës dhe duke diskriminuar një tjetër.

Nr	**Emër Mbiemër**	**Emërtesa sipas strukturës**	**Niveli referues i pagave të KM paga neto**	**Vendim nr. 3005/9 KM datë 19.11.2018 paga neto**	**Paga bruto**	Diferenca mujore paga neto	Diferenca Dhjetor 2018-Janar 2020
1	B.X	Përgj.Zyre Finance	48.000	55.004	67.420	7.004	98.056
2	Y.H	Inspektor	30.000	30.000	34.433	0	0
3	G. H	Pompist	25.308	30.000	34.433	4.692	65.688
4	F.H	Elektropompist	25.308	30.000	34.433	4.692	65.688
5	H.K	Inspektor	30.000	30.000	34.433	0	0
6	L.D	Spec.Mardh Publikun	30.000	33.004	38.391	3.004	42.056
7	I.L	Brigadier	30.000	33.004	38.391	3.004	42.056
8	P.S	Brigadier zonë rurale	30.000	33.004	38.391	3.004	42.056
9	S.A	Brigadier	30.000	33.004	38.391	3.004	42.056
TOTALI							**397.656**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.D dhe Ish Administratori i Shoqërisë z.B.T

8. Mbi gjobat dhe kamatvonesat në sistemin tatimor dhe gjobat e kamatvonesat mbi detyrimet e papaguara të energjisë elektrike

Situata: Nga auditimi i sistemit tatimor deri në Shkurt 2020, rezultojnë gjoba dhe kamatvonesa **në vlerën 8,637,236 lekë** si gjobë për pagesa të vonuara, nga të cilat 8,305,094 lekë janë gjoba për mospagesa të TVSH në kohë reale, 270,850 lekë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, 40,000 lekë për tatim fitimin dhe 21,292 lekë për tatimin në burim vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar**. Shoqëria nuk është në gjendje të paguajë detyrimet për TVSH, penaliteti i së cilës rritet çdo ditë.

Shoqëria nuk është në gjendje të paguajë faturat e energjisë elektrike me detyrim principal 173,708,004 lekë dhe gjoba e kamatvonesa në shumën **83,671,514 lekë**, të cilat gjithashtu përbëjnë **efekt negativ financiar.**

Aktualisht interesat e regjistruara në sistemin tatimor janë në shifrën **3,787,461 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar** ndër të cilat 3,719,389 janë interesat vetëm për

mospagimin në kohë të detyrimit për TVSH dhe 68,072 lekë interesa për pagesa të vonuara të sigurimeve shoqërore dhe tatimit në burim.
Shoqëria nga mungesa e likuiditetit dhe keq menaxhimi aktualisht ka **gjoba dhe kamatvonesa në shumën totale 96,096,211 lekë.**

Kriteri: Penalitetet e mësipërme llogariten sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Sanksionet, Neni 114 Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit Gjoba llogaritet në 0,06% të detyrimit të papaguar shumëzuar me nurmin e ditëve vonesë por jo më shumë se 365 ditë.
Kamatëvonesa për mospagimin e detyrimeve tatimore brenda afateve te përcaktuara, është 120 për qind e shkallës së interesit ndërbankar të Bankës së Shqipërisë e cila shpallet nga kjo e fundit për çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të një tremujori më parë shumëzuar me vlerën e detyrimit dhe numrin e ditëve.

Ndikimi: Mos kryrje eficente e veprimtarisë
Shkaku: Mungesa e likuiditeteve
Rëndësia: E lartë.
Rekomandime: Shoqëria të marrë masa dhe të kryejë në mënyrë më efiçente menaxhimin e veprimtarisë së përditshme si dhe të shqyrtojë efektin negativ nga gjobat dhe kamatvonesat në shumën **96,096,211 lekë.** Shoqëria të ulë numrin e punonjësve mbi strukturë, të punësojë punonjës të kualifikuar dhe të menaxhojë me efektivitet asetet për rritjen e rentabilitetin të shoqërisë.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.D dhe Administratori i Shoqërisë z.B.T.

Në lidhje me pikën 9 të Akt Konstatimit nr.3 është dërguar obsevacioni i datës 26.02.2020 (e-maili ne brendshëm i KLSH) i nënshkruar nga; z. F.Q dhe z.M.R. Obserbacioni është lexuar nga grupi i auditimit të KLSH dhe është reflektuar në Projektraport.

9. Mbi dhënien e shpërblimeve

Situata: Shoqëria edhe pse figuron me humbje gjatë vitit 2018 dhe 2019, përveç se ka punësuar persona mbi strukturë duke i shkaktuar dëme të mëtejshme shoqërisë gjithashtu ka shpërndarë edhe shpërblime për punonjës të saj.
Të gjitha shpërblimet të cilat janë për pushime të pamarra ose me rastin e daljes në pension janë në përputhje me Kodin e Punës.
Shpërblimet për vitin 2018 kanë vlerë **efekti negativ financiar 130,000 lekë** kurse për vitin 2019 kanë vlerë **efekti negativ financiar 806,088 lekë.**
Në rast se shoqëria figuron me humbje nuk shpërndan shpërblim. Gjithashtu nuk ka shpërblim për punë jashtë orarit, siç është shpërblyer E.L. Puna jashtë orarit paguhet sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe pasqyrohet në pagën mujore të personit i cili ka punuar jashtë orari, në referencë të listëprezencës mujore.

Kriteri: Çdo shpërblim tjetër i cili nuk jepet për arsyet e sipërpërmendura përbën efekt negativ financiar pasi është në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", Neni 2, Kompetencat për caktimin e pagës i cili citon Në Republikën e Shqipërisë kanë kompetencë për caktimin e pagës, sipas përkatësisë: ç) organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të ndërmarrjeve shtetërore, shoqërive aksionare dhe të institucioneve të tjera publike;

Neni 6 Kompetencat e organeve kolegjiale 1. Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave**,** në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës; b) ***masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor***, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.

Ndikimi: Rritje e kostove të shoqërisë

Shkaku: Shpërndarjë shpërblimi në kushtet e një shoqërie e cila figuron me humbje që prej vitit 2015

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Këshilli i Administrimit dhe Titullari i shoqërisë UKK Sh.a, të marrin masa që të rishqyrtojnë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitet 2018 dhe 2019 në vlerën **936,088 lekë**, shpërblime të dhëna pas daljes së rezultatit financiar vjetor negativ, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për vlerën e mësipërme, e cila përbën **efekt financiar negativ** për Buxhetin e shoqërisë dhe ka rënduar edhe më tëpër kostot e shoqërisë në kushtet që ajo figuron me humbje prej vitit 2015.

Shpërblime 2018

Nr	Emër Mbiemër	Nr Prot.	Motivacioni i shpërblimit	Dt. Ekzekutimit	Vlera
1	L.G	2709	performancë e mirë në punë		20.000
2	A.H	2709	performancë e mirë në punë		20.000
3	H.R	2709	performancë e mirë në punë		20.000
4	R.K	938	rezultate të mira në punë		55.000
5	N.C	516	rezultate të mira në punë		15.000
Totali					**130.000**

Shpërblime 2019

Nr	Emër Mbiemër	Nr. Vendimit për shpërblim	Motivacioni	Dt. Ekzekutimit	Vlera
1	F.Gj	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
2	R.K	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
3	E.Gj	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
4	E.S	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
5	E.S	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
6	L.L	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000

7	B.X	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
8	A.H	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
9	J.Gj	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
10	Xh.I	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
11	R.D	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
12	F.B	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
13	L.G	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
14	N.XH	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
15	A.M	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
16	E.G	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
17	Mirela Hovi	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
18	Greta Gega	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
19	L.P	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
20	H.R	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
21	E.I	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
22	M.K	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
23	D.LL	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
24	S.B	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
25	L.SH	19	me rastin e festës të 8-Marsit	07.03.2019	3.000
26	E.T	43	për punë të mirë	18.07.2019	55.000
27	B.X	43	për punë të mirë	18.07.2019	55.000
28	G.XH	45	për punë të mirë	25.07.2019	65.000
29	J.K	48	për punë të mirë	01.08.2019	48.000
30	F.Gj	50	për punë të mirë	29.07.2019	55.000
31	A.H	50	për punë të mirë	29.07.2019	35.000
32	E.S	50	për punë të mirë	29.07.2019	33.000
33	L.L	50	për punë të mirë	29.07.2019	40.000

34	A.M	50	për punë të mirë	29.07.2019	30.000
35	H.T	51	për punë të mirë	30.07.2019	87.000
36	B.D	51	për punë të mirë	30.07.2019	55.000
37	J.Gj	52	për punë të mirë	30.07.2019	55.000
38	B.Q	90	për perfor. të lartë në punë	22.10.2019	35.000
39	B.K	73	për punë të mirë	06.09.2019	30.000
40	E.L	81	për punë jashtë orarit sez.veror	30.09.2019	30.000
41	S.A	113	për performancë të lartë në punë gjatë punimeve Golem	10.12.2019	23.088
Totali					**806.088**

Të dhëna përmbledhëse për përdorimin e fondit të veçantë për vitin 2018 dhe vitin 2019 në mijë lekë

Nr	**Emërtimi**	**Viti 2018**		**Viti 2019**	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	Fondi i veçantë	ska	ska	ska	ska
2	Shpërblime për rezultate në punë	ska	130	ska	731
3	Shpërblime për fund viti/8mars	ska	ska	ska	75
4	Shpërblime sëmundje	ska	ska	ska	ska
5	Për largime nga puna	ska	126	ska	455
6	Për raste fatkeqësie/lindjeje	ska	30	ska	40
7	Për dalje në pension	ska	168	ska	124

Burimi : Ujësjellës Kanalizime Sh.a Kavajë

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.D dhe Administratori i Shoqërisë z.B.T.

10. Diferencat pozitive dhe negative në paga

Situata: Janë audituar pagat e 25 punonjësve të administratës për periudhën Prill 2018-Dhjetor 2018 dhe janë vënë re diferenca në aplikimin dhe pagesën e pagave.

Ekziston mospërputhje midis emërimit në kontratë pune dhe emërimit të pozicionit në bordero.

Meqënëse struktura nuk është e mirëpërcaktuar disa nivele pagash përgjegjës sektori paguhen si kryetar departamenti. Ka gjithashtu nivele të ndryshme pagash për të njëjtat pozicione.

Ka pozicione të cilat paguhen më shumë ose më pak se sa niveli i miratuar në strukturë.

Nuk ka unifikim të emërtimeve në sistemin tatimor për pozicione pune të ngjashme dhe ka diferenca në caktimin e pagave për të njëjtat pozicione pune.

Diferencat pozitive tregojnë se janë paguar më shumë se sa pozicioni i tyre aktual i punës ndërsa diferencat negative tregojnë që janë paguar më pak ose që mbajnë një pozicion tjetër pune në krahasim me atë që shënohet në kontratë pune apo në bordero.

Kriteri:

-Struktura e miratuar nga Këshilli i Administrimit i UKKa SH.A me Vendimin nr. 768/4 prot., datë 02.08.2017.

-Niveli i pagave të miratuar nga Këshilli i Administrimit me Vendimin nr. 97/5, datë 10.02.2017.

-Kontratat e punës

Ndikimi: Rritje e kostove të shoqërisë, diskrimin për pozicione të ngjashme pune

Shkaku: Përcaktim i paqrtë i pozicionit të punës, pozicionit në strukturë ose nivelit referues të pagave

Rëndësia: E mesme.

Rekomandime: Nga Departamenti i Financës të merren masa që të ri-strukturohet mënyra e përllogaritjes së pagave për çdo të punësuar duke rritur transparencën në afrimin e informacionit përkatës për të gjithë komponentët e pagës, sipas legjislacionit në fuqi, pozicionit të punës sipas emërimit përkatës të gjithsecilit në kontratën e punës dhe përcaktimin e pagës bruto sipas arsimimit përkatës të gjithsecilit dhe pozicionit në strukturë

-Të merren masa që të bëhet përditësimi i regjistrit të punonjësve si dhe librezave të punës me lëvizjet përkatëse dhe periudhat përkatëse për çdo të punësuar si edhe plotësimi i dosjeve për çdo të punësuar sipas inventarit të dosjes.

	Emër Mbiemër	**Emërtesa sipas strukturës në bordero**	**Niveli referue KM paga neto**	**VKM datë 19.11.2018**	**Pozicioni Kontrate pune**	**Niveli refer.**	**Bordero Prill 2018**	**Bordero Maj 2018**
1	F.Gj	Drejtori Tregtare	65.000		Dr. Tregt.	65.000	65.000	65.000
2	K.M	Pergj.Administrat	55.000		P/B. Njerez	55.000	60.047	60.047
3	R.K	Përgj.Zy. Juridike	43.000		**Pergj.Sek.**	43.000	55.004	55.004
4	B.X	P.Zyre Finance	48.000	55.004	P. Finance	48.000	48.016	48.016
5	M.M	Spec.Finance	43.000				**35.000**	35.000
6	D.XH	Spec.Finance	43.000		S. Finance	43.000	**40.001**	40.001
7	A.H	Spec.Deg. Teknik	40.000				35.001	35.001
8	XH.A	P/Zyrës Teknike	43.000		**Përgj. Sek**		48.016	48.016
9	L.G	Sp.Degës Teknike	40.000				40.001	40.001
10	E.G	Arkëtare	35.000		Ark Qytet	35.000	44.735	44.735
11	E.S	S. Mar. Publikun	30.000	33.004			30.000	30.000
12	L.P	Regjist.ankesash	30.000				30.000	30.000
13	N.C	Magazinier	30.000				35.001	35.001
14	I.G	Dispecer	25.308				26.716	26.716
15	E.Q	Dispecer	25.308				26.716	26.716
16	I.K	Dispecer	25.308				26.716	26.716
17	B.I	Sanitare	22.000				24.001	24.001
18	L.B	Sanitare	22.000				24.001	24.001
19	S.K	Dispecer	25.308				26.716	26.716
20	E.T	Përgj/ Deg Shitje	43.000		**K D.shitjes**	55.004	55.004	55.004
21	N.T	**Magazinier**	30.000				35.000	35.000
22	G.T	P/M/ Publikun	43.000		Pergj/M/P	43.000	37.816	37.816

23	Xh.I	P?Shitjesh	43.000				43.001	43.001

Përgjegjësi i degës së shitjes E.T është Përgjegjës Sektori dhe jo Përgjegjës Departamenti sepse Dega e Shitjes përfshihet brenda Drejtorisë Tregtare dhe në strukturë ekziston një Drejtor Tregtar.

Përgjegjësi i Zyrës Juridike R.K është Përgjegjës Sektori dhe jo Përgjegjës Departamenti sepse zyra juridike përfshihet brenda departamentit të adminsitratës.

Po kështu D.XH dhe M.M janë të dy specialist finance dhe paguhen me paga të ndryshme. Kjo situatë nxit diskriminimin dhe është në kundërshtim me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë.

Ka transferime të shumta sidomos gjatë vitit 2019 dhe ndryshime të shpeshta të pozicioneve të punës.

Nr	**Emër Mbiemër**	**Emërtesa sipas strukturës**	**Niveli referues KM paga neto**	**Diferenca Prill-Dhjetor 2018**
1	F.Gj	Drejtori Tregtare	65.000	-12.777
2	K.M	Pergj.Administrate	55.000	-43.757
3	R.K	Pergj.Zyre Juridike	43.000	108.039
4	E.Gj	Juriste	40.000	-1.637
5	B.X	Pergj.Zyre Finance	48.000	-3.890
6	M.M	Spec.Finance	43.000	-63.639
7	D.XH	Spec.Finance	43.000	-46.996
8	A.H	Spec.Deges Teknike	40.000	-44.993
9	XH.A	Pergj/Zyres Teknike	43.000	45.140
10	L.G	Spec.Deges Teknike	40.000	-1.638
11	E.G	Arketare	35.000	48.455
12	E.S	Spec.Mardh Publikun	30.000	0
13	L.P	Regjist.ankesash	30.000	-1.185
14	N.C	Magazinier	30.000	45.007
15	I.G	Dispecer	25.308	12.670
16	E.Q	Dispecer	25.308	12.670
17	I.K	Dispecer	25.308	12.670
18	B.I	Sanitare	22.000	5.940
19	L.B	Sanitare	22.000	16.917
20	S.K	Dispecer	25.308	12.670
21	E.T	Pergj/ Dega Shitjes	43.000	93.038

22	N.T	Magazinier	30.000	45.000
23	G.T	Pergj/Mardh me publikun	43.000	-46.656
24	Xh.I	Pergjegjese Shitjesh	43.000	-1.772

Struktura e miratuar me Vendimin nr. 97/5, datë 10.02.2017, nga Këshilli i Administrimit: Z.A.H(Kryetar) znj. M.K(nënkryetar) është:
Administrata (32) – Drejtoria Teknike, Dega e shitjes(10), Task Force (15) –Drejtoria Teknike, Sektori Elektromekanik (20), Sektori Qytetit (Mirëmbajtje) (16)- Sektori KUN (12), Sektori Qytet (Dispeceri) (23), IPUN Qerret (16), Sektori Golem (16), Sektori Manskuri ((9), Sektori Fshat (4) Zona Lekaj (20) , Zona Synej (15), Zona Helmas (12). Në total 221 punonjës. Është miratuar edhe struktuar e pagave, e cila paraqitet në mënyrë të hollësishme në aneksin e këtij aktkonstatimi.
Po në vitin 2017 me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 768/4 prot., datë 02.08.2017 për miratimin e strukturës me 152 punonjës, vendim i cili ka qenë në fuqi edhe gjatë vitit 2018-2019.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.Ddhe Administratori i Shoqërisë z.B.T.

11. Në lidhje me çeljen e fondit për ish të përndjekurit politik.

Situata: Ujësjellës Kanalizime Kavajë Sh.a,nuk ka llogaritur dhe derdhur për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2018-2019 në **shumën totale 1,835,010 lekë.**

Fondi i pagave	Vlera	Fondi për të përndjekurit
2018	85,460,000	854,600
2019	98,041,000	980,410
Totali	**183,501,000**	**1,835,010 lekë**

Kriteri: Ujësjellës Kanalizime Sh.a Kavajë nuk ka zbatuar shkronjën "b" të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "*Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë"* dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 "*Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë"*

Ndikimi: Efekt social
Shkaku: Mos përcaktim i fondit për të përndjekurit politike
Rëndësia: E mesme
Rekomandime: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa çdo fillim viti "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë" dhe të kryhet raportimi i saktë në pasqyrat financiare, në përputhje me standardet dhe politikat kontabël të miratuara nga vetë institucioni.
-Nga Administratori i shoqërisë dhe sektori i financës të merren masa që shuma e identifikuar të mund të paguhet me këste sipas një skeduli të detajuar për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë**.**
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: Ish Administratori z. H.T, Ish Administratori z. E.D dhe Administratori i Shoqërisë z.B.T.*Trajtuar me hollësisht tek aktkonstatimi nr.3, datë 21.02.2020*

IV. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjeve me vlera te vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).

1.Titulli i gjetjes: Shpërndarja e karburantit pa dokumente justifikuese, në UKKA SHA Kavajë
Situata: Për mbajtjen e dhe shpërndarjen e karburantit në UK Kavajë SHA, nuk ka një strukturë të ngritur me një urdhër titullari, por kjo shpërndarje e karburantit është kryer me urdhër verbal nga Administratorët e UK Kavajë SHA për periudhën objekt auditimi.
-Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit për vitin 2018 dhe vitin 2019 u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës.
-Kartelat për tërheqjen e karburantit janë nënshkruar nga titullari i UK Kavajë për periudhën objekt auditimi ose personi i autorizuar në formë verbale nga Titullari i UK Kavajë SHA, sipas periudhës objekt auditimi.
-Automjetet e UK Kavajë SHA, nuk janë të pajisura me sistemin GPS, nuk kontrollohen km e përshkuar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patenta shoqëruese e mjeteve dhe për mjetet e përdorura nuk janë të miratuara normativat e konsumit/100km për këtë qëllim, si dhe nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina.
- Nga verifikimi i gjendjes së karburantit sipas evidencës nga programi Alpha Platinium në datën 18.02.2020, në zyrën e financës në UK Kavajë SHA për periudhën 2018-2019 nuk rakordon vlera hyrje e Naftës sipas kartelës nr.01306 dhe vlera dalje e Naftës sipas kartelës nr.01306, sipas sasive të tërhequra gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit në Ujësjellës Kanalizime Kavajë për vitin 2018 dhe vitin 2019, nuk dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës për vitin 2018 prej 4,457,238 lekë për 31,752 litra dhe shpenzimi i naftës për vitin 2019 për 3,726,099 lekë për 25,946 litra.
Kriteri: Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30,datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kapitulli III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" Dokumentimi i lëvizjeve pikat 34, 35/b, 38 dhe 39.
Ndikimi/Efekti: Shpërndarje e pajustifikuar me dokumentacion dhe e pa monitoruar e karburantit nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e tij në UKKA SHA Kavajë, me një dëm të mundshëm në vlerën 8,183,337 lekë , për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA.
Shkaku: Keqmenaxhimi dhe mosnjohja e kuadrit ligjor mbi normativat dhe menaxhimin shpërndarjes së karburantit nga Administratori i UKKA Kavajë SHA dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e tij.
Rëndësia:e Lartë
Rekomandime: Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë që nga UKKA SHA Kavajë, të merren masa që të rregullohet me urdhër struktura që menaxhon mbajtjen e karburantit dhe të dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës në vazhdimësi.

1.Titulli i gjetjes : Shpërndarja e karburantit pa dokumente justifikuese, në UKKA SHA Kavajë ,ka rezultuar me dëm ekonomik të mundshëm në vlerën 8,183,337 lekë

Situata: Për mbajtjen e dhe shpërndarjen e karburantit në UK Kavajë SHA, nuk ka një strukturë të ngritur me një urdhër titullari, por kjo shpërndarje e karburantit është kryer me urdhër verbal nga Administratorët e UK Kavajë SHA për periudhën objekt auditimi.
-Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit për vitin 2018 dhe vitin 2019 u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës.
-Kartelat për tërheqjen e karburantit janë nënshkruar nga titullari i UK Kavajë për periudhën objekt auditimi ose personi i autorizuar në formë verbale nga Titullari i UK Kavajë SHA, sipas periudhës objekt auditimi.
-Automjetet e UK Kavajë SHA, nuk janë të pajisura me sistemin GPS, nuk kontrollohen km e përshkuar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patenta shoqëruese e mjeteve dhe për mjetet e përdorura nuk janë të miratuara normativat e konsumit/100km për këtë qëllim, si dhe nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina.
- Nga verifikimi i gjendjes së karburantit sipas evidencës nga programi Alpha Platinium në datën 18.02.2020, në zyrën e financës në UK Kavajë SHA për periudhën 2018-2019 nuk rakordon vlera hyrje e Naftës sipas kartelës nr.01306 dhe vlera dalje e Naftës sipas kartelës nr.01306, sipas sasive të tërhequra gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit në Ujësjellës Kanalizime Kavajë për vitin 2018 dhe vitin 2019, nuk dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës për vitin 2018 prej 4,457,238 lekë për 31,752 litra dhe shpenzimi i naftës për vitin 2019 për 3,726,099 lekë për 25,946 litra. Për rrjedhojë vlera 8,183,337 lekë ,përbën dëm ekonomik të mundshëm për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA dhe Buxhetin e Shtetit,dhe nqs nuk paraqitet dokumentacioni i mësipërm duhet të dëmshpërblehet nga ish Administratorët e UK Kavajë SHA z.H.T për periudhën 01.01.2018-1.08.2019, z.E.D për periudhën 2.08.2019-13.08.2019, Administratori i UK Kavajë SHA z.B.T për periudhën 15.08.2019-31.12.2019, përgjegjësit e shpërndarjes së karburantit znj.R.B për periudhën 11.03.2019-31.07.2019, Znj.F.Gj për periudhën 21.07.2019- 31.08.2019, z.M.SH për periudhën 21.08.2019-31.12.2019 dhe z.N.C, me detyrë magazinier për periudhën objekt auditimi.
Kriteri: Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30,datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kapitulli III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" Dokumentimi i lëvizjeve pikat 34, 35/b, 38 dhe 39.
Ndikimi/Efekti: Shpërndarje e pajustifikuar me dokumentacion dhe e pa monitoruar e karburantit nga strukturat përgjegjëse për menaxhimin e tij në UKKA SHA Kavajë, me një dëm të mundshëm në vlerën 8,183,337 lekë , për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA.
Shkaku: Keqmenaxhimi dhe mosnjohja e kuadrit ligjor mbi normativat dhe menaxhimin shpërndarjes së karburantit nga Administratori i UKKA Kavajë SHA dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e tij.
Rëndësia:e Lartë
Rekomandime: Nga Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, të ndiqen të gjitha hapat ligjore dhe administrative për arkëtimin e vlerës 8,183,337 lekë e cila përbën dëm ekonomik të mundshëm për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, dhe nqs nuk paraqitet dokumentacioni i mësipërm duhet të dëmshpërblehet nga ish Administratorët e UK Kavajë SHA z.H.T për periudhën 01.01.2018-1.08.2019, z.E.D për periudhën 2.08.2019-13.08.2019, Administratori i UK Kavajë SHA z.B.T për periudhën 15.08.2019-31.12.2019, përgjegjësit e

shpërndarjes së karburantit znj.R.B për periudhën 11.03.2019-31.07.2019, Znj.F.Gj për periudhën 21.07.2019- 31.08.2019, z.M.SH për periudhën 21.08.2019-31.12.2019 dhe z.N.C, me detyrë magazinier për periudhën objekt auditimi.*Sa më sipër është mbajtur akt konstatimi nr.12, datë 21.02.2020*

1.Në përgjigje të observacionit të datës 09.04.2020 ora 10:43, të ardhur në adresën zyrtare të KLSH me email nga znj.F.Gj ,për projektraportin e dërguar në UKKA SHA, ju sqaroj si më poshtë vijon :

Përsa i përket konstatimeve për problematikat dhe mangësitë e konstatuara në mbajtjen e karburantit dhe komenteve tuaja mbi "keqkuptimet grupit të auditimit për marrjen e informacionit" përsa i përket marrjes së informacionit nga Dega e Financës, të pretenduara nga ju ,ju sqaroj përsëri si më poshtë se :

Për mbajtjen e dhe shpërndarjen e karburantit në UK Kavajë SHA, nuk ka një strukturë të ngritur me një urdhër titullari, por kjo shpërndarje e karburantit është kryer me urdhër verbal nga Administratorët e UK Kavajë SHA për periudhën objekt auditimi.

-Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit për vitin 2018 dhe vitin 2019 u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës.Automjetet e UK Kavajë SHA, nuk janë të pajisura me sistemin GPS, nuk kontrollohen km e përshkuar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patenta shoqëruese e mjeteve dhe për mjetet e përdorura nuk janë të miratuara normativat e konsumit/100km për këtë qëllim, si dhe nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina.

Nga verifikimi i gjendjes së karburantit sipas evidencës nga programi Alpha Platinium në datën 18.02.2020, në zyrën e financës në UK Kavajë SHA për periudhën 2018-2019 nuk rakordon vlera hyrje e Naftës sipas kartelës nr.01306 dhe vlera dalje e Naftës sipas kartelës nr.01306, sipas sasive të tërhequra gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit në Ujësjellës Kanalizime Kavajë për vitin 2018 dhe vitin 2019, nuk dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës për vitin 2018 prej 4,457,238 lekë për 31,752 litra dhe shpenzimi i naftës për vitin 2019 për 3,726,099 lekë për 25,946 litra.

Grupit të auditimit ju dorëzua një shkresë nga arkivi i UK Kavajë SHA me nr.1026, datë 21.08.2019 e Administratorit të UK Kavajë SHA, ku i kërkohet firmës fituese të tenderit të karburantit për vitin 2019 "K..." SHA, ndryshimin e përdoruesit i cili bën menaxhimin e karburantit për mjetet e ndërmarrjes UKKA SHA nga znj.F.Gj në z.M.SH. Ndërsa nga emaili i dates 14.02.2020, i sjellë në zyrën e financës në UK Kavajë SHA nga firma fituese e tenderit të karburantit për vitin 2019 "K..." SHA, sqarohet se përdoruese e sistemit nga peridha 31.07.2019-21.08.2019, ka qenë znj.F.Gj. Nuk ka pasur asnjë keqkuptim përsa i përket marrjes së informacionit nga Dega e Financës dhe Drejtoria Tregtare sepse grupi i auditimit ka komunikuar dhe marrë informacion me email , shkrim dhe verbal nga të gjithë personat përgjegjës për shpërndarjen e karburantit dhe praktikisht ka konsultuar gjithë korrespondencën e ardhur dhe të dalë nga UKKA SHA për periudhën objekt auditimi dhe çdo dokumentacion i prodhuar pas faktit s'ka vlerë juridike. Ju sqarojmë se bashkëlidhur emailit keni sjellë një pasqyrë shpërndarje të naftës që nuk dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit dhe për arsyet e lartpërmendura observacioni juaj nuk merret parasysh.

2. Në përgjigje të observacionit të datës 07.04.2020 ora 10:45, të ardhur në adresën zyrtare të KLSH me email nga z.M.SH ,për projektraportin e dërguar në UKKA SHA, ju sqaroj si më poshtë vijon :

Përsa i përket konstatimeve për problematikat dhe mangësitë e konstatuara në mbajtjen e karburantit dhe komenteve tuaja mbi "keqkuptimet grupit të auditimit për marrjen e informacionit", përsa i përket marrjes së informacionit nga Dega e Financës, të pretenduara nga ju ,ju sqaroj përsëri si më poshtë se :

Për mbajtjen e dhe shpërndarjen e karburantit në UK Kavajë SHA, nuk ka një strukturë të ngritur me një urdhër titullari, por kjo shpërndarje e karburantit është kryer me urdhër verbal nga Administratorët e UK Kavajë SHA për periudhën objekt auditimi.

-Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit për vitin 2018 dhe vitin 2019 u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës.Automjetet e UK Kavajë SHA, nuk janë të pajisura me sistemin GPS, nuk kontrollohen km e përshkuar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patenta shoqëruese e mjeteve dhe për mjetet e përdorura nuk janë të miratuara normativat e konsumit/100km për këtë qëllim, si dhe nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina.

Nga verifikimi i gjendjes së karburantit sipas evidencës nga programi Alpha Platinium në datën 18.02.2020, në zyrën e financës në UK Kavajë SHA për periudhën 2018-2019 nuk rakordon vlera hyrje e Naftës sipas kartelës nr.01306 dhe vlera dalje e Naftës sipas kartelës nr.01306, sipas sasive të tërhequra gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit në Ujësjellës Kanalizime Kavajë për vitin 2018 dhe vitin 2019, nuk dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës për vitin 2018 prej 4,457,238 lekë për 31,752 litra dhe shpenzimi i naftës për vitin 2019 për 3,726,099 lekë për 25,946 litra.

Grupit të auditimit ju dorëzua një shkresë nga arkivi i UK Kavajë SHA me nr.1026, datë 21.08.2019 e Administratorit të UK Kavajë SHA, ku i kërkohet firmës fituese të tenderit të karburantit për vitin 2019 "K.." SHA, ndryshimin e përdoruesit i cili bën menaxhimin e karburantit për mjetet e ndërmarrjes UKKA SHA nga znj.F.Gj në z.M.SH.Ndërsa nga emaili i dates 14.02.2020, i sjellë në zyrën e financës në UK Kavajë SHA nga firma fituese e tenderit të karburantit për vitin 2019 "K..." SHA, sqarohet se përdorues i sistemit dhe përgjegjës për menaxhimin e karburantit nga peridha 21.08.2019-31.12.2019, ka qenë z.M.SH. Nuk ka pasur asnjë keqkuptim përsa i përket marrjes së informacionit nga Dega e Financës dhe Drejtoria Tregtare sepse grupi i auditimit ka komunikuar dhe marrë informacion me email , shkrim dhe verbal nga të gjithë personat përgjegjës edhe nga ju personalisht ku na u tha në prani të Drejtoreshës Tregtare madje na e konfirmoi edhe ajo në praninë tuaj, që për shpërndarjen e karburantit nuk ka asnjë praktikë dokumentare, as urdhra titullari për më tej grupi i auditimit ka konsultuar gjithë korrespondencën e ardhur dhe të dalë nga UKKA SHA për periudhën objekt auditimi dhe çdo dokumentacion i prodhuar pas faktit s'ka vlerë juridike. Ju sqarojmë se bashkëlidhur emailit keni sjellë një pasqyrë shpërndarje të naftës që nuk dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit, që nuk u faktua as në kohën kur grupi i auditimit ishte në fazën audituese dhe prodhimi i dokumentacionit pas faktit, ngre dyshime mbi vërtetësinë e dokumentacionit të bashkëlidhur ktij emaili.Për arsyet e lartpërmendura observacioni juaj nuk merret parasysh.

VI. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e

vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

1.Titulli i Gjetjes. Në shoqërinë UK.Kavajë SHA nuk janë miratuar pasqyrat financiare sipas afateve të përcaktuara nga Ministria e Financave, bazuar në Udhëzimin nr.14 datë 28.12.2006 , i ndryshuar me urdhërin nr.26 datë 27.12.2007.Nuk është bërë transferimi i aseteve në Bashkin Rrogozhinë.Nuk është kontabilizuar zvogëlimi i kapitalit sipas rekomandimit të ekspertëve.(pra nuk është miratuar në Këshillin Administrativ).Bilanci i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë për vitin 2018, moskuadrimi i tij me llogaritë e gjëndjeve sipas programit të kontabilitetit Alfa.

Situata: a.Shoqëria UK.Kavajë SHA, nuk ka miratuar pasqyrat financiare sipas afateve të përcaktuara nga Ministria e Financave, në kundërshtim me Udhëzimin nr.14 datë 28.12.2006 , i ndryshuar me urdhërin nr.26 datë 27.12.2007 dhe mosdorëzimi i bilancit sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, ka rënduar shoqërinë me një gjobë prej 15,000 lekë.

b.Shoqëria UK Kavajë SHA, nuk ka bërë transferimin e aseteve në Bashkinë Rrogozhinë, gjithashtu nuk është kontabilizuar zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë për vitin 2018, në vlerën 93,802,627 lekë vlerë e cila i takon Bashkisë Rrogozhinë në bazë të përllogaritjeve të ekspertëve kontabël të miratuar në raportin "Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë", datë 12.02.2018, përsa më sipër vlera 93,802,627 lekë rëndon në mënyrë të padrejtë zërin e bilancit aktive afatgjata materiale, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

c.Bilanci i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë për vitin 2018, nuk kuadron në llogaritë e gjëndjeve sepse totali i bilancit i raportuar nga shoqëria për vitin 2018 është në vlerën 2,706,139,177 lekë , ndërsa sipas programit të kontabilitetit totali i bilancit rezulton në vlerën 2,707,071,100 lekë me nje diferencë në vlerën 931,923 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i moskuadrimit të hedhjes së të dhënave në programin e kontabilitetit të shoqërisë duke raportuar një mospërputhje të të dhënave në programin e kontabilitetit dhe në bilancin e raportuar, duke ulur shkallën e besueshmërisë të ngjarjeve dhe fakteve në kontabilitetin e shoqërisë dhe rezultatin financiar, veprime në kundërshtim *me udhëzimin nr.14 date 28.12.2006 , i ndryshuar me urdhërin nr.26 datë 27.12.2007, Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat , i ndryshuar, neni 33/1"***,** *Ligjin nr.9228,datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe SKK2.*

Kriteri: Udhëzimin nr.14 datë 28.12.2006, i ndryshuar me urdhërin nr.26 datë 27.12.2007, *Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, nëni 33/1"***,** Ligjin nr.9228,datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin" dhe SKK2.

Ndikimi/efekti: Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë për vitin 2018 për shkak të dorëzimit me vonesë të pasqyrave financiare, miratuar me vendim *nr.817/3, datë 29.07.2019,nga Këshili Administrativ, ndërsa për vitin 2019 nuk janë miratuar.ende. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, neni 33/1"Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit 1. Shoqëritë tregtare sipas ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar , pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të Kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve ose organin kompetënt vendimarrës të shoqërisë, rezultatët financiare*

të vitit paraardhes dhe ta destinojnë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezërvave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.Veprimet përsa më sipër ngarkojnë me përgjegjësi Administratorin e UK Kavajë SHA dhe Keshillin e Administrimit UK Kavajë SHA për periudhën objekt auditimi. Pasqyrat financiare janë firmosur nga ish p/sektorit të financës znj.B.X, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, nga ish Drejtori Tregtar zj.F.Gj, si dhe ish Drejtori i Përgjithshëm H.T.Veprimet përsa me sipër ngarkojnë me përgjegjesi ish p/sektorit të financës znj. B.X, në cilësinë e hartuesit të pasqyrave financiare, nga ish Drejtori Tregtar zj. F.Gj, si dhe ish Administratori z.H.T dhe Këshillin e Administrimit UK Kavajë SHA për periudhën objekt auditimi.

Udhëzimin nr.14 datë 28.12.2006 , i ndryshuar me urdhërin nr.26 datë 27.12.2007.

Shkaku: Mbi mosdorëzimin e pasqyrave financiare brënda afatit të miratuar nga shoqëria.
Mbi moskuadrimin dhe mospranimin e bilancit nga organet kompetente.
Mbi mos kontabilizimin e zvogëlimit të kapitalit nga shoqëria UK.Kavajë SHA.

Rëndësia: E lartë

1.1Rekomandimi: Nga Drejtoria Tregtare e UK Kavajë SHA dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin masa për hartimin e pasqyrave financiare dhe dorëzimin e tyre në Këshillin e Administrimit dhe Asamblenë e Aksionarëve brenda afateve sipas përcaktimeve ligjore.

1.2.Rekomandimi : Nga Drejtoria Tregtare e UK Kavajë SHA të merren masa për sistemimin e veprimeve financiare që lidhen me regjistrimin e përpiktë në programin e kontabilitetit të shoqërisë, sipas ngjarjeve dhe fakteve të konstatuara gjithashtu të kryejë të gjitha sistemimet e diferencave që ekzistojnë midis bilancit të raportuar dhe të dhënave në programin e kontabilitetit të shoqërisë.

1.3 Rekomandimi Shoqëria UK Kavajë SHA të marrë masa për kontabilizimin e zvogëlimit të kapitalit duke marrë në konsideratë rezultatin financiar (humbjen) e miratuar në Këshillin e Administrimit dhe duke e shpërndarë këtë humbje 80.5 % në UK Kavajë SHA dhe 19.5 % Bashkisë Rrogozhinë, duke kryer edhe transferimin e aseteve nga UK Kavajë SHA në Bashkinë Rrogozhinë.

2. Titulli i gjetjes: **Mosrakordim në bilanc i veprimeve me arkë dhe bankë dhe me faturimet ndaj klientëve**

Situata: -Nga auditimi u konstatua se **s**hoqëria UK Kavajë SHA , nuk ka një pasqyrim të saktë midis gjëndjes në bilanc të veprimeve me arkë dhe bankë dhe me faturimet ndaj klientëve konkretisht në llogarinë "Aktive Mjete Monetare" për vitin 2018 përfshihet vlera 16,747,026 lekë e raportuar në bilanc ndërsa gjëndja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është 16,747,751 lekë duke rezultuar në një diferencë prej 725 lekë, veprime që kanë ardhur si rezultat i moshedhjes së saktë të mandat arkëtimeve dhe mandat pagesave në librin e arkës gjithashtu nga Drejtoria Tregtare e UK Kavajë SHA, nuk është kryer aktrakordimi përfundimtar me arkëtaren e shoqërisë për gjëndjen reale të arkës, gjithashtu nga auditimi u konstatua se Shoqëria UK.Kavajë nuk punon me kasa fiskale, në kundërshtim me ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat",i ndryshuar.

-Nga auditimi u konstatua se në bilancin e vitit 2018 për llogarinë e detyrimeve të klientëve të shoqërisë UK Kavajë SHA, rezultojnë 8 klientë që janë me gjendje kreditore në vlerën 12,874,007 lekë, duke mos i pasqyruar saktë në bilanc të ardhurat e shoqërisë.Ky veprim është në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin ", i ndryshuar

-Shoqëria UK Kavajë SHA, për vitin 2018 ka dhënë page paradhënie për dy punonjës në vlerën 69,692 lekë në kundërshtim me ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"

Kriteri: Ligjin e kontabilitetit nr.9228 Datë 29.04.2004, me Ligjin nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar,*Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat , i ndryshuar, nëni 33/1,*të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe SKK4.
Ndikimi i efektit: Ushtrim i veprimtarisë së shoqërisë UKKA SHA Kavajë në kundërshtim me parimet e kontabilitetit, Ligjin nr. 9228 datë 29.04.2008 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, Ligji Nr. 10296, datë 08.08.2010"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,i ndryshuar,
Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet i procesit të raportimit të kërkesave të arkëtueshme ose klientëve të shoqërisë UK.Kavajë SHA. brenda vitit ushtrimor 2018 në kundërshtim me parimin themelor të kontabilitetit"Shpenzimet dhe të ardhurat konstatohen në momentin kur lindin detyrimet dhe të drejtat".
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi: : -Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, të marrë masa për të pasqyruar në mënyrë të saktë gjëndjen në bilanc të veprimeve me arkë dhe bankë.
- Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, të marrë masa për të sistemuar detyrimin e faturave të klientëve nga diferencat që kanë rezultuar në librat analitikë të bilancit.
-Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, të marrë masa për të kryer aktrakordimin përfundimtar me arkëtaren e shoqërisë për gjëndjen reale të arkës, gjithashtu çdo veprim të kryhet me kasa fiskale.
- Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA të marrë masa për të sistemuar veprimet për shpenzimet e shtyra ,për shpenzimet e pajustifikuara me bankë dhe ato shpenzime të cilave nuk i është përcaktuar afati i shkarkimit të tyre në pasqyrën e rezultatit të çdo viti ,vendimet e marra nga Keshilli i Administrimit i shoqërisë. Në mënyrë të menjëhershme të arkëtohen paradhëniet dhe të dalin përgjegjesitë e arsyes së dhënies së këtyre fondeve nga arka e shoqërisë për individë të veçantë të saj.

3.Titulli i Gjetjes: Nuk është llogaritur amortizimi i aktiveve afatgjata materiale (Ndërtesa, Impiantë, Makinëri Pajisje, Mjet Transporti)

Situata: Nga Shoqëria UK Kavajë SHA, nuk është llogaritur amortizimi i aktiveve afatgjata materiale për vitin 2018 (Ndërtesa, Impiante, Makineri Pajisje, Mjete Transporti),veprim në kundershtim të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998"Tatimi mbi të ardhurat ",i ndryshuar, dhe udhëzimi nr.5 i ministrisë së financave datë 30.01.2018 ,ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar.
Kriteri: Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, VKM Nr. 63, datë 27.1.2016, si dhe legjislacionit specifik në fuqi (lejet, autorizimet, licensat etj) që lidhet me aktivitetin e kësaj shoqërie në përputhje me zonën e juridiksionit të Bashkisë Kavajë .
Ndikimi/efekti: Ushtrim i veprimtarisë së shoqërisë në kundërshtim me Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, VKM Nr. 63, datë 27.1.2016, si dhe legjislacionit specifik në fuqi (lejet, autorizimet, licensat etj) që lidhet me aktivitetin e kësaj shoqërie në përputhje me zonën e juridiksionit të Bashkisë Kavajë .
Shkaku: Për periudhën 2018 objekt auditimi, nuk është kryer inventari fizik i aseteve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe ai ekonomik. Gjatë investimeve të ndryshme në linja e kanalizime të reja, dhe impiantë, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kryer veprimet përkatëse në kontabilitet në kundërshtim me

Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktivitetëve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar
Për mos pasqyrimin në lidhje me Amortizimin e AQT (Ndërtësa, Impiantë, Makineri Pajisje, Mjet Transporti), rezulton se Shoqëria në vitin 2018, ka përdorur norma të ndryshme nga normat e miratuara në kundërshtim Legjislacionit përkatës tatimor (Ligji "Për Tatimin mbi të Ardhurat" Nr.8438 dt. 28.12.1998, i ndryshuar dhe Udhëzimi i MF nr. 5 dt. 30.01.2006, i ndryshuar, në zbatim të këtij ligji)
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi:
Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa për të kryer inventarin fizik të aseteve të shoqërisë për vitin 2018, të evidentohen aktivet afatgjata materiale që kanë dalë jashtë përdorimit, si dhe të kryhen procedurat përkatëse.
-Drejtoria Tregtare e shoqërisë UK.Kavajë SHA të marrë masa për të kërkuar hyrjet e aktivet afatgjata materiale si dhe hyrjet e Aktiveve të periudhës me kosto historike të tyre. Njëkohësisht në bazë të viteve të jetës që ky aktiv ka në shoqëri, të rëndohet me normat e amortizimit përcaktuar në ligj dhe të llogaritet saktë amortizimi i akumuluar për vitin 2018 e në vazhdim.

4.Titulli i Gjetjes: moskuadrimi i llogarive "Furnitorë" "Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore", "Të pagueshme për detyrimet tatimore', "Të pagueshme për Shpenzimet e konstatuara" në bilancin e vitit 2018 me llogaritë e gjendjeve në programin e kontabilitetit Alfa.
Situata: Nga shoqëria UK Kavajë SHA dhe Drejtoria Tregtare nuk është kuadruar me bilancin dhe librat analitikë të llogarisë "Furnitorë" "Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore", "Të pagueshme për detyrimet tatimore', "Të pagueshme për Shpenzimet e konstatuara" në bilancin e vitit 2018 me llogaritë e gjendjeve në programin financiar të kontabilitetit. Konkretisht në kontabilitetin e Shoqërisë paraqiten (7 shtatë) furnitorë që janë me gjëndje debitore ne vlerën 844,976,8 lekë**.**Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos kontabilizimit të faturave, por vetëm i pagesave të tyre , pa njohur detyrimin nga subjekti i Ujesjellës Kanalizime Kavajë sha për rrjedhojë kjo ka sjellë dhe mosdeklarimin saktë të shpenzimeve në kundërshtim me SKK 4 "Për të drejtat dhe detyrimet", Ligji nr.9228, date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
-Shoqëria UK Kavajë SHA për vitin 2018 ka deklaruar në shtet detyrimin për TVSH-në në vlerën 11,973,528 lekë , ndërsa vlera e likujdimeve të raportuara në urdhër pagesat e tatimeve është 10,296,442 lekë. Diferenca për detyrimin e papaguar të TVSH-së për vitin 2018 është 1,677,086 lekë. Kjo diferencë nuk përputhet me gjëndjen e raportuar në muajin Dhjetor 2018 të vlerës së deklaruar në shtet, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.9228, date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
Kriteri: Ligji nr. 9228 datë 29.04.2008 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, Ligji Nr. 10296, datë 08.08.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"i ndryshuar, Ligji nr.92/2014 "Për pagat dhe shpërblimet në Republikën e Shqipërisë"
Ndikimi/efekti: Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9228 datë 29.04.2008 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, Ligji Nr. 10296, datë 08.08.2010"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Ligji nr. 9228 datë 29.04.2008 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"
Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet i procesit të raportimit të Llogarive të pagueshme (Furnitorë) të shoqërisë UK.Kavajë SHA. brenda vitit ushtrimor 2018 duke mos zbatuar

parimin themelor të kontabilitetit "Shpenzimet dhe të ardhurat konstatohen në momentin kur lindin detyrimet dhe të drejtat".Mos vlerësim sa dhe si duhet detyrimit të shoqërisë për pagën bruto ndaj punonjësve të saj, në bazlë të Ligjit nr.92/2014, " Për pagat dhe shpërblimet në Republikën e Shqipërisë".Mos vlerësim sa dhe si duhet i procesit të detyrimeve tatimore të shoqërisë në organë tatimore të saj kryesisht TVSH.Mos prezantimi i saktë në programin e kontabilitetit Alfa të shoqërisë për historikun e këtyre shpenzimeve të konstatuara, për çfarë janë përdorur mjetet monetare, pse me këto mjete likuidohet detyrim TVSH , kur kjo llogari ka pozicionin e vet në bilanc.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi:

- Drejtoria Tregtare e shoqërisë UK.Kavajë SHA, të marrë masa për të rakorduar llogarinë, për të gjithë furnitorët që nuk u ka paguar detyrimin në momentin e lindjes së detyrimit të tyre nga shoqëria UK.Kavajë SHA, si dhe të sistemojë ata furnitorë që kanë dalë me pagesë më shumë se sa detyrimi në librat analitike të tyre.

-Drejtoria Tregtare e shoqërisë UK.Kavajë SHA, të marrë masa masa për të rakorduar me degën të tatimeve Durrës për detyrimet dhe likuidimet për vitin 2018 dhe në vazhdim dhe të nxjerrë një detyrim real të saj, ndaj degës së tatimeve Durrës, duke u bazuar në FDP dhe në Urdhër pagesat nëpërmjet bankës për likuidimin e TVSH.

5.Titulli i Gjetjes: Për mos rakordimin e llogarise "Hua Bankare", si dhe moskryerja e analizës së llogarisë "Të ardhura të shtyra" për vitin 2018

Situata: - Shoqëria UK Kavajë SHA në rolin e agjencisë zbatuese sipas marrveshjes së huasë miratuar me ligjin Nr. 9042 datë 03.04.2003 ka ndërtuar impjantin e prodhimit të ujit të pijshëm në Manskuri. Ky impjant është projektuar që të furnizojë zonën e plazhit Golem si dhe shitje me shumicë UK Durrës. Ndërtimi i tij është financuar nga huaja 2,045,167.52 Euro dhe granti 1,533,875.64 Euro i marrë nga Qeveria Gjermane (Banka KfW).Punimet e impjantit janë kryer në lotin A ku përfshihen 1. Ndërtimi i tre filtrave të rërës 1200 m3, 2. Rezervuari dhe stacionet e pompimit, sistemi automatik i klorinimit. Punimet kanë përfunduar më 04.07.2007 dhe janë marrë në dorëzim me Certificate of Handing Over datë 14.09.2007 firmosur nga kontraktori, konsulenti dhe klienti (Drejtori i UKK Z. H.SH). Nga auditimi është konstatuar se Shoqëria UK Kavajë SHA nuk ka kontabilizuar disbursimin e kredisë së dhënë në bazë të marrëveshjes së Shtetit Shqiptar me Bankën Gjermane, nuk ka llogaritur kostot e mirëmbajtjes dhe të amortizimit gjithashtu nuk ka kthyer asnjë këst si principal ashtu edhe interesa për huanë e dhënë, në kundërshtim me ligjin Nr. 9042 datë 03.04.2003.

Kriteri: Zbatimi i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",I ndryshuar, si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", I ndryshuar,SKK4.

Ndikimi/efekti: Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, me Ligjin nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar,SKK4, SKK5"Për të ardhurat e shtyra"

Shkaku: Mos deklarimi i saktë në programet e kontabilitetit disbursimi i kredisë në llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe mungesa e likuidimit të tyre.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi:
-DrejtoriaTregtare në UK Kavajë SHA, të marrin masa për të nxjerrë të dhënat e plota mbi akordimin e kredisë nga shteti shqiptar dhe nga Banka Gjermane, të evidentojë disbursimin e saj, me bankën e nivelit të dytë me të cilën është bërë disbursimi, likuidimi i principalit, llogaritjen e kostove të mirëmbajtjes, amortizimit dhe interesave, që kjo kredi të shlyhet brenda vitit 2042, siç është përcaktuar në marrëveshjen e qeverisë shqiptare me bankën gjermane.

6.Titulli i Gjetjes:. Për Llogarinë "Rezerva të tjera "për vitin 2018 vlera e raportuar në bilanc është: 0 ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është: 1,702,411,755 lekë. Ekziston një diferencë prej 1,702,411,755 lekë
-Për Llogarinë "Fitim /Humbje e vitit" për vitin 2018 vlera e raportuar në bilanc është: -8,968,840) lekë ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është: -10,643,159 lekë . Ekziston një diferencë prej -1,674,319 lekë

Situata: Në bilancin e vitit 2018 të shoqërisë në zërin "të ardhura të shtyra" ka një vlerë 1,720,430,086 lekë, origjina e të cilës nuk është e argumentuar në të dhënat e programit të kontabilitetit kjo shifër është 108 lekë. Diferenca prej 1,720,430,068 lekë rezulton të jetë një vlerë e mbartur në vite në bilanc. Kjo vlerë mund të ketë ardhur si rezultat i mosdeklarimit të të ardhurave të muajit dhjetor të çdo viti i raportuar në janarin e vitit të ardhshëm apo të ndonjë natyre tjetër që nuk është kuadruar midis Drejtorisë së Shitjes dhe Drejtorisë Tregtare në UK Kavajë SHA. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, SKK nr.5 "Për të ardhurat e shtyra".
Kriteri:Zbatimi **i** Ligjit nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",i ndryshuar, si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,i ndryshuar,
Ndikimi/efekti: Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",i ndryshuar, si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin,i ndryshuar, SKK5"Për të ardhurat e shtyra"
Shkaku: Mos raportimi i saktë nga ana e institucionit UK.Kavajë SHA Llogarinë KAPITALI, lind pyetja shoqëria ka vite me humbje, si i realizoi rezërvat ligjore , kur ato krijohen nga fitimi i shoqërisë. Pse një humbje me tepër se tre vjet.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi: DrejtoriaTregtare dhe Drejtoria e Shitjes në UK Kavajë SHA, të marrin masa të argumentojnë dhe të sistemojnë vlerën 1,720,430,068 lekë në programin e kontabilitetit të shoqërisë.

7.Titulli i Gjetjes. Moskuadrimi i llogarive të ardhura dhe shpenzime gjithsej në shoqërinë UK.Kavajë SHA.për vitin 2018 ndërmjet bilancit dhe llogarive të gjendjeve në programin e kontabilitetit Alfa.
Situata: -Në bilancin e vitit 2018 të shoqërisë në zërin "Rezerva të tjera "për vitin 2018 vlera e raportuar në bilanc është: 0 ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është: 1,702,411,755 lekë. Ekziston një diferencë prej 1,702,411,755 lekë. Për vlerën 1,702,411,755 lekë, nuk jepen sqarime ne llogarine e saj,por e sjellin me gjendje te mbartur nga vitet e kaluara.
- Në bilancin e vitit 2018 të shoqërisë për zërin "Fitim /Humbje e vitit" për vitin 2018 vlera e raportuar në bilanc është: -8,968,840 lekë ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të

kontabilitetit është: -10,643,159 lekë . Ekziston një diferencë prej -1,674,319 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",i ndryshuar, si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin,i ndryshuar, SKK5"Per te ardhurat e shtyra"

Kriteri: Zbatimi i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Ndikimi/efekti: Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet i të ardhurave dhe shpenzimeve të shoqërisë duke zbatuar ligjet përkatëse si dhe SKK7, si dhe parimet bazlë të kontabilitetit financiar në raportimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin kur lind detyrimi dhe e drejta.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi: Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA të marrë masa që të evidentojë dhe analizojë nga bilancet e viteve të mëparshme ecurinë e llogarisë "Fitim/humbje" duke paraqitur arsyet e aktivitetit me humbje si dhe të sistemojë llogarinë "Rezerva të tjera" për vlerën 1,702,411,755 lekë, që në bilancin e vitit 2018 paraqitet me gjendje zero.

8:Titulli i Gjetjes. **Mosrakordim i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit të bilancit të vitit 2018 me llogaritë e gjendjeve të programit të kontabilitetit Alfa, si dhe me deklarimet në drejtorinë e Tatim Taksave Durrës.**

-Tatimit në Burim.
- Tatimit mbi të Ardhurat Personale (TAP) .
- Sigurimeve Shoqërore /Shëndetësore.

Situata: Moskuadrimi i llogarive të ardhura dhe shpenzime gjithsej në shoqërinë UK.Kavajë SHA për vitin 2018 ndërmjet bilancit dhe llogarive të gjendjeve në programin e kontabilitetit Alfa. Llogaria "Te ardhura gjithsej" për vitin 2018 në Pasqyrën financiare te raportuar vlera eshte: 327,169,258 lekë, ndersa gjendja e kasaj llogarie ne programin e kontabilitetit eshte: 326,974,038 leke. Ekziston nje diference prej 195,220 lekë.

Llogaria"Shpenzime gjithsej"per vitin 2018 ne Pasqyren financiare te raportuar vlera eshte: 336,138,098, ndersa gjendja e kasaj llogarie ne programin e kontabilitetit eshte: 337,617,198 leke Ekziston nje diference prej 1,479,100 leke. Llogaria e te ardhurave ka moskuadrime ne llogarite "Te ardhura Financiare" per vitin 2018 ne Pasqyren financiare të raportuar vlera është: 32,146,963 lekë, ndërsa gjendja e kësaj llogarie në programin e kontabilitetit eshte: 31,951,743 leke. Ekziston nje diference prej 195,220 leke,si dhe ne Llogarine "Te ardhura nga aktiviteti I shfrytezimit" per vitin 2018 ne Pasqyren financiare te raportuar vlera eshte: 165,726,667 leke ndersa gjendja e kasaj llogarie ne programin e kontabilitetit eshte: 165,713,708 leke. Ekziston nje diference prej 12,959.00 leke.Persa u perket shpenzimeve diferencat kane ardhur si rezultat i mosraportimit te sakte te blerjeve, llogaria "Shpenzime Lendë e parë dhe material te konsumueshme' (KMSH) per vitin 2018 ne Pasqyren financiare te raportuar vlera eshte: 116,976,428 leke.Ne programin e kontabilitetit vlera e blerjeve te rregjistruara per vitin 2018 eshte:*117 969 255 leke.* Ndersa ne bilancin e raportuar vlera e blerjeve eshte : *112,322,413 leke,* Keto moskuadrime kane sjelle dhe mos kuadrimin e sakte te humbjes ne shoqerine UK.Kavaje SHA. Kjo ka ardhur si rezultat i mos zbatimit plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008

"Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 date 8.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin". Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 date 8.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Kriteri: Zbatimi i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Ndikimi/efekti: Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Shkaku: Mos rakordim i vlerës në bilanc për tatimin në burim , me pasqyrqat e tatimit në burim, TAP si dhe sigurimeve shoqërore /shëndetësore,të nxjerra nga dega e tatimeve Durrës.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi:
Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, duhet të evidentojë nga bilancet e viteve të mëparshme si ka qenë ecuria e llogarive të ardhura dhe shpenzime dhe të sistemojë për vitin 2018 dhe në vazhdim klientët që kanë bërë arkëtime, por nuk ju është kontabilizuar detyrimi i tyre ndaj shoqërisë dmth fatura e shitjes.

9: Titulli i Gjetjes :Mosrakordim i detyrimeve fiskale
Situata : Nga shoqëria UK Kavajë SHA, ka një mosrakordim të detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit të bilancit të vitit 2018 me llogaritë e gjendjeve të programit të kontabilitetit të shoqërisë, si dhe me deklarimet në drejtorinë e Tatim Taksave Durrës konkretisht për: a.Tatimin në Burim,b.Tatimin mbi të Ardhurat Personale (TAP),c.Sigurimeve Shoqërore /Shëndetësore në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 date 29.04.2004 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 date 8.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Kriteri: Zbatimi i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Ndikimi/efekti: Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".
Shkaku: Mos rakordim i vlerës në bilanc për tatimin në burim , me pasqyrqat e tatimit në burim, TAP si dhe sigurimeve shoqërore /shëndetësore,të nxjerra nga dega e tatimeve Durrës.
Rëndësia: E Lartë
Rekomandimi: Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA të marrë masa për të evidentuar me saktësi dhe të kontabilizojë duke u mbështetur në dokumentat justifikues dhe dokumentat e bankës: tatimin në burim, tatimit mbi të ardhurat personale (TAP) dhe kontributet sigurimeve shoqërore /shëndetësore të punonjësve.
10.Titulli i Gjetjes. Moskryerja e inventarizimit të Aktiveve për vitin 2018, si një element i rëndësishëm kontrolli ne kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të

vërtetuar saktësinë, cilesinë e gjendjes fizike të aktiveve në fund të vitit si dhe përdorimin në mënyren e duhur dhe me eficiencë të tyre;

Situata: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2018 nuk është kryer procesi i inventarizimit të aseteve të shoqërisë nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.88, datë 27.12.2018 të Administratorit të UKKA SHA, gjithashtu nuk është monitoruar zbatimi i këtij urdhri, konkretisht për Llogarinë Inventar për vitin 2018, gjendja e raportuar në bilanc është 50,723.821 lekë, ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është 49,736,256 lekë , pra ekziston një diferencë prej (987,565) lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25 datë 10.5.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, nenin 15 dhe ngarkojnë me përgjegjësi grupin e inventarizimit dhe Administratorin e UK Kavajë SHA për vitin 2018.

Shkaku: Mos kryerja e inventarizimit të shoqërisë UK.Kavajë SHA.për vitin 2018.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandimi:

Administratori i UK Kavajë SHA, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor sipas procedurave të miratuara ligjore, rezultatet e të cilit të pasqyrohen në bilancin ekonomiko- financiar të Shoqërisë.

11.Titulli i Gjetjes. Moskuadrimi i debitorëve dhe kreditorëve midis degës shitjes dhe degës së financës për vitin 2018.

Situata: Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Shitjes në UK Kavajë SHA nuk ka kuadruar llogaritë e debitorëve dhe kreditorëve për vitin 2018. Referuar sherbimeve të kryera ndaj popullatës në lidhje me furnizimin me ujë dhe kanalizime UK Kavaje SHA i kanë lindur debitorë të cilët për vitet e veprimtarisë të kësaj shoqërie nuk kanë shlyer detyrimet për sherbimin e marrë kundrejt faturimeve të realizuara.

Në dokumentet e vëna në dispozicion grupit të auditimit nga Drejtoria e Shitjes janë paraqitur debitorët nga janari –nëntor 2018 dhe debitorët e muajit dhjetor pasqyrohen në janar të vitit 2019. Nga Drejtoria Tregtare pasqyrat e detyrimeve të debitorëve pasqyrohen deri në muajin dhjetor të vitit 2018. Konkretisht të dhënat e debitorëve nga Drejtoria Tregtare në vlerën 317,527,778 lekë, të dhënat e debitorëve nga Drejtoria e Shitjes në vlerën 307,366,000 lekë ku diferenca midis të dhënave nga Drejtoria e Shitjes është 10,161,778 lekë. Moskuadrimi i të dhënave të debitorëve nga Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Shitjes në UK Kavajë SHA ka denatyruar të ardhurën që i takon shoqërisë brënda vitit kalendarik të shoqërisë për periudhën 1.01-31.12.2018 dhe është veprim në kundërshtim me ligjin nr.9228 date 29.04.2008 " Për Kontabilitetin" , me SKK 4 "të ardhura dhe detyrime".

Kriteri: Zbatimi i Ligjit 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare",i ndryshuar, Ligji 10296 datë 8.07.2010 "Menaxhimi financiar dhe kontrolli", SKK4."Për të drejtat dhe detyrimet".

Ndikimi/efekti: Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", SKK2.

Shkaku: Mos rakordimi i debitorëve me degën e financës dhe të degën e shitjes të shoqërisë UK.Kavajë SHA.për vitin 2018 e në vazhdim.

Rëndësia: **E Lartë**

Rekomandimi: Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Shitjes të marrë masa për kuadrimin e të dhënave për debitorët e vitit 2018 duke u bazuar në parimin bazë të kontabilitetit sipas të cilit të ardhurat dhe shpenzimet evidentohen në momentin kur lind e drejta dhe detyrimi.
Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.6, datë 21.02.2020

VII.*Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.*

-Nga auditimi i dokumentacionit dhe sistemit elektronik të APP, UK Kavajë sh.a **për vitin 2018** ka parashikuar 26 prokurime me fond limit në vlerë 33,393,950 lekë, nga të cilat 18 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në vlerë 11,559,800 lekë dhe 8 procedura prokurimi "Kërkesë për propozim" me fond limit në vlerë 21,834,150 lekë. Gjatë këtij viti janë realizuar 10 procedura prokurimi, nga këto 7 procedura prokurimi blerje të vogla, me fond limit në vlerë 5,578,000 lekë e me vlerë të realizuar 5,031,500 lekë, diferenca midis vlerës së fondit limit dhe asaj të realizuar është 546,500 lekë (9.8% e fondit limit). Gjithashtu janë realizuar 3 procedura prokurimi, "Kërkesë për propozim" me fond limit në vlerë 14,000,000 lekë e vlerë të kontraktuar 8,828,939 lekë, diferenca midis vlerës së fondit limit dhe asaj të realizuar është 5,171,061 lekë(37% e fondit limit). Për vitin 2018 realizimi i prokurimeve kundrejt parashikimit, në vlerën lekë, është në masën 58.6%.
-Nga auditimi i dokumentacionit dhe sistemit elektronik të APP, UK Kavajë sh.a **për vitin 2019** ka parashikuar 30 prokurime me fond limit në vlerë 50,506,825 lekë, nga të cilat 23 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në vlerën 15,286,925 lekë dhe 7 procedura prokurimi "Kërkesë për propozim" me fond limit në vlerë 35,2019,900 lekë. Gjatë këtij viti janë realizuar 10 procedura prokurimi, nga këto 9 procedura prokurimi blerje të vogla, me fond limit në vlerë 7,786,925 lekë e me vlerë të realizuar 6,488,499 lekë, diferenca midis vlerës së fondit limit dhe asaj të realizuar është 1,298,426 lekë (16.7% e fondit limit). Gjithashtu është realizuar 1 procedurë prokurimi "Kërkesë për propozim" me fond limit në vlerë 6,000,000 lekë e me vlerë të kontraktuar 4,299,900 lekë, diferenca midis vlerës së fondit limit dhe asaj të kontraktuar është 1,700,100 lekë (28.3% e fondit limit). Për vitin 2019 realizimi i prokurimeve kundrejt parashikimit, në vlerën lekë, është në masën 27.3%.
Grupi i auditimit i ka audituar të gjitha procedurat e prokurimit të realizuara për periudhën objekt auditimi.

1. Titulli i gjetjes: Procedura prokurimi, të kryera jo plotësisht konform dispozitave ligjore.

Situata:

-Në 3 procedura prokurimi për vitin 2018 në vlerën 8,828,939 lekë dhe 1 procedurë për vitin 2019 në vlerën 4,299,900 lekë, nuk ka gjurmë të studimit të tregut, referim të kontratave të ngjashme, apo të dhëna referuar INSTAT, për të bërë të qartë mënyrën e përllogaritjes së fondit limit të kësaj procedurë, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", i ndryshuar, neni 59 "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës".
-Për një procedurë prokurimi për vitin 2019 "Blerje Karburanti" me vlerë 4,299,900 lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk është përcaktuar kufiri për marzhin e fitimit dhe nuk ka asnjë dokument që argumenton mungesën e përcaktimit të këtij elementi në DST, i cili shërben si kufi për të mbajtur një çmim të arsyeshëm dhe me ekonomicitet për shoqërinë duke minimizuar kostot e panevojshme. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.
-Në procedurën e prokurimit në vlerën, 2,954,789 lekë "Blerje Karburanti" për vitin 2018, referuar sistemit elektronik të APP, në skedarin e vlerësimit është konstatuar se dy nga anëtarët e KVO-së, nuk e kanë kualifikuar operatorin ekonomik A&T sh.p.k, megjithatë në

kualifikimin përfundimtar ky operator është shpallur fitues i kësaj procedure. Në dosjen shkresore të prokurimit nuk gjendet asnjë gjurmë e cila justifikon kualifikimin e këtij operatori të shpallur fitues, gjithashtu KVO nuk ka dokumentuar me raport përmbledhës të nënshkruar nga çdo anëtar i KVO,vazhdimin e procedurës për miratim nga titullari i AK. Përsa më sipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë,veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave.

-Ne 7 procedura me blerje të vogël për vitin 2018 në vlerën 5,031,500 lekë dhe 10 procedura me blerje të vogël për vitin 2019 në vlerën 6,488,499 lekë , në të gjitha rastet e blerjes së mallrave dhe shërbimeve të planifikuara dhe jo të planifikuara , u konstatua se kërkesa e bërë për mallin apo shërbimin ishte formale pa argumentin e nevojës së kryerjes së shpenzimit nga specialistë të fushës dhe ku shpesh herë kjo kërkesë nuk kishte konfirmimin e magazinierit. Gjithashtu marrja në dorëzim e mallrave referuar procedurave me blerje me vlerë të vogël konfirmonte thjesht marrjen në dorëzim (konfirmim që e bën dhe magazina me fletë hyrjen e mbajtur) dhe jo marrjen në dorëzim konform specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

- Në të gjitha procedurat e prokurimit dhe procedurat e prokurimit me blerje të vogël për periudhën 2018-2019, dosjet e vëna në dispozicion të grupit të auditimit janë të pasakta nga ana e rregullave të arkivimit, kjo në kundërshtim me ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", dhe në Rregulloren "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH", neni 13.

- Në të gjitha procedurat e prokurimit dhe procedurat e prokurimit me blerje të vogël për periudhën 2018-2019, dosjet e vëna në dispozicion të grupit të auditimit nuk gjenden deklaratat e konfliktit të interesit të nënshkruara nga anëtaret e komisioni të prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me, VKM Nr. 914, date, 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 11.

-Në të gjitha procedurat e prokurimit,blerje me vlerë të vogël për periudhën 2018-2019, janë pasqyruar dhe kanë kryer veprime në sistemin elektronik APP, "Njësi Prokurimi" dhe "Komision Vlerësimi të Ofertave", në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar.

- Në 7 procedura prokurimi për vitin 2018, blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 5,031,500 lekë (pa TVSH) dhe në 7 procedura prokurimi për vitin 2019 , blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 5,586,925 lekë (pa TVSH), konstatohet se: Znj.F.Gj me detyrë Drejtor Tregtar i Shoqërisë UKK është njëkohësisht edhe kryetare komisioni e blerjes me vlerë të vogël, në kundërshtim me ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 22, pika 5.

- Në 1 procedurë prokurimi për vitin 2019 , blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 800,000 lekë (pa TVSH), specifikimet teknike (vizatimet) janë në gjuhë të huaj, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 14, pika 2, paragrafi 3.

- Autoriteti Kontraktor Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kavajë sh.a për periudhën objekt auditimi viti 2018 dhe viti 2019, për çdo artikull mallrash të blerë nën vlerën 100,000 lekë (rreth 234 urdhra prokurimi), ka përdorur ligjin e prokurimit publik pavarësisht vlerës së mallit duke i trajtuar si blerje emergjente të cilat nuk i ka pasqyruar as në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike dhe nga mungesa e një plani ekonomik të detajuar

sipas nevojave të çdo sektori, ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.914 "Për rregullat e prokurimit publik",i ndryshuar,pika 2,paragrafi 2 ku thotë në mënyrë eksplicite":"Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100,000 lekë deri në 800,000 lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlerë të vogël, siç përshkruhet në nenin 40 të këtyre rregullave. Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100,000 lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë".

- Stafi i organizimit të Procedurave të Prokurimeve në Ujësjellës Kanalizime Kavajë nuk ka kryer asnjë trajnim pranë APP për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me LPP (Ligjin për Prokurimin Publik) dhe VKM nr.914 "Për rregullat e prokurimit publik",i ndryshuar.

Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e Autoritetit Kontraktor dhe anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për periudhën objekt auditimi.(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-48, të Raportit Përfundimtar të auditimit)**Kriteri:**Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar, ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin",

Ndikimi/efekti:. Shmangie e procesit të rregullt të procedurave të prokurimit publik.

Shkaku: Keq interpretime të akteve ligjore dhe nëligjore të procedurave të prokurimit publik.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi:

Për rritjen e efiçencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kritereve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:

-Nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë, përllogaritja e vlerës së kontratës, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, si dhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, në raport me specifikimet teknike.

-Nga Shoqëria t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.

- Autoriteti kontraktor duhet që në çdo rast nevoje për kryerje shpenzimesh nën vlerën 100,000 lekë pavarësisht nga fakti që nuk do të përdorë procedurë prokurimi, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto objekte të kryhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

- Administratori i shoqërisë duhet të planifikojë programe trajnimi për stafin në lidhje me procedurat e prokurimit dhe përdorimin e sistemit elektronik të APP.

2. Titulli i gjetjes : Nga auditimi i procedurave të prokurimeve "Kërkesë për Propozim" dhe procedurave blerje me vlerë të vogël, për vitin 2018 dhe vitin 2019 është konstatuar problematika e copëzimit të fondeve.

Situata : a. Nga auditimi i dy procedurave të realizuara në vitin 2018, konstatohet se janë mallra të të njëjti grupim dhe nga mbledhja e vlerave të përllogaritura për procedurat e kryera me vlerë të vogël respektivisht për procedurën "Blerje hipoklorit" 800,000 lekë dhe 790,000 lekë për procedurën "Blerje hipoklorit kalciumi dhe hipoklorit natriumi",Autoriteti Kontraktor duhet të kishte përdorur një procedurë tenderi mbi kufirin e fondit për procedurat me blerje të vogël, por ndërkohë ka kryer copëtim fondi duke realizuar dy procedura blerje të vogël për të njëjtin grupim mallrash në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me blerje të vogël", pika 4 ku citohet se "Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë dhe i përfshin ato në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik.Autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë njëherësh të gjithë sasinë e mallrave,shërbimeve apo të punëve për plotësimin e nevojave të veta. Autoriteti kontraktor mund të realizojë disa procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik, në varësi të nevojave dhe mundësive të tij, por vlera e përllogaritur në total e këtyre procedurave për të njëjtin mall/shërbim/punë ose grup mallrash/shërbimesh/punësh, nuk duhet të jetë më e madhe se 800.000 (tetëqindmijë) lekë në vit dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 , i ndryshuar.Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e Autoritetit Kontraktor për periudhën objekt auditimi dhe anëtarët e komisionit te prokurimit me vlere te vogël sipas urdhrit nr. 03 datë 17.01.2018, të titullarit për krijimin e komisionit për prokurimit me vlerë të vogël.

b. Për vitin 2018 Autoriteti Kontraktor përpara se të kryente procedurën "Kërkesë për Propozim" me objekt "Blerje Diesel", është konstatuar se, ka prokuruar një shtesë kontrate me objekt "Blerje Diesel" të kontratës bazë nr.648, datë 30.06.2017 me operatorin e mëparshëm, me vlerë 532,362 lekë, pa përcaktuar litrat e karburantit, pa përcaktuar as datën e lëvrimit të mallit.Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën Kërkesë për propozim "Blerje Karburanti" me vlerë 2,751,200 lekë pa Tvsh por nuk ka përfunduar procedurat për lidhjen e kontratës edhe pse ka publikuar operator fitues.Gjatë periudhës së publikimit të operatorit fitues, Autoriteti Kontraktor ka vazhduar të prokurojë, Blerje me Vlerë të Vogël 600 litra Diesel 10 ppm,me shënimin që ky karburant duhet për nevojat emergjente të ndërmarrjes pa analizë gjendje në magazine,likujduar me faturën nr.369, datë 18.04.2018 në vlerën 79,625 lekë pa TVSH.
Nga Autoriteti Kontraktor, në asnjë rast nuk është paraqitur një analizë e saktë e gjëndjes së karburantit/diesel sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, të vërtetuar me dokumentacion mbi lëvrimin e karburantit si dhe nuk pasqyrohet me fleta udhëtimi dhe urdhra shërbimi harxhimi i karburantit nga mjetet e UK Kavajë sh.a, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30,datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kapitulli III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" Dokumentimi i lëvizjeve pikat 34, 35/b, 38 dhe 39.
Përsa më sipër vlera e prokuruar me procedurën e emergjencës prej 258,508 lekë pa TVSH, likujduar me faturat nr.369, datë 18.04.2018 në vlerën 79,625 lekë pa TVSH, nr.399, datë 25.04.2018 në vlerën 53,333 lekë pa TVSH, nr.399, datë 25.04.2018 në vlerën 53,333 lekë pa TVSH, konsiderohet copëtim i fondeve duke realizuar një procedura me blerje të vogël dhe

një procedure "Kërkesë pë Propozim" ,brenda të njëjtit vit për të njëjtin grupim mallrash në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me blerje të vogël", pika 4 ku citohet se "Autoriteti kontraktor planifikon natyrën, sasitë dhe llojet e mallrave, shërbimeve dhe zërat e punëve që do të prokurohen në këtë mënyrë dhe i përfshin ato në regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit publik.Autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të prokurojë njëherësh të gjithë sasinë e mallrave,shërbimeve apo të punëve për plotësimin e nevojave të veta. Autoriteti kontraktor mund të realizojë disa procedura prokurimi me vlerë të vogël gjatë vitit kalendarik, në varësi të nevojave dhe mundësive të tij, por vlera e përllogaritur në total e këtyre procedurave për të njëjtin mall/shërbim/punë ose grup mallrash/shërbimesh/punësh, nuk duhet të jetë më e madhe se 800.000 (tetëqindmijë) lekë në vit dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 , i ndryshuar.Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e Autoritetit Kontraktor për periudhën objekt auditimi dhe anëtarët e komisionit te prokurimit me vlere te vogël sipas urdhrit nr. 03 date 17.01.2018 të titullarit për krijimin e komisionit për prokurimit me vlerë të vogël.

c. Për vitin kalendarik 2019 është konstatuar copëzimi i fondeve për mallrat, tuba e rakorderi, klor dhe kapakë pusetash, si më poshtë:
-Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se, AK ka zhvilluar procedura për "Blerje Tuba Uji", me fond limit 795,000 lekë (pa tvsh), dhe "Blerje Rakorderi", me fond limit 791,925 lekë (pa tvsh). Këto mallra përfshihen ne te njëjtin grup dhe kane te njëjtin funksion kryesor dhe duhet te prokuroheshin se bashku. Vlera totale, prokuruar e copëzuar, 1,586,925 lekë (pa tvsh) duhej të prokurohej në një procedure të vetme**.**
-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për mallin "Klor" AK ka zhvilluar procedura, blerje me vlerë nën 100,000 lekë (pa TVSH), blerje me vlerë të vogël, me fond limit 800,000 lekë (pa TVSH) dhe blerje me vlerë të vogël me fond limit 600,000 lekë (pa TVSH). Vlera totale, prokuruar e copëzuar 1,500,000 lekë (pa tvsh) duhej të prokurohej në një procedure të vetme.
- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për mallin "Kapak pusetash" AK ka zhvilluar procedura, blerje me vlerë nën 100,000 lekë (pa TVSH) dhe blerje me vlerë të vogël me fond limit 800,000 lekë (pa TVSH Vlera totale, prokuruar e copëzuar, 900,000 lekë (pa tvsh) duhej të prokurohej në një procedure të vetme.

Kriteri: VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, dhe Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël"i ndryshuar, pika 3.
Ndikimi/Efekti: Mund të shkaktojë premisa për shmangien e kryerjes së procedurave normale të prokurimit si dhe rritjen e shpenzimeve të pa nevojshme të shoqërisë duke vendosur atë në vështirësi financiare
Shkaku: Mosveprim i komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, sipas kërkesave të LPP-së.
Rëndësia: E mesme.
Rekomandim: Titullari i Ujësjellës Kanalizime Kavajë sh.a, njësia e prokurimit, të marrin masa që në të ardhmen, të shmangë këto praktika duke mos copëzuar fondet për mallra të së njëjtës kategori.

3. Titulli i Gjetjes: Moszbatim i legjislacionit i Prokurimit Publik, në shpalljen e ofertës fituese.
Situata: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit public për vitin 2019, blerje me vlerë të vogël, u konstatua mungesa e plotësimit të kritereve të veçanta të vendosura në DST

nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël. Mosplotësimi i kritereve të veçanta në procedurat e prokurimit është si më poshtë:

a. Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Kompjuter dhe Printera", konstatohet se likuidimi i mallit është bërë sipas faturës tatimore, Nr. 178, datë 04.03.2019, me vlerë 450,000 lekë (pa TVSH), për llogari të operatorit ekonomik fitues "F…". Magazinimi i mallit ka fletë-hyrje Nr. 33, datë 04.03.2019. Gjithashtu, konstatohet se, në asnjë dokument të marrjes dhe te daljes nga magazina, nuk gjenden të shënuara numrat serial të pajisjeve të përfituara në këtë procedurë, kështu që gjurmimi i tyre bëhet i pa mundur, për rrjedhojë, grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve, veprim në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave, Nr. 30, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Referuar DST, në specifikimet teknike është kërkuar që për mallrat e prokuruara duhet të paraqitet garanci, me afat kohor minimumi 2 vjet, nga OE fitues. Në dosje, gjendet fleta e garancisë e lëshuar nga OE "F…", datë 04.03.2019. Në fletë garanci nuk janë të shënuara Nr. serial i pajisjeve të përfituara nga kjo procedure, si dhe nuk janë përshkruar kushtet e garancisë në rast se do të nevojitet. Për sa më sipër, garancia e ofruar nuk mund të jetë me efikasitet të plotë, në rast të problemeve që mund të kenë pajisjet për periudhën 2 vjeçare.

Mosplotësimi i kërkesave të mallit të prokuruar sipas specifikimeve teknike te DST, si edhe mungesa e numrave serial në faturën tatimore dhe në garancinë e paraqitur, **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën 450,000 lekë.**

b. Në DST për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Tuba Uji", është kërkuar që mallrat duhet të shoqërohen me dokumentin teknik përkatës, ndër to edhe:

- Certifikata e origjinës së prodhimit të materialit të PE nga prodhuesi (B, S, B, E ose ekuivalent), e shoqëruar me tipin e materialit, llojin dhe të dhënat teknike.
- Certifikata e testimit të tubave dhe pjesëve speciale nga prodhuesi. Ovaliteti i tubave nuk duhet të jetë me i madh se 1.5 %.

Nga auditimi i dosjes konstatohet se të dy certifikatat e mësipërme mungojnë, kështu që OE "2…", është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Mos shoqërimi i mallit të prokuruar me certifikatat e kërkuara në DST që vërtetojnë plotësimin e specifikimeve teknike sipas standardeve, konsiderohet **shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 695,000 lekë.**

c. Në DST për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Rakorderi" është kërkuar që, mallrat të shoqërohen me dokumentacionin teknik përkatës:

- Certifikata e origjinës së mallit nga prodhuesi i materialeve.
- Certifikata e origjinës së prodhimit të materialit të PE nga prodhuesi (B, S, B, E ose ekuivalent) e shoqëruar me tipin e materialit, llojin dhe të dhënat teknike të përshkruara.

Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit, blerje me vlerë te vogël, me objekt "Blerje Rekorderi", konstatohet se certifikata e origjinës së mallit nga prodhuesi i materialeve mungon në dosje, dhe certifikata e origjinës së prodhimit të materialit PE, është në gjuhë të huaj, kështu që, OE " T…" është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Mos shoqërimi i mallit të prokuruar me certifikatat e kërkuara në DST, që vërtetojnë plotësimin e specifikimeve teknike sipas standardeve, konsiderohet **shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 670,000 lekë.**

d. Në dokumentat e procedurës së prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Tonera", është kërkuar që: "Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor (në rastet kur kërkohet), dokumentet si më poshtë:

- Certifikatë qe vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001-2008/ISO 9001-2015.
- Certifikatë OHSAS -18001-2007 (ose ekuivalente të vlefshme) për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në punë.

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kriteret e mësipërme, kështu që OE "I…", është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Mos shoqërimi i mallit të prokuruar me certifikatat e kërkuara në DST, që vërtetojnë plotësimin e specifikimeve teknike sipas standardeve, konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 660,000 lekë.

5. Për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Kaseta Matësash", nga auditimi i sistemit elektronik të APP, në skedarin "Njoftimi i Fituesit", OE "D…" është publikuar fitues në datë 01.07.2019, ora 09:47, sipas procesverbalit Nr. 1, datë 01.07.2019, i cili nuk ka konfirmuar pjesëmarrjen, kështu që është kaluar në OE të radhës, por konstatohet se, OE "A…" i renditur në vendin e dytë, është publikuar fitues në datë 01.07.2019, ora 10:09, kjo në kundërshtim me afatin e përcaktuar nga vetë AK në DST. Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të konfirmoje pjesëmarrjen pranë autoritetit kontraktor brenda 2 orëve nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Gjithashtu, afati i publikimit midis vendit të tretë, të katërt dhe të pestë, si dhe vendit të gjashtë me të shtatë, nuk është respektuar nga AK. Në dosje nuk gjenden gjurmë që justifikojnë këto veprime të komisionit të vlerësimit.

Mosrespektimi i afatit të përcaktuar për të konfirmuar pjesëmarrjen nga OE i publikuar fitues "D…" ka sjelle që, diferenca midis ofertës se OE "D…" me vlerë 468,000 lekë (pa TVSH)" dhe OE fitues "A…" me vlerë 749,999 lekë (pa TVSH), **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 281,999 lekë.**

e. Në DST për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Matësa Uji", kërkohen të plotësohen kriteret e më poshtme:

- Vërtetimin se OE i shpallur fitues, duhet të ketë shlyer të gjitha taksat (qendrore dhe vendore)Vërtetim nga OSHEE se objekti nuk ka detyrime të pashlyera.

Matësi i Ujit: (Të ofrojë mundësinë dhe të jete kompatibël me teknologjinë e Leximit Automatik të Matësi),

Vulat: (Të kenë logon "Ujësjellës Kanalizime Kavajë", 6 numra serial unik të njëpasnjëshëm në pjesën e përparme të trupit (pjesa femërore).

Çelsat e bllokuesve: (Njeri krah i çelësit duhet të jetë i veshur me material plastik ose qeramike).

Nga auditimi i dosjes, konstatohet se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kriteret e mësipërme, kështu që OE "A…", është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Mosplotësimi i kërkesave të mallrave (matësa uji, vula dhe çelësave të bllokuesve) të prokuruar sipas specifikimeve teknike të DST, vlera e përfituar konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 750,000 lekë (pa TVSH).

f. Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Klor", sipas kualifikimit përfundimtar, dokumentuar me procesverbalin Nr.1 datë 25.07.2019 konstatohet se OE fitues "A…" renditet në vendin e 11 (njëmbëdhjetë). Shpallja fitues i OE "A…" është në kundërshtim me udhëzimin Nr.3, datë 8.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", ku përcaktohet se: "Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël do të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të prokurimit vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e 10 (dhjetë) të klasifikimit", i ndryshuar. Për sa më sipër kjo procedurë prokurimi duhej të anulohej.Mos anulimi i procedurës së prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Klor" vlera e përfituar nga OE "A…" **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 800,000 lekë (pa TVSH).**

g. Për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Kapak Pusetash" në sistemin elektronik në skedarin "Njoftimi i Fituesit" konstatohet se OE "A…" me ofertën më të ulët është publikuar fitues me datën 02.09.2019 ora 11:43 dhe OE në vendin e dytë është publikuar fitues me datën 02.09.2019, ora 13:11, pra nuk është pritur dy orë për të publikuar fitues OE të renditur në vendin e dytë. Ky veprim është në kundërshtim me kërkesën e vetë AK në DST ku thuhet se OE i shpallur fitues duhet të konfirmojë pjesëmarrjen brenda dy orëve. Në dosje nuk gjenden dokumenta që justifikojnë veprimin e mësipërm.Mosrespektimi i afatit të përcaktuar për të konfirmuar pjesëmarrjen nga OE i publikuar fitues "A…" ka sjellë që, diferenca midis ofertës së OE "A…" me vlerë 695,400 lekë (pa TVSH)" dhe OE fitues "E…"me vlerë 789,000 lekë (pa TVSH), **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 93,600 lekë (pa TVSH).**

Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik.

Ndikimi/Efekti: Vlera e kontratës është përdorim i fondeve publike në kundërshtim me kërkesat ligjore.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjor, për prokurimin publik

Rëndësia: e Lartë

Rekomandime:

-Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjellë si pasojë fitues një OE që ka patur mangësi në dokumentacion, që nuk është evidentuar nga ana e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël.

-Për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Kompjuter dhe Printera", AK ti kërkojë OE fitues "F…" te paraqesë një garanci, për mallrat e përfituara, ku të shënohet numri serial për çdo pajisje, gjithashtu kjo garanci të shoqërohet me kushtet e saj.

Përsa më sipër janë mbajtur aktkonstatimet nr.4, nr.5, nr.7, nr.8, nr.9, nr.10, datë 21.02.2020 1.Në përgjigje të observacionit të datës 09.04.2020 të dërguar nga Znj. F.Gj, Z. M.SH dhe Z. E.S si anëtar të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël në procedurën e prokurimit me objekt "Blerje Kapak Pusetash", Nr. REF-34630-08-30-2019 ,për projektraportin e dërguar në UKKA SHA, ju sqaroj si më poshtë vijon:

Në procedurën me objekt "Blerje Kapak Pusetash", Nr. REF-34630-08-30-2019, me datë zhvillimi 02.09.2019, referuar gjetjeve në Akt Konstatimin nr. 5, datë 21.02.2020, ju sqarojmë se;
- Tërheqja e operatorit ekonomik "A..." duke u paraqitur fizikisht në zyrat e ndërmarrjes duhet të ishte dokumentuar dhe të bëhej pjesë e dosjes ku të jepeshin arsyet që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit, kjo referuar Udhëzimit Nr.3, datë 08.01.2018, i ndryshuar, pika 15, paragrafi 5 ku thuhet se; "Si regull, në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, ofertuesi i renditur në vend të parë, duhet të njoftojë autoritetin kontraktor brenda afatit kohor të përcaktuar në ftesën për ofertë. Në njoftim duhet të jepen arsyet, që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit". Gjithashtu email i bashkangjitur këtij observacioni nuk merret parasysh se është një veprim i kryer pas faktit.
- Ju theksoni se operatori ekonomik "A..." nuk ka bërë ankesë për këto veprime në faqen APP por kjo gjë nuk është e mundur referuar Udhezimit Nr.3, datë 08.01.2018, i ndryshuar, pika 10, ku thuhet se;"Duke qenë se, procedurat e prokurimit me vlerë të vogël janë procedura të thjeshtuara, për këto procedura nuk zbatohen dispozitat e nenit 56 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, për ofertat anomalisht të ulëta, si dhe dispozitat e nenit 63 të po këtij ligji, për ankimimin administrative."Për sa më sipër observacioni juaj nuk merret parasysh, shuma 93,600 lekë do të jetë dëm ekonomik në ngarkim të antarëve të komisionit të prokurimit me vlerë të vogël.

VIII. *Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.*

1. Titulli i Gjetjes: Mjedisi i kontrollit në shoqërinë UKKa, për periudhën objekt auditimi, rezulton jo efektiv.

Situata: Mjedisi i kontrollit përbën bazën ku ngrihen të gjithë komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit duke siguruar disiplinën dhe strukturën. Mjedisi i kontrollit përbëhet nga dy aspekte: strukturat formale dhe aspektet e sjelljes individuale.

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në shoqërinë UKKa, grupi audites kreu verifikimet mbi implementimin dhe plotësimin e kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura, dhe për mjedisin e kontrollit u konstatua që:

- Administratori i Shoqërisë UKKa, nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Këshillin Teknik të Shoqërisë UKKa.
- Shoqëria UKKa nuk ka hartuar plan biznesi afatgjatë, duke operuar pa program ekonomik për periudhën objekt auditimi.
  Shoqëria UKKa është e pa orientuar strategjikisht. Mungesa e Planit të biznesit ka ndikuar në përcaktimin e objektivave strategjik, të cilat duhen të jenë specifikë, të matshëm dhe me afate kohore të përcaktuara.
- UKKa, nuk e ka miratuar statutin e shoqërisë nga Këshilli i Administrimit.
- Rregullorja e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin e Strukturave dhe Detyrave në Ujësjellës Kanalizimin SH.A., Kavajë, e miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit Nr. 97/5 Prot. datë 10.02.2017, është në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 63 date 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", pasi;

a)Rregullorja e Brendshme e UKKa, ka mos përputhje me strukturën organizative të miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 768/4 Prot. datë 02.08.2017;
b) Rregullorja i referohet UKD (Ujësjellës Kanalizime, Durrës) dhe jo Ujësjellës Kanalizime, Kavajë;
c)Rregullorja i referohet Këshillit Mbikëqyrës dhe jo Këshillit të Administrimit, si organ drejtues në Shoqërinë UKKA.
Për sa më lart, në ligjin nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, parashikohet sistemi me një dhe dy nivele administrimi për shoqëritë aksionare. Në sistemin me dy nivele, qartazi janë ndarë funksionet e kontrollit të këshillit mbikëqyrës dhe ato të administrimit për administratorin. Ndërsa në sistemin me një nivel (rasti i shoqërisë UKKa), ligji i sipërcituar, parashikon Këshillin e Administrimit si të vetmin organ që ushtron të dy funksionet, të administrimit dhe të mbikëqyrjes. Gjithashtu në VKM-në Nr. 63 datë 27.01.2016, pika 2, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", përcaktohet që: *Të gjitha njësitë e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, organizohen si shoqëri aksionare, sipas sistemit me një nivel administrimi dhe funksionojnë në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."*

- Administratori i shoqërisë për përudhën respektive brenda objektit të auditimit, nuk ka deleguar kompetencat ose detyrat anëtarëve të caktuar të stafit drejtues, sipas objektivave dhe detyrave te shoqërisë, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit për MFK.
- Përgjatë vitit 2018-2019, nr. i përgjithshëm i punonjësve të UKKa, rezulton të ketë rritje në krahasim me numrin e përgjithshëm të punonjësve të miratuar me Vendim[1] të Këshillit të Administrimit nr. 768/4 Prot. datë 02.08.2017.
  Administratori përkatës për periudhën respektive të ushtrimit të funksionit, brenda periudhës objekt auditimi, ka rritur numrin e strukturës organizative me punonjës përtej numrit të përgjithshëm të strukturës së miratuar nga KA, dhe në fund të vitit 2019, Shoqëria UKKa rezulton me 304 punonjës[2].
  Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kavajë në fund të vitit 2019, rezulton me 25,124 lidhje (abonentë), pra çka tregon që UKKa ka 12.5 punonjës për 1,000 lidhje, duke e renditur UKKa me treguesin më të larte të nr. të punonjësve për 1,000 lidhje krahasuar me standardet dhe mesataren kombëtare të ujësjellës kanalizimeve në vend, që është rreth 4.5-6 punonjës për 1,000 lidhje.
- Administratori i Shoqërisë UKKa, për periudhën respektive brenda periudhës objekt auditimi, nuk ka kryer vlerësime periodike të stafit të shoqërisë (ngritje ose ulje në detyrë) mbi performancën dhe realizimin e detyrave të punonjësve, mbi bazën e përshkrimeve të detyrave në kontratën e punës dhe rregulloren e përgjithshme.
- Sektori i marrëdhënieve me publikun pranë shoqërisë UKKa, trajton ankesat e qytetarëve në lidhje me shërbimin e ofruar. Qytetarët që kanë ankesa për shërbimin e ofruar nga Shoqëria UKKa, paraqiten pranë këtij sektori duke plotësuar formularin e ankesave. Punonjësit e këtij sektori i regjistrojnë ankesat e qytetareve manualisht dhe jo në sistemin informatik "Albilling", i cilin e mundëson regjistrimin e tyre në modulin "regjistrimi i ankesave".

[1] *Nr. i përgjithshëm i miratuar me vendim të KA, është 152 punonjës*
[2] *Listë pagesa e muajit Nëntor 2019, me urdhër xhirimi nr.340 datë 06.12.2019, në vlerë totale 8,842,368 lekë*

Për vitin 2018 në Shoqërinë UKKa, janë regjistruar 77 ankesa të përgjithshme (kryesisht ankesat janë për mbifaturim) dhe 61 ankesa për probleme inxhinierike. Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 131 ankesa të përgjithshme dhe 116 për probleme inxhinierike. Trajtimi i ankesave të qytetarëve bëhet nga departamente/ drejtori/ sektor përkatës ku është adresuar ankesa.

- Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë nuk ka nënshkruar kontratë me Administratorin e Shoqërisë UKKa, për realizimin e objektivave dhe tregueseve sasior dhe cilësor të matshëm të performancës të shoqërisë, për rritjen e treguesve ekonomiko financiar dhe të cilësisë së shërbimit të ofruar ndaj qytetarëve.
- Administratori i shoqërisë UKKa, për vitin 2018-2019, nuk ka parashikuar programe trajnimi për stafin, për njohjen dhe zbatimin e Ligjit të MFK dhe Prokurimeve Publike, megjithëse prej stafit vlerësohet si e nevojshme.
- Shoqëria UKKa, nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit për arkivat dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve. Nga auditimi u konstatua që: a) dokumentet e arkivuara nuk janë të dokumentuara në regjistrin e hyrjeve-daljeve; b) nuk janë përpiluar pasqyrat emërtuese në regjistër, në bazë të gjitha kritereve arkivore të cilat janë: të objektit, të autorit, të korrespondentit, të ndarjes territoriale–administrative, të llojit të dokumentit, të kohës; c) pasqyra emërtuese nuk është miratuar nga administratori i shoqërisë.

Kriteri: Ligji nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, VKM nr. 63 datë 27.01.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Ligji për MFK, nenin 20 "Mjedisi i kontrollit", Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe Rregullorja "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH"

Ndikimi/Efekti:Rritja e efektivitetit të shoqërisë për arritjen e objektivave të vendosura, krahas përcaktimit të misionit, strategjisë në mënyrë të veçantë duhet të fokusohet në drejtim të hartimit dhe monitorimit të planeve konkrete të veprimit, të cilat duhet të përmbajnë afatet kohore dhe personat përgjegjës për realizimin e tyre. Përcaktimi i këtyre objektiva duhet të jenë sanksionuar në marrëveshjen e performancës midis Administratorit të Shoqërisë dhe Këshillit të Administrimit, dhe Asamblesë Përgjithshme të Shoqërisë. Mungesa e hartimit dhe miratimit të dokumenteve strategjik dhe rregullator e ka vendosur shoqërinë UKKa, në një situatë të vështirë ekonomiko financiare dhe ta pa orientuar strategjikisht.

Shkaku: Mos respektimi i Ligjit të MFK, VKM-së nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" dhe akteteve rregullatore.

Rëndësia: E lartë

Rekomandime 1: Administratori i shoqërisë të marrë masa, për hartimin dhe miratimin e statutit, rregullores së brendshme dhe plan biznesit afatgjatë.

Rekomandimi 2: Administratori i shoqerisë të miratoj pasqyrën emertuese për dosjet e arkivuara dhe të marri masa për rregjistrimin e tyre.

2. Titulli i Gjetjes: Në Shoqërinë UKKa, nuk funksionon një sistem efektiv për menaxhimin e riskut.

Situata: Menaxhimi i riskut mund të thuhet se është po aq i zhvilluar sa janë edhe aktivitetet e kontrollit. Aktivitetet e kontrollit përqendrohen jo vetëm në çështjet e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë, por edhe në çështje që lidhen me dhënien e sigurisë, se objektivat e vendosura do të arrihen. Në drejtim të vlerësimit për menaxhimin e riskut, u konstatua që:

- Shoqëria UKKa nuk ka hartuar regjistër risku për identifikimin, kategorizimin, ndjekjen dhe minimizimin e risqeve që mund të shfaqen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.
- Shoqëria nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë një raport vjetor mbi problematikat e hasura.
- Koordinatori i riskut nuk është emëruar, por funksionet e tij, i kryen Administratori i shoqërisë sipas përcaktimeve në MFK.

Kriteri: Ligji 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik".

Ndikimi/Efekti: Mungesa e regjistrit të riskut ka ndikuar në mos identifikimin dhe kategorizimin e risqeve potenciale, që mund të shfaqen gjatë veprimtarisë së shoqërisë për parandalimin e ndodhjes së tyre.

Shkaku: Mungesa e strategjisë dhe regjistrit të riskut për identifikimin dhe kategorizimin e risqeve pontenciale që mund të shfaqen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë UKK

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime: Administratori i Shoqërisë në bashkëpunim me Këshillin e Administrimit të marrë masa, për hartimin dhe miratimin e politikave të menaxhimit të riskut.

3. Titulli i Gjetjes: Shoqëria ka mangësi në aktivitetet e kontrollit.

Situata: Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në drejtim të vlerësimit te komponentit te MFK për "*aktivitet e kontrollit"*, u konstatua që:

- Shoqëria nuk ka ngritur Njësinë e Auditit të Brendshëm.
- Shoqëria UKKa nuk ka përgatitur hartën e proceseve dhe gjurmëve të auditit.
- Shoqëria UKKa, nuk ka të regjistruar asetet e saj dhe nuk ka evidentuar vlerat e aktiveve afatgjata, të cilat nuk janë të përditësuara në një regjistër të posaçëm në lidhje me kronologjinë e vlerës ndër vite, rivlerësimin, amortizimin etj., probleme të mbartura ndër vite.
- Administratori i shoqërisë nuk ka paraqitur deklaratën e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm të UKKa, si edhe Raportin e Vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.
- Shoqëria UKKa, përdor sistemin informatik "*Albilling*" për faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave.

  Nga analizimi i raporteve që gjeneron sistemi konstatohet që, ka problematika si në drejtim të numrit të limituar të raporteve që gjenerohen, por dhe në drejtim të cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave.

  Gjatë analizimit të të dhënave p.sh., duke krahasuar të dhënat e një abonenti mbi bazën e numrit të kontratës, rezulton që në paraqitjen e "*raportit mujor të arkëtimit*" dhe "*raportit mujor me zëra*", rezultojnë të dhëna të ndryshme. Gjithashtu në raportet e gjeneruara nga sistemi informatik *"Albilling",* gjatë eksportimit të të dhenave në formatin "*excel*", ato nuk ruajnë parametra të njëjtë të renditjes për çdo muaj.
- Sistemi informatik *"Albilling",* nuk ka *"backup"* të bazës së të dhënave, duke cenuar sigurinë e tyre.
- UKKa, nuk ka hartuar rregullore në nivel administrimi për përdoruesit e sistemit *"Albilling".*

- Në sistemin informatik *"Albilling"* nuk pasqyrohen abonentët pa matësa.
  Në rubrikën "raport mbi abonentët" nuk pasqyrohet nr. i abonentëve me dhe pa matësa. Në fund të vitit 2019, nr. i abonentëve familjare pa matësa ishte 17,077, kjo e dhënë është marrë nga Drejtoria e Shitjeve pranë UKKa dhe jo nga sistemi, i cili nuk e pasqyron këtë të dhënë.
- UKKa nuk ka laborator për kryerjen e analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike për monitorimin e cilësisë së ujit, në kundërshtim me VKM 379 datë 25.05.2016. Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm".
- Laboratori i analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike në ITUN pranë UKKa, nuk funksionon.
- Sistemi SCAD funksionon vetëm në pikën e furnizimit me ujë, në Çermë të Lushnjës. Ky sistem nuk është i shoqëruar me manual shpjegues, dhe nuk gjeneron raporte mbi treguesit kryesor. Sistemi SCAD nuk gjeneron *log-in* për të evidentuar gjurmimin në kohë të funksionimit të kësaj pike furnizimi të UKKa, me ujë të pijshëm.
- Sistemi SCAD në ITUN nuk funksionon.

Kriteri: Ligji për MFK, Ligji nr. 114/2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik"**,** VKM 379 datë 25.05.2016, për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm"

Ndikimi/Efekti: Risk i lartë për menaxhimin e fondeve publike.

Shkaku: Mos vlerësimi i duhur nga drejtimi i shoqërisë i dispozitave ligjore në fuqi.

Rëndësia: E Lartë

Rekomandime 3.1: Administratori i Shoqërisë UKKa, të kërkojë nëpërmjet Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme përfshirjen në programet e auditimit të NjAB të Bashkisë Kavaje edhe Shoqërinë UKKa.

Rekomandime 3.2: Administratori i Shoqërisë UKKa, të marrë masa për vënien në funksionim të plotë të sistemit të faturimit të ujit *Albilling*

4. Titulli i Gjetjes: UKKa SHA,nuk ka zhvilluar ende një sistem komunikimi dhe informimi të përshtatshëm dhe efektiv.

Situata: Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Në drejtim të vlerësimit të komponentit të MFK për "*Informacioni dhe komunikimi"*, u konstatua që:

- Në Rregulloren e brendshme të shoqërisë UKKa, nuk është përcaktuar mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave të UKKa.
- Komunikimi i brendshëm dhe jashtë institucionit, bëhet me adresa personale dhe jo me e-mail zyrtar.
- UKKa, nuk posedon faqe Web-i zyrtar. Shoqëria UKKa, nuk ka të publikuar online programin e transparencës**,** në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"
- Zyra e marrëdhënieve me publikun, pranë UKKa nuk shfrytëzon sistemin informatik "*Albilling"* për regjistrimin dhe trajtimin e ankesave të qytetareve.
- Shoqëria UKKa, nuk ka përcaktuar procedura mbi mënyrën e raportimit ditor apo periodik mbi ecurinë dhe realizimin e treguesve ekonomiko financiar të shoqërisë.

Kriteri: Ligji për MFK, neni 23 "Informacioni dhe komunikimi", Ligji nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" , dhe Rregullorja e Brendshme e Shoqërisë

Ndikimi/Efekti:
Shkaku: Mungesa e një komunikimi efektiv, në të gjitha nivelet e hierarkisë së shoqërisë UKKa.
Rëndësia: E mesme
Rekomandime: Shoqëria UKKA SHA, të krijojë faqen e web-it zyrtar, ku te pasqyrojë edhe programin e transparencës, si dhe komunikimin elektronik brenda dhe jashtë institucionit të kryhet me adresë e-mail zyrtar.

5. Titulli i Gjetjes: Në UKKA SHA Kavajë mungon sistemi i monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Situata: Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme, se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efiçente me kalimin e kohës.

- Shoqëria nuk ka ngritur Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB).
- Në Shoqërinë UKKa për periudhën objekt auditimi, nuk është realizuar asnjë program auditimi nga NjAB i Bashkisë Kavajë.
- UKKa, nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2018 dhe 2019, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike".
- **Kriteri:** Ligji i MFK, neni 24 "Monitorimi", Ligji nr. 114/2015, "*Për auditimin e brendshëm në sektorin publik*", VKM nr. 83, datë 03.02.2016, "Për miratimin e kritereve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik", Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike".

Ndikimi/Efekti: Mungesa e vlerësimit nëse sistemi i drejtimit, politikat, veprimtaria dhe kontrolli, kane ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, të kenë mundësuar shërbimeve publike efektive dhe eficente, për të adresuar drejt risqet pontenciale, për të dhënë garanci të mjaftueshme në realizimin e objektivave të vendosura nga SH.A Ujësjellës Kanalizime Kavajë, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarive efektive, efiçente dhe me ekonomicitet, zbatimit dhe pajtueshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe me aktet e brendshme, gjenerimit të informacioneve operative dhe financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit dhe të aktiveve.
Shkaku: Mungesa e Njësisë së Audit të Brendshëm
Rëndësia: E lartë
Rekomandime: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e Njësisë së Auditit të Brendshëm.
Trajtuar më hollësisht në Aktkonstatimin nr.11, datë 21.02.2020

***IX*. Zbatimi i standardeve shtetërore të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura që shkarkohen në mjedis.**
1. Titulli i gjetjes: Prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm nuk është kryer plotësisht në zbatim të standardeve shtetërore.
Situata: Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Kavaje" sh.a kryen veprimtarinë me objekt prodhimin, grumbullimin, përpunimin, shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura. Prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm i popullatës,

enteve private (biznesit) dhe institucioneve shtetërore është me ngritje mekanike, burimet janë ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Uji prodhohet nga, stacioni i pompimit Çermës me gjashtë kaptazhe (puse), stacioni i pompimit Harizaj me tre kaptazhe (puse) si dhe impianti i përpunimit të ujit të pijshëm Maskuria që burim (ujëra sipërfaqësor) ka ujëmbledhësin"Rezervuari i Maskurisë". Stacioni i pompimit të Çermës furnizon depon kryesore që shërben për qytetin e Kavajës dhe depon e Maskurisë gjatë sezonit turistik ku kërkesat për ujë të pijshëm janë të mëdha. Stacioni e Pompimit Harizaj furnizon me ujë të pijshëm depot që shërbejnë për zonën rurale.

-Nga vizita ne terren e grupit te auditimit në Stacionin e Pompit të Çermës dhe kaptazheve (pusçpimet) u konstatua se: kaptashet (veprat e marrjes së ujit) janë në oborrin e shtëpive private të cilat nuk janë të lidhura me një sistem kanalizimesh për largimin e ujërave të ndotura. Ujërat e ndotura grumbullohen në gropa septike të cilat nuk janë të izoluara. Gjithashtu në oborrin e shtëpive, ku ndodhen kaptazhet (puset e ujit) ka dhe stalla bagëtish që mbarështohen nga pronarët. Për të gjitha puset nuk është realizuar plotësisht mbrojtja higjeno-sanitare e kaptazheve (burimet nëntokësore) veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm", neni 11, shtojca IV "Zonat e mbrojtjes sanitare" pika 2 "Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore"

-Nga grupi i auditimit u konstatua se: dezinfektimi i ujit të pijshëm bëhet me metodën kimike me produktet dezinfektuese, hipokloriti i kalciumit dhe hipokloriti i natriumit. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i natriumit bëhet në mënyrë automatike me dozim, në varësi të prurjeve nga kaptazhet, në stacionin e pompimit Çermë. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i kalciumit bëhet në shuarësin e presionit në qytetin e Kavajës si dhe në depon Golem.

Nga auditimi i dosjeve personale të vëna në dispozicion, administruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, për punonjësit që kryejnë dizinfektimin e ujit në periudhën objekt auditimi, Depo/shuarësi i presionit Kavajë z.B.F, Stacioni i Pompimit Çermë z.A.H dhe Depo Golem z.B.V konstatohet se nuk gjenden dëshmi të gjendjes shëndetësore të tyre, në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit te pijshëm", neni 17.

Gjithashtu konstatohet se nuk janë kryer analizat e përbërjes fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm për çdo pus, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit.

Kriteri: Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit te pijshëm",

Ndikimi/Efekti: Risk i Lartë që ujërat e ndotura, substancat dhe preparatet kimike të rrezikshme që vijnë nga banesat qe ndodhen brenda zonës 1 te mbrojtjes, janë ose mund të jenë të pranishme në sasi të tilla që mund të shkaktojnë ndotjen e ujit te pijshëm duke shkaktuar dëme në shëndetin e njeriut.

Shkaku: Mos monitorim i mjaftueshëm nga Administratori i Shoqërisë si dhe organet drejtuese, për cilësinë e ujit të pijshëm.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandime: -Administratori i Shoqërisë duhet të marr masat e nevojshme që analizat e përbërjes fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm për kaptazhet, të kryhen në mënyrë periodike dhe në varësi të ndotjes që krijohet brenda zonës 1, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit si dhe kryerjen e analizave te produkteve dezinfektuese nga ana e ISHP, sipas legjislacionit ne fuqi (VKM Nr. 379, datë 25.05.2016, "Për miratimin e

rregullores Cilësia e Ujit të Pijshëm", neni 14, pika 4), para se ato te përdoren për trajtimin e ujit te pijshëm.
- Administratori i Shoqërisë dhe organet drejtuese duhet të marrin masat e nevojshme që punonjësit, të cilët kryejnë dezinfektimin e ujit të pijshëm dhe janë në kontakt me ujin e pijshëm të jenë të pajisur me dëshmi të gjendjes shëndetësore sipas rregullores për pajisjen me librezë shëndetësore profesionale.
-Shoqëria në bashkëpunim me ISHP të hartojë një rregullore (metodikë) të kryerjes të analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm, në burimet e ujit dhe sistemin shpërndarës, gjithashtu hartimin e një protokolli se si duhet të veprohet në rastet e ndotjes, marrjen e masave në mënyrë rigoroze dhe të menjëhershme, për mbrojtjen e shëndetit publik.

2.Titulli i gjetjes: Largimi dhe përpunimi i ujërave të ndotura dhe normat e lejuara të shkarkimeve në mjedisin pritës jo në përputhje me standardet shtetërore dhe direktivën e Bashkimit Evropian.
Situata: Shoqëria e "Ujësjellës Kanalizime Kavajë" Sh.a. kryen shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për qytetin e Kavajës dhe zonën e plazhit Golem. Largimi i ujërave të ndotura nga qyteti i Kavajës bëhet me vetërrjedhje dhe për zonën Golem me ngritje mekanike nëpërmjet gjashtë stacioneve të pompimit pa presion. Sistemin i kanalizimeve mbledh ujërat e ndotura të familjareve, bizneseve private dhe aktiviteteve industrialeve dhe trajtohen nga impianti i pastrimit te ujërave të ndotura. Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) në Kavajë, është i pari impiant i këtij lloji i ndërtuar në Shqipëri pas viteve 90, ka filluar të funksionojë që nga Tetori i vitit 2005. Vendndodhja e ITUN është në fshatin Qerret, në një distancë 0,6 km larg bregut të detit dhe afërsisht 6 km larg nga qendra e qytetit të Kavajës. Impianti përdor për trajtimin e ujërave të ndotura metodën biologjike, konkretisht metodën e trajtimit me filtër biologjik, të llojit filtër me pikim. Në vitin 2015 kanë përfunduar punimet për zgjerimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura që vijnë nga zona Plazh Golem, për të patur një funksionim fleksibël për të përballuar një shkallë të gjerë prurjesh dhe karakteristikash të ujit të ndotur.
Nga grupi i auditimit në ITUN u konstatua se impianti nuk i kryen të gjitha proceset për pastrimin e ujërave të ndotura, konkretisht:
2.1. Trajtimi paraprak, kryen procesin e eliminimit të mbetjeve dhe copërave të madha, rërëmbledhësi për eliminimin e materialit të trashë në suspensë dhe yndyrëmbledhësi për largimin e vajrave dhe yndyrës. Paisjet që kryenin këtë proces janë në gjendje pune por kërkojnë mirëmbajte të tyre për vazhdimësinë e trajtimit të ujërave të ndotura.
2.2. Trajtimi primar përfshin largimin e pjesshëm të lëndëve në suspensë dhe lëndëve organike me anë të metodave fizike të tilla si sedimentimi, flotimi dhe sitimi. Për të përmirësuar trajtimin primar ose ndryshe trajtimi me fotosinteze përdoret flokulimi i para-ajruar. Në dekantuesin primar, ajrosja, largimi i llumit dhe kalimi i materialit për t'ju nënshtruar proceseve të tjera kryhet nga dy pajisje lundruese (draga) të cilat lëvizin me telekomande. Nga grupi i auditimit u konstatua se këto dy pajisjet lundruese dhe aparaturat (pompa, përzierësi dhe tubat) ishin për një kohë të gjatë jashtë funksionit, këtë e tregonte korrozioni i tyre, e për rrjedhojë proceset e tjera të trajtimit nuk kryheshin.
2.3. Trajtimi sekondar kryhen largimin i lëndëve organike të tretura dhe koloidale, si dhe i lëndëve të ngurta në suspensë që e kanë kaluar trajtimin primar. Nga grupi i auditimit u konstatua se ky proces nuk kryhej për arsye se pompat dhe tubacionet janë jashtë funksionit.
2.4. Trajtimi terciar e kalon nivelin e trajtimit tradicional sekondar për të larguar sasi të rëndësishme të azotit, fosforit, metaleve të rënda, lëndëve organike të biodegradueshme,

baktereve dhe viruseve. Në këtë proces trajtohet materiali nga dekantuesi primar pasi janë veçuar materialet e ngurta. Nga grupi i auditimit u konstatua se ky proces nuk kryhej për arsye se pompat dhe tubacionet janë jashtë funksionit.

2.5. Trajtimi i llumit i cili përmban lëndë të ngurta organike dhe inorganike që janë larguar nga rrjedha e ujit me anë të dekantuesit primar dhe lëndët organike të prodhuara gjatë trajtimit sekondar biologjik dhe të larguara me anë të dekantuesit sekondar, trajtohet në mënyra të ndryshme. Nga grupi i auditimit u konstatua se llumi nuk trajtohej. Gjithashtu u konstatua se, llumi dhe materialet e ngurta nga dekantuesi primar nuk është larguar për një kohë të gjatë duke zvogëluar sasinë përpunuese e duke dëmtuar bazamentin e tij.

S*hkarkimi i ujërave të ndotura, pas dekantimit mekanik në ITUN Qerret, derdhen në detin Adriatik. Bazuar në kushtin që trajtimi i ujërave të ndotura është përdorimi i metodave fizike, kimike dhe biologjike, trajtim i cili mungon në ITUN Qerret..*

Ne ITUN ka sistem të kontrollit "SKADA" që shërben për komandimin e gjithë procesit në mënyrë automatike si dhe gjeneron të dhënat e nevojshme. Nga grupi i auditimit u konstatua se sistemi SCADA është jashtë funksionit si dhe shoqëria nuk ka staf specialist për përdorimin e tij.

Laboratori i ITUN duhet të kryej analizat e ujërave të ndotura, në nyje të ndryshme të procesit, sipas skemës funksionale dhe metodës biologjike që është projektuar. Analizat që duhet të kryhen janë vlerat e NKO-së (Nevoja Kimike për Oksigjen) dhe të NBO-së (Nevoja Biokimike për Oksigjen) të shprehura në mg/l O_2 si dhe lënda e ngurtë pezull e shprehur mg/l. Nga grupi i auditimit u konstatua se laboratori nuk kryen analizat e kërkuara, në staf nuk ka punonjës laborant sipas strukturës si dhe reagentët që gjendeshin në laboratorin e impiantit ishin të skaduar. Nga ish laborantja Znj. J.Gj nuk janë kryer analizat e ujit të ndotur në të gjitha fazat dhe nuk ka mbajtur regjistra të saktë për shkarkimin e ujërave në mjedisin pritës.

Gjithashtu nga grupi i auditmit u konstatua se, të gjitha pompat janë jashtë funksionit, ka çarje të tubacioneve të filtrimit, pajisjet elektrike kanë probleme të theksuara dhe pajisja për kryerjen e procesit filtrim me pikim janë jashtë funksionit.

Për sa më sipër, ITUN Kavajë nuk kryen proces të plotë të trajtimit të ujërave te ndotura, kryen procesin paraprak dhe atë primar jo të plotë, kështu që nuk jep rezultatin e pritshmërisë së investimit, nuk plotëson normat dhe standardin e cilësisë që duhet të plotësoj uji i trajtuar përpara se të derdhet në trupat ujore pritëse, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011"Për mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr.177, dt. 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse", si dhe direktivën e Bashkimit Evropian 91/271/EEC.

Kriteri: Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura",Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", Ligji nr. 10,431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr.177, dt. 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse", Direktiva e Bashkimit Evropian 91/271/EEC.

Ndikimi/Efekti: Shkarkimin e ujërave të ndotura në mjedisin pritës, jo në përputhje me normat e lejuara që mund të shkaktojnë dëme në mjedis apo në shëndetin e njeriut.

Shkaku: Mos monitorim i mjaftueshëm nga Administratori i Shoqërisë dhe organet drejtuese i ITUP, si dhe mos mirëmbajtje e pajisjeve elektro-mekanike të ITUP nga ana e punonjësve të ITUP.

Rëndësia: I lartë
Rekomandim: -Administratori i Shoqërisë, të krijojë një grup pune me specialist të fushës përkatëse për evidentimin e problemeve në ITUP. Gjithashtu të evidentohen nevojat e kërkesat, dhe të hartohet një plan pune i detajuar, sipas të gjitha proceseve, për vënien në efiçensë të plotë të ITUP në një kohë sa më të shkurtër.
-Të vihet në funksionim laboratori në ITUP, sipas standardeve shtetërore, dhe të kryhen në mënyrë rigoroze e të vazhdueshme analizat e ujit të ndotur që shkarkohet në mjedisin pritës.
-Nga ana e shoqërisë të evidentohen dhe të krijohet një regjistër për të gjitha subjektet komerciale dhe industriale që shkarkojnë ujin e ndotur në sistemin publik të kanalizimeve. Nga ana e shoqërisë të kërkohet/monitorohet kryerja e analizave të ujërave të ndotura, nga vetë subjektet komerciale dhe industriale, në zbatim të standardeve shtetërore, për të ulur koston e përpunimit të ujërave të ndotura në ITUP. Në rast të moskryerjes së analizave të merren masa administrative ndaj këtyre subjekteve, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Licensimi i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kavajë sipas legjislacionit në fuqi.
Gjetja: Shoqëria e Ujësjellës Kanalizime Kavajë për periudhën objekt auditimi kryen veprimtari të pa licensuar në kategorinë, D- *për përpunimin e ujërave të ndotura*, si dhe ka detyrime financiare ndaj ERRU.
Situata: Nga dokumentacioni i vënë dispozicion grupit te auditimit, konstatohet se për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 deri 06.09.2018 operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Kavajë ka kryer veprimtari të pa licensuar në të gjitha kategoritë, A,B,C e D, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar. Për kryerjen e veprimtarisë të pa licensuar, në të gjitha kategoritë, nga operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Kavajë, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU me Vendim Nr. 42, datë 13.06.2018 ka dënuar me gjobë në shumën 300,000 lekë për ushtrimin e veprimtarisë pa licensë dhe në shumën 100,000 lekë për mospagimin e detyrimeve financiare ndaj ERRU, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ky institucion. Nga dokumentacioni e vënë në dispozicion konstatohet se për mospagim të detyrimeve financiare ndaj ERRU, Përmbaruesi Gjyqësor G.F me shkresën Nr. 65/42 Prot. datë 02.07.2018, ka nxjerrë " Urdhër për vënien sekuestro konservative" në zbatim të Urdhrit Ekzekutues Nr.5583/U datë 03.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në shumën 5,346,470 lekë. Nga dokumentat financiare të vendosura në dispozicion konstatohet se detyrimi i mbartur ndaj ERRU, deri në përfundim të auditimit, është 5,779,600 lekë.
Shoqëria e UK Kavajë është e licensuar nga ERRU (Enti Rregullator i Ujit) me Vendimin Nr. 65, datë 06.09.2018, me mbarim afati 05.09.2022. sipas licencës operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Kavajë autorizohet të kryej veprimtarinë përkatëse për kategoritë, A-*për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik*, B-*për përpunimin e ujit për konsum publik*, C-*për largimin e ujërave të ndotura*. Nga grupi i auditimit u konstatua se, për kategorinë D-*për përpunimin e ujërave të ndotura*, operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Kavajë kryen veprimtari të pa licensuar ne Impiantin e Përpunimit të Ujërave të Ndotura. Mos licensimi për kategorinë nga ana e ERRU është si rezultat se shoqëria UK Kavajë nuk është pajisur me Leje Mjedisore për ITUN kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", seksioni 2, neni 29, pika 1 ku thuhet: "*Veprimtaritë, që shkaktojnë ndotje në mjedis, pajisen me lejen përkatëse të mjedisit, ku përcaktohen, me shkrim, kushtet e nevojshme për të garantuar se veprimtaria/instalimi do të përmbushë kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi".*

Kriteri: Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", Ligji nr. 10,431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit",
Ndikimi/Efekti: Rritjen e shpenzimeve të pa nevojshme të shoqërisë nga gjobat dhe kamat vonesat si dhe bllokim të llogarive bankare duke vendosur shoqërinë në vështirësi financiare. Mos ushtrimi plotësisht i veprimtarisë së shoqërisë konform legjislacionit specifik në fuqi (lejet, autorizimet, licensat etj) për përpunimin e ujërave të ndotura.
Shkaku: Mos monitorim i mjaftueshëm nga Administratori i Shoqërisë dhe organet drejtuese, për shlyerjen e detyrimeve ndaj ERRU dhe mospasja Leje Mjedisore për ITUN.
Rëndësia: I lartë
Rekomandim: Administratori i Shoqërisë, Këshilli Administrimit të marrin masa për përgatitjen e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pajisje me Leje Mjedisore për ITUN që është kusht paraprak për licensimin e shoqërisë nga ana e ERRU për përpunimin e ujërave të ndotura
-Nga ana e shoqërisë të arrihet në një marrëveshje me ERRU për shlyerjen e detyrimeve financiare dhe ato të prapambetura, duke shmangur bllokimin e llogarive bankare e për rrjedhoje vendosin shoqërinë në vështirësi financiare.
Përsa më sipër është mbajtur aktkonstatimi nr.13, datë 21.02.2020

Për përmirësimin e gjëndjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

B. <u>MASA ORGANIZATIVE</u>
I. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

1.Gjetja nga auditimi: Asambleja e Aksionarëve, në rastet që është mbledhur, ka analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë por në opinionin e grupit të auditimit vlerësohet se nga problematikat e diskutuara nuk janë nxjerrë konkluzione mbi mbarëvajtjen dhe funksionimin e shoqërisë për ta orientuar drejt në zgjidhjen e problematikave, nëpërmjet përshpejtimit të reformave të sektorit siç parashtrohet në VKM nr. 63, 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura".
Rekomandimi 1.1: Asambleja e Aksionarëve, gjatë veprimtarisë së saj të marrë masa për të analizuar problematikat me karakter rregullator, ekonomik dhe financiar të shoqërisë me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë funksionale të saj.

Vazhdimisht

1.2Gjetja nga auditimi: Referuar mbledhjeve të Këshillit të Administrimit për vitin 2018, nga grupi i auditimit u konstatua se nuk ka një regjistër që të dokumentojë se sa herë është mbledhur Këshilli i Administrimit për periudhën objekt auditimi, por duke u bazuar në vendimet e marra nga Këshilli i Administrimit për vitin 2018, ky Këshill është mbledhur 3 herë referuar 2 vendimeve dhe 1 projektvendimi që ka marrë për këtë vit, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi Këshillin e Administrimit dhe Administratorin e Shoqërisë UKKA SHA Kavajë, për periudhën objekt auditimi.
- Anëtarët e Këshillit të Administrimit me shoqërinë UK Kavajë SHA, nuk kanë lidhur kontratë pune me shoqërinë UK Kavajë SHA me terma të performancës;
-Referuar plotësimit të kuadrit rregullator të Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, për vitin 2018 u konstatua se UKKA SHA Kavajë, nuk ka një statut të miratuar.

-Këshilli i Administrimit, nuk ka monitoruar, shqyrtuar dhe miratuar veprimtarinë organizative dhe funksionale të UKKA SHA Kavajë dhe vendimet e drejtimit të shoqërisë nga Administratori i UKKA SHA Kavajë për periudhën objekt auditimi;
-Është konstatuar se UK Kavajë SHA, nuk ka një strukturë të miratuar dhe të unifikuar sipas nivelit të pagave dhe numër të miratuar punonjësish në UKKA SHA Kavajë, por referuar vendimit nr.768/4, datë 02.08.2017 i Këshillit të Administrimit të UKKA SHA Kavajë, konstatohet se është miratuar struktura organizative e shoqërisë me 152 punonjës, ndërkohë që nga auditimi analitik i strukturës aktuale të shoqërisë UKKA SHA Kavajë, rezultojnë të punësuar 305 punonjës;
-Këshilli i Administrimit nuk ka shqyrtuar dhe nuk ka miratuar programe ekonomike për vitet 2018-2019 për shoqërinë UKKA SHA Kavajë;
-Këshilli i Administrimit ka miratuar me vonesë pasqyrat financiare për vitin 2017-2018.
Përsa më sipër për parregullsitë e konstatuara në kundërshtim me VKM nr.63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", ngarkohet me përgjegjësi Këshilli i Administrimit dhe Administratori i Shoqërisë UKKA SHA Kavajë, për periudhën objekt auditimi (Trajtuar më hollësisht në faqet 8-9 , të Raportit Përfundimtar të auditimit)
Rekomandimi 1.2.1 :
-Këshilli i Administrimit të marrë masa për shmangjen e praktikave me mangësi të trajtuara, sa më sipër me qëllim mbarëvajtjen e veprimtarisë funksionale të shoqërisë.
-Nga Këshilli i Administrimit të merren masa për të hartuar kontratën e punës me Administratorin e Shoqërisë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

Rekomandimi 1.2.2 :Këshilli i Administrimit të marrë masa për monitorimin dhe shqyrtimin e vendimeve të Administratorit të UKKA Kavajë SHA, për të plotësuar kuadrin rregullator të shoqërisë duke miratuar statutin e saj, përditësimin e rregullores së brendshme, programet ekonomike, planin e biznesit të shoqërisë në funksion të mbarëvajtjes dhe funksionimit të aktivitetit të UKKA SHA Kavajë.

Vazhdimisht

1.3.Titulli i gjetjes: Për periudhën objekt auditimi për vitet 2018-2019 në Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA janë nxjerrë rreth 300 urdhra me karakter organizativ, disiplinor, urdhra për procedura prokurimi, për mbarëvajtjen e veprimtarisë së UK Kavajë SHA etj, nga Ish Administratorët.
Nga auditimi është konstatuar se baza ligjore e përdorur për nxjerrjen e këtyre urdhrave nuk gjen mbështetje në aktet administrative që rregullojnë veprimtarinë e Ujësjellësit, sepse UK Kavajë SHA e kryen veprimtarinë pa pasur një statut të miratuar dhe një rregullore të brendshme jo të përditësuar.Urdhrat nuk kanë siglimet e duhura që e bëjnë aktin administrativ të rregullt nga ana e procedurës administrative (përshkrimi i sektorit që koncepton urdhrin dhe miratimi i tij).
Janë konstatuar në shumë raste paradhënie të një page apo dy pagash punonjësve pa arsye të mbështetur në ligj dhe pa relacione shpjeguese për punonjësin përfitues, gjithashtu janë konstatuar raste të dhënieve të urdhrave për pushime nga puna, që nuk evidentojnë afatet dhe hapat administrative deri në marrjen e masave disiplinore për largimet nga puna. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi Ish Administratorët e UKKA SHA Kavajë për periudhën objekt auditimi. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 8-9 , të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandimi 1.3.1: Administratori i UKKA SHA Kavajë përpara nxjerrjes së urdhrave, të marrë masa për të garantuar vlefshmërinë e akteve administrative që nxjerr, duke u njohur me kuadrin rregullator të UKKA SHA Kavajë dhe procedurat administrative (përshkrimi i sektorit që koncepton urdhrin dhe miratimi i tij).

Vazhdimisht

II. Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik.

2.1Gjetje nga auditimi: Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë, nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata, në përputhje me objektivat e caktuar nga organet drejtuese të saj. Shoqëria nuk ka hartuar plan 5-vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plan të biznesit, në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës – Kanalizime përcaktuar në Udhëzuesin e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, ku të përcaktohen: Deklarata e vizionit dhe misionit, përmbledhje për drejtuesit e lartë, qëllimet strategjike, analiza dhe parashikimi për menaxhimin e kërkesës për ujë, struktura organizative dhe personeli, programi për përmirësimin e performancës, programi pesëvjeçar për investimet kapitale, buxheti 5-vjeçar për operacionet mirëmbajtjen, nevoja për të ardhura dhe analiza e tarifave/strategjitë e çmimeve.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 9-10 ,të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandimi 2.1.1: Administratori i Shoqërisë dhe Këshilli Administrativ të Shoqërisë të marrin masa për hartimin dhe miratimin e planeve afatmesme e afatgjatë, të planit 5-vjeçar për përmirësimin e performancës dhe planit të biznesit, në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës – Kanalizime.

Brenda 6 mujorit të parë 2020

2.2 Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria Tregtare, Administratori dhe Këshilli i Administrimit të Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, nuk janë miratuar programe ekonomik për vitin 2018 dhe vitin 2019 në kundërshtim me VKM nr.63, datë 27.01.2016 dhe rregulloren e brendshme UK Kavajë SHA. Megjithëse nga Drejtoria Tregtare e shoqërisë nuk janë paraqitur projekt buxhetet të planifikuara dhe të miratuara për vitet 2018 dhe 2019, grupi i auditimit është shprehur mbi shpenzimet dhe ardhurat faktike sipas të dhënave të programit të kontabilitetit të shoqërisë, nga ku është konstatuar se shpenzimet sipas zërave të buxhetit të mbartura në programin e kontabilitetit sipas funksionit , nuk janë të njëjta me shpenzimet sipas natyrës, të cilat gjithashtu rezultojnë të mbartura në kontabilitet. Pra konstatohet se njëjti fakt është i ndryshëm në bilancin e shoqërisë dhe në zërat e shpenzimeve sipas buxhetit, për rrjedhojë mosplanifikimi i programit ekonomik, ka sjellë tejkalime dhe mosrealizime në zëra të ndryshme të buxhetit të shoqërisë për vitin 2018 dhe 2019.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 8-9, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

2.2.1Rekomandimi: Administratori, Këshilli i Administrimit dhe Asambleja e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, të marrin masa për hartimin dhe miratimin në kohë të programit ekonomiko-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, si dhe të marri masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

Vazhdimisht

2.2.2Rekomandimi: Drejtoria Tregtare të marrë masa në vazhdimësi që raportimet mbi realizimin e treguesve ekonomikë e financiar, të jenë të plota, të sakta dhe të shoqëruara me relacione, duke analizuar të dhënat historike mbi realizimin e treguesve tekniko-ekonomik të shoqërisë; duke raportuar çdo muaj për ecurinë e shoqërisë pranë Këshillit të Administrimit dhe çdo vit përpara Asamblesë së Përgjithshme.

Vazhdimisht

III. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3.1Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i strukturës organizative rezulton se në vitin 2017 me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 768/4 prot., datë 02.08.2017 është miratuar struktura me 152 punonjës, vendim i cili ka qenë në fuqi edhe gjatë vitit 2018-2019, por nuk ka listë me pozicione pune dhe emrat bashkëngjitur pozicionit përkatës. Në organogramën e miratuar nga Këshilli i Administrimit është edhe Auditi i Brendshëm, por në UKKa nuk ka funksionuar kjo strukturë. Gjithashtu u konstatua dhe mungesa e specifikimit të numrit të punonjësve për çdo pozicion dhe për çdo sektor duke krijuar konfuzion në mënyrën e mirëfunksionimit të strukturës administrative dhe ndarjes së punës me efiçiencë sipas pozicioneve përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me pikën c, nenin 18, VKM nr.63, datë 27.1.2016 dhe Statutit të UKKA SH.A. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

3.1.1Rekomandime: Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore, Këshilli i Administrimit dhe Titullari të marrin masa për hartimin e strukturës dhe organigramës së shoqërisë duke specifikuar numrin total të punonjësve të miratuar në strukturë, numrin e punonjësve për çdo degë dhe sektor, pozicionin specifik të çdo punonjësi shoqëruar me organigramën e shoqërisë.

Menjëherë

3.2Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i rregullores së brendshme rezulton se rregullorja e brendshme për UKKa Sh.a është miratuar në vitin 2017 dhe gjatë kësaj kohe nuk është përshtatur me ndryshimet në strukturën organizative dhe statutin e ndryshuar të shoqërisë duke mos ndihmuar në mirëfunksionimin e brendshëm të saj. Në rregulloren e brendshme nuk është përcaktuar lloji i arsimimit për të gjitha pozicionet e punës si dhe nuk janë të përcaktuar qartë përshkrimi i punës për çdo pozicion, duke bërë të vështirë identifikimin e detyrave dhe të drejtave që ka çdo punonjës i shoqërisë. Janë përcaktuar vetëm funksionet apo detyrat e disa pozicioneve dhe jo përshkrimi i punës për çdo pozicion. Në rregulloren e brendshme nuk janë përcaktuar kriteret për procedurat e marrjes në punë, konkurrimin dhe vlerësimin e kandidatëve. Përzgjedhja e punonjësve nuk është kryer si rezultat i një procedure rekrutimi të ndjekur, as të kritereve të pozicionit, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë etj. Çdo rekrutim i punonjësve gjatë periudhës objekt auditimi është kryer me urdhër të administratorit të shoqërisë dhe asnjë kriter tjetër. Nga ana e strukturave drejtuese nuk është marrë asnjë masë për përshtatjen apo hartimin e një rregulloreje të re sipas organizimit të ri në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.01.2016 *"Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"*. Këto veprime janë në kundërshtim nenin 18, pika 2c të VKM nr. 63 datë 27.1.2016, *"Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

3.2.1Rekomandime: Drejtoria Juridike, Burimeve Njerëzore, Këshilli i Administrimit dhe Titullari të marrin masa për hartimin e rregullores së re të brendshme të shoqërisë ku të specifikohen qartë detyrat dhe të drejtat për çdo pozicion pune, nivelin arsimor të kërkuar për përmbushjen efiçente të këtyre detyrave si dhe të bëhet vazhdimisht përshtatja e rregullores me ri-organizimin e shoqërisë.

Brenda 6 mujorit të parë 2020

3.2.3Rekomandime: Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Këshilli i Administrimit dhe Titullari të hartohen rregulla dhe procedura specifike ku të specifikohen qartë kriteret e punësimit për çdo pozicion pune lidhur me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë apo trajnimet profesionale të nevojshme për përmbushjen efikase të detyrave për çdo pozicion pune, duke rritur transparencën e mënyrës së punësimit dhe rekrutimit në bazë të meritokracisë.

Brenda 6 mujorit të parë 2020

3.3Gjetja nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se në rregulloren e brendshme, në kontratat individuale dhe në mungesë të kontratave kolektive nuk specifikohet përmbajtja e dosjes së personelit. Në kundërshtim me VKM Nr.63 "*Për organizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura*", datë 27.01.2016, neni 18, pika b nga auditimi i dosjes së administratorit konstatohet se z.B.T, i emëruar si Administrator i Ujësjellës Kanalizime Kavajë Sh.a në datën 20.02.2018, nuk është pajisur akoma, me çertifikatën përkatëse për aftësimin specifik profesional të tij, sipas detyrës që do të ushtrojë, në fushën e menaxhimit të ujësjellës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotur. Në asnjë nga kontratat individuale nuk specifikohej paga dhe elementet përbërës të saj. Në disa raste mungonte CV e punonjësit, diplomat universitare në pjesën më të madhe të dosjeve ishin të panoterizuara, në disa raste mungonte libreza e punës, mungonte fleta e inventarizimit dhe libreza e sigurimeve shoqërore në të gjitha dosjet. Gjithashtu u evidentuan raste të dosjeve vetëm me kontratën e punës të personit të punësuar dhe asnjë dokumentacion tjetër. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës.(*Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

3.3.1Rekomandime: Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa të plotësojë të gjitha dosjet e punonjësve dhe sidomos kontrata e punës ku të specifikohet qartë pozicioni i punës në përputhje me nivelin arsimor dhe profesional të çdo punonjësi si dhe paga bruto për periudhën e punësimit. Në çdo kohë, në dosjen e punonjësit duhet të figurojnë kopje të të gjithë urdhrave të transferimit në pozicione pune të tjera brenda shoqërisë, për të rritur transparencën në afrimin e pozicioneve të punës me formimin përkatës.

Menjëherë

3.4Gjetja: Nga auditimi i strukturës së shoqërisë rezulton se kjo strukturë është tejkaluar çdo muaj gjatë viteve 2018 dhe 2019. Nga auditimi i vendimeve të Administratorit dhe Këshillit Mbikëqyrës rezulton se me vendimin nr.15/2 datë 20.12.2017 Këshilli i Administrimit miratoi vetëm nivelin e pagave të personelit të menaxhimit administrativ dhe përgjegjësitë e sektorëve të degëve të shoqërisë por jo për të gjithë punonjësit e shoqërisë. Në këtë mënyrë administratori vendos për nivelin e pagave të disa punonjësve ku, për pozicion të njëjta pune aplikohen nivele të ndryshme duke treguar sjellje preferenciale dhe pa ia kaluar për kompetencë organeve kolegjiale. Veprimet e administratorit janë në kundërshtim me nenin 2, pika ç, *dhe nenin 6, pika 1, ligji nr.10405, datë 24.03.2011 për "Kompetencat e organeve kolegjiale".(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

3.4.1Rekomandime: Përcaktimi i nivelit të pagave të kryhet sipas legjislacionit në fuqi nga Këshilli i Administrimit i shoqërisë dhe në çdo kohë pozicione pune të ngjashme, duhet të kenë pagë të njëjtë. Diferencimi mund të kryhet në performancën e secilit punonjës, në çdo rast e dokumentuar me rezultate konkrete në punë dhe jo vetëm me vendim të titullarit duke favorizuar një punonjës dhe duke diskriminuar një tjetër.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

3.5.Gjetja: Nga auditimi i listëpagesave dhe nivelit referues të pagave rezulton se Këshilli i Administrimit me vendimin nr. 3005/9 datë 19.11.2018 ka ndryshuar pagat për 9 punonjës ku 7 prej tyre paguhen më shumë se pozicionet e ngjashme të miratuara në strukturë. Në këtë mënyrë, favorizimi i këtyre 7 punonjësve ka rritur kostot e pagave në **397,656 lekë** për periudhën Dhjetor 2018-Janar 2020.
Nga auditimi i listëpagesave rezulton se ekziston mospërputhje midis emërimit në kontratë pune dhe emërimit të pozicionit në bordero. Meqenëse struktura nuk është e mirëpërcaktuar disa nivele pagash përgjegjës sektori paguhen si kryetar departamenti. Ka gjithashtu nivele të ndryshme pagash për të njëjtat pozicione punë duke nxitur diskriminimin në punë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kodin e Punës, Neni 115, "Barazia në shpërblim" (Ndryshuar me Ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015) *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*
3.5.1Rekomandime: Nga Këshilli i Administrimit dhe Titullari i UKKa, të merren masa për miratimin e nivelit të pagave, në zbatim të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve". Përcaktimi i nivelit të pagave të kryhet sipas legjislacionit në fuqi nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë dhe në çdo kohë pozicione pune të ngjashme duhet të kenë pagë të njëjtë. Diferencimi mund të kryhet në performancën e secilit punonjës, në çdo rast e dokumentuar më rezultate konkrete në punë dhe jo vetëm me vendim të titullarit duke favorizuar një punonjës dhe duke diskriminuar një tjetër.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

3.6.Gjetja: Nga auditimi i listëpagesave dhe nivelit referues të pagave kanë rezultuar diferenca pozitive dhe negative në paga. Këto diferenca kanë ardhur si pasojë e mospërputhjeve midis emërimit në kontratë pune dhe emërimit të pozicionit në bordero. Meqenëse struktura nuk është e mirëpërcaktuar disa nivele pagash përgjegjës sektori paguhen si kryetar departamenti. Ka gjithashtu nivele të ndryshme pagash për të njëjtat pozicione. Ka pozicione të cilat paguhen më shumë ose më pak se sa niveli i miratuar në strukturë. Nuk ka unifikim të emërtimeve në sistemin tatimor për pozicione pune të ngjashme dhe ka diferenca në caktimin e pagave për të njëjtat pozicione pune. Diferencat pozitive tregojnë se janë paguar më shumë se sa pozicioni i tyre aktual i punës ndërsa diferencat negative tregojnë që janë paguar më pak ose që mbajnë një pozicion tjetër pune në krahasim me atë që shënohet në kontratë pune apo në bordero. Veprimet janë në kundërshtim me strukturën e miratuar nga Këshilli i Administrimit i UKKA SHA me Vendimin nr. 768/4 prot., datë 02.08.2017, nivelin e pagave të miratuar nga Këshilli i Administrimit me Vendimin nr. 97/5, datë 10.02.2017 dhe kontratat individuale të punës.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

3.6.1Rekomandime: Nga Departamenti i Financës të merren masa që të ri-strukturohet mënyra e përllogaritjes së pagave për çdo të punësuar duke rritur transparencën në afrimin e informacionit përkatës për të gjithë komponentët e pagës, sipas legjislacionit në fuqi, pozicionit të punës sipas emërimit përkatës të gjithsecilit në kontratën e punës dhe përcaktimin e pagës bruto sipas arsimimit përkatës të gjithsecilit dhe pozicionit në strukturë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

3.7.Gjetja: Nga auditimi për çeljen e fondit për ish të përndjekurit politik rezulton se Ujësjellës Kanalizime Kavajë Sh.a nuk ka llogaritur dhe derdhur për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë shumën 1 % të fondit të pagave për vitin 2018-2019 në **shumën totale 1,835,010 lekë.** Veprimet janë në kundërshtim me shkronjën "b" të nenit 1 të ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "*Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë"* dhe VKM nr. 392, datë 12.08.1999 "*Për administrimin e fondit të veçantë monetar, të krijuar sipas ligjit nr. 7598, datë 01.09.1992 "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë".(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

3.7.1Rekomandime: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa çdo fillim viti "Për krijimin e fondit të veçantë monetar për ish-të dënuarit e të përndjekurit politikë" dhe të kryhet raportimi i saktë në pasqyrat financiare, në përputhje me standardet dhe politikat kontabël të miratuara nga vetë institucioni.

-Nga Administratori i shoqërisë dhe sektori i financës të merren masa që shuma e identifikuar të mund të paguhet me këste sipas një skeduli të detajuar për llogari të Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë**.**

Brenda vitit 2020

IV. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjeve me vlera te vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).

4.1 Gjetje nga auditimi: Për mbajtjen e dhe shpërndarjen e karburantit në UK Kavajë SHA, nuk ka një strukturë të ngritur me një urdhër titullari, por kjo shpërndarje e karburantit është kryer me urdhër verbal nga Administratorët e UK Kavajë SHA për periudhën objekt auditimi.

-Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit për vitin 2018 dhe vitin 2019 u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës.Kartelat për tërheqjen e karburantit janë nënshkruar nga titullari i UK Kavajë ose personi i autorizuar në formë verbale nga Titullari i UK Kavajë SHA, sipas periudhës objekt auditimi. Automjetet e UK Kavajë SHA, nuk janë të pajisura me sistemin GPS, nuk kontrollohen km e përshkuar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patenta shoqëruese e mjeteve dhe për mjetet e përdorura nuk janë të miratuara normativat e konsumit/100km për këtë qëllim, si dhe nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina.

- Nga verifikimi i gjendjes së karburantit sipas evidencës nga programi Alpha Platinium në datën 18.02.2020, në zyrën e financës në UK Kavajë SHA për periudhën 2018-2019, nuk rakordon vlera hyrje e Naftës sipas kartelës nr.01306 dhe vlera dalje e Naftës sipas kartelës nr.01306, sipas sasive të tërhequra gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit në Ujësjellës Kanalizime Kavajë për vitin 2018 dhe vitin 2019, nuk dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës për vitin 2018 prej 4,457,238 lekë për 31,752 litra dhe shpenzimi i naftës për vitin 2019 për 3,726,099 lekë për 25,946 litra.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 28-31, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

4.1.1Rekomandime: Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë që nga UKKA SHA Kavajë, të merren masa që të rregullohet me urdhër struktura që menaxhon mbajtjen e karburantit dhe të dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit, shpenzimi i naftës në vazhdimësi.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

V. Mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

5.1Gjetje nga auditimi: a. Shoqëria UK. Kavajë SHA, nuk ka miratuar pasqyrat financiare sipas afateve të përcaktuara nga Ministria e Financave, në kundërshtim me Udhëzimin nr.14 datë 28.12.2006, i ndryshuar me urdhrin nr.26 datë 27.12.2007 dhe mosdorëzimi i bilancit sipas afateve të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, ka rënduar shoqërinë me një gjobë prej 15,000 lekë.

b. Shoqëria UK Kavajë SHA, nuk ka bërë transferimin e aseteve në Bashkinë Rrogozhinë, gjithashtu nuk është kontabilizuar zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë për vitin 2018, në vlerën 93,802,627 lekë vlerë e cila i takon Bashkisë Rrogozhinë në bazë të përllogaritjeve të ekspertëve kontabël të miratuar në raportin "Mbi ndryshimin e kapitalit të shoqërisë", datë 12.02.2018, përsa më sipër vlera 93,802,627 lekë rëndon në mënyrë të padrejtë zërin e bilancit aktive afatgjata materiale, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

c. Bilanci i veprimtarisë ekonomiko-financiare të shoqërisë për vitin 2018, nuk kuadron në llogaritë e gjendjeve sepse totali i bilancit i raportuar nga shoqëria për vitin 2018 është në vlerën 2,706,139,177 lekë , ndërsa sipas programit të kontabilitetit totali i bilancit rezulton në vlerën 2,707,071,100 lekë me një diferencë në vlerën 931,923 lekë. Kjo diferencë ka ardhur si rezultat i moskuadrimit të hedhjes së të dhënave në programin e kontabilitetit të shoqërisë duke raportuar një mospërputhje të të dhënave në programin e kontabilitetit dhe në bilancin e raportuar, duke ulur shkallën e besueshmërisë të ngjarjeve dhe fakteve në kontabilitetin e shoqërisë dhe rezultatin financiar, veprime në kundërshtim *me udhëzimin nr.14 date 28.12.2006 , i ndryshuar me urdhrin nr.26 datë 27.12.2007, Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi te ardhurat , i ndryshuar, neni 33/1"***, *Ligjin nr.9228,datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar dhe Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe SKK2. (Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

5.1.1Rekomandimi: Nga Drejtoria Tregtare e UK Kavajë SHA dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin masa për hartimin e pasqyrave financiare dhe dorëzimin e tyre në Këshillin e Administrimit dhe Asamblenë e Aksionarëve brenda afateve sipas përcaktimeve ligjore.

Vazhdimisht

5.1.2.Rekomandimi: Nga Drejtoria Tregtare e UK Kavajë SHA të merren masa për sistemimin e veprimeve financiare që lidhen me regjistrimin e përpiktë në programin e kontabilitetit të shoqërisë, sipas ngjarjeve dhe fakteve të konstatuara gjithashtu të kryejë të gjitha sistemimet e diferencave që ekzistojnë midis bilancit të raportuar dhe të dhënave në programin e kontabilitetit të shoqërisë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.1.3 Rekomandimi Shoqëria UK Kavajë SHA të marrë masa për kontabilizimin e zvogëlimit të kapitalit duke marrë në konsideratë rezultatin financiar (humbjen) e miratuar në Këshillin e Administrimit dhe duke e shpërndarë këtë humbje 80.5 % në UK Kavajë SHA dhe 19.5 % Bashkisë Rrogozhinë, duke kryer edhe transferimin e aseteve nga UK Kavajë SHA në Bashkinë Rrogozhinë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se **s**hoqëria UK Kavajë SHA , nuk ka një pasqyrim të saktë midis gjendjes në bilanc të veprimeve me arkë dhe bankë dhe me faturimet ndaj klientëve konkretisht në llogarinë "Aktive Mjete Monetare" për vitin 2018 përfshihet vlera 16,747,026 lekë e raportuar në bilanc ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është 16,747,751 lekë , këto veprime që kanë ardhur si rezultat i moshedhjes së saktë të mandat arkëtimeve dhe mandat pagesave në librin e arkës ,gjithashtu nga Drejtoria Tregtare e UK Kavajë SHA, nuk është kryer aktrakordimi përfundimtar me arkëtaren e

shoqërisë për gjendjen reale të arkës, gjithashtu nga auditimi u konstatua se Shoqëria UK. Kavajë nuk punon me kasa fiskale, në kundërshtim me ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

5.2.1Rekomandimi:

-Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, të marrë masa për të pasqyruar në mënyrë të saktë gjendjen në bilanc të veprimeve me arkë dhe bankë.

Vazhdimisht

5.3 Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në bilancin e vitit 2018 për llogarinë e detyrimeve të klientëve të shoqërisë UK Kavajë SHA, rezultojnë 8 klientë që janë me gjendje kreditore në vlerën 12,874,007 lekë, duke mos i pasqyruar saktë në bilanc të ardhurat e shoqërisë, veprim është në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

5.3.1Rekomandimi:

- Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, të marrë masa për të sistemuar detyrimin e faturave të klientëve nga diferencat që kanë rezultuar në librat analitikë të bilancit.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.4.Gjetje nga auditimi: Nga Shoqëria UK Kavajë SHA, nuk është kryer inventari fizik i aseteve të shoqërisë si dhe nuk është llogaritur amortizimi i aktiveve afatgjata materiale për vitin 2018 (Ndërtesa, Impiante, Makineri Pajisje, Mjete Transporti),veprim në kundërshtim të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998"Tatimi mbi të ardhurat ",i ndryshuar, dhe udhëzimi nr.5 i ministrisë së financave datë 30.01.2018 ,ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, i ndryshuar.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit*).

5.4.1Rekomandimi:

Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa për të kryer inventarin fizik të aseteve të shoqërisë për vitin 2018, të evidentohen aktivet afatgjata materiale që kanë dalë jashtë përdorimit, si dhe të kryhen procedurat përkatëse.

-Drejtoria Tregtare e shoqërisë UK. Kavajë SHA të marrë masa për të kërkuar hyrjet e aktivet afatgjata materiale si dhe hyrjet e Aktiveve të periudhës me kosto historike të tyre. Njëkohësisht në bazë të viteve të jetës që ky aktiv ka në shoqëri, të rëndohet me normat e amortizimit përcaktuar në ligj dhe të llogaritet saktë amortizimi i akumuluar për vitin 2018 e në vazhdim.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.5.Gjetje nga auditimi: Nga shoqëria UK Kavajë SHA dhe Drejtoria Tregtare nuk është kuadruar me bilancin dhe librat analitikë të llogarisë "Furnitorë" "Të pagueshme ndaj

punonjësve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore", "Të pagueshme për detyrimet tatimore', "Të pagueshme për Shpenzimet e konstatuara" në bilancin e vitit 2018 me llogaritë e gjendjeve në programin financiar të kontabilitetit. Konkretisht në kontabilitetin e Shoqërisë paraqiten (7 shtatë) furnitorë që janë me gjendje debitore ne vlerën 844,976,8 lekë**.** Kjo vlerë ka ardhur si rezultat i mos kontabilizimit të faturave, por vetëm i pagesave të tyre , pa njohur detyrimin nga subjekti i Ujësjellës Kanalizime Kavajë sha për rrjedhojë kjo ka sjellë dhe mosdeklarimin saktë të shpenzimeve në kundërshtim me SKK 4 "Për të drejtat dhe detyrimet", Ligji nr.9228, date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
-Shoqëria UK Kavajë SHA për vitin 2018 ka deklaruar në shtet detyrimin për TVSH-në në vlerën 11,973,528 lekë , ndërsa vlera e likuidimeve të raportuara në urdhër pagesat e tatimeve është 10,296,442 lekë. Diferenca për detyrimin e papaguar të TVSH-së për vitin 2018 është 1,677,086 lekë. Kjo diferencë nuk përputhet me gjendjen e raportuar në muajin Dhjetor 2018 të vlerës së deklaruar në shtet, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr.9228, date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".*(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

5.5.1Rekomandimi:

- Drejtoria Tregtare e shoqërisë UK. Kavajë SHA, të marrë masa për të rakorduar llogarinë, për të gjithë furnitorët që nuk u ka paguar detyrimin në momentin e lindjes së detyrimit të tyre nga shoqëria UK. Kavajë SHA, si dhe të sistemojë ata furnitorë që kanë dalë me pagesë më shumë se sa detyrimi në librat analitike të tyre.
-Drejtoria Tregtare e shoqërisë UK. Kavajë SHA, të marrë masa masa për të rakorduar me degën të tatimeve Durrës për detyrimet dhe likuidimet për vitin 2018 dhe në vazhdim dhe të nxjerrë një detyrim real të saj, ndaj degës së tatimeve Durrës, duke u bazuar në FDP dhe në Urdhër pagesat nëpërmjet bankës për likuidimin e TVSH.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.6.Gjetje nga auditimi: Shoqëria UK Kavajë SHA në rolin e agjencisë zbatuese sipas marrëveshjes së huasë miratuar me ligjin Nr. 9042 datë 03.04.2003, ka ndërtuar impiantin e prodhimit të ujit të pijshëm në Manskuri. Ky impjant është projektuar që të furnizojë zonën e plazhit Golem si dhe shitje me shumicë për Ujësjelës Kanalizime Durrës. Ndërtimi i tij është financuar nga huaja 2,045,167.52 Euro dhe granti 1,533,875.64 Euro i marrë nga Qeveria Gjermane (Banka KfW).Punimet e impjantit janë kryer në lotin A ku përfshihen 1. Ndërtimi i tre filtrave të rërës 1200 m3, 2. Rezervuari dhe stacionet e pompimit, sistemi automatik i klorinimit. Punimet kanë përfunduar më 04.07.2007 dhe janë marrë në dorëzim me "Certifikatë of Handing Over" datë 14.09.2007 firmosur nga kontraktori, konsulenti dhe klienti (Drejtori i UKK z. H.SH). Nga auditimi është konstatuar se Shoqëria UK Kavajë SHA, nuk ka llogaritur kostot e mirëmbajtjes dhe të amortizimit të impiantit të prodhimit të ujit të pijshëm në Manskuri ,nuk ka kthyer asnjë këst si principal ashtu edhe interesa për huanë e dhënë sipas kushteve të marrëveshjes së huasë , gjithashtu nuk ka gjurmë në bilancin e shoqërisë UKKA SHA të kontabilizimit të disbursimit të kredisë së dhënë, në kundërshtim me ligjin Nr. 9042 datë 03.04.2003 "Marrëveshja e huase, e financimit dhe e projektit "Furnizimi me ujë, Kavaja II, Manskuria" ndërmjet Republikës se Shqipërisë dhe Bankës Gjermane për Rindërtim dhe Zhvillim (KfW)."(*Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

5.6.1Rekomandimi:

-Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, të marrin masa për të nxjerrë të dhënat e plota mbi akordimin e kredisë nga shteti shqiptar dhe nga Banka Gjermane, të evidentojë disbursimin e

saj, me bankën e nivelit të dytë me të cilën është bërë disbursimi, likuidimi i principalit, llogaritjen e kostove të mirëmbajtjes, amortizimit dhe interesave, që kjo kredi të shlyhet brenda vitit 2042, siç është përcaktuar në marrëveshjen e qeverisë shqiptare me bankën gjermane.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.7.Gjetje nga auditimi: Në bilancin e vitit 2018 të shoqërisë në zërin "të ardhura të shtyra" ka një vlerë 1,720,430,086 lekë, origjina e të cilës nuk është e argumentuar në të dhënat e programit të kontabilitetit kjo shifër është 108 lekë. Diferenca prej 1,720,430,068 lekë rezulton të jetë një vlerë e mbartur në vite në bilanc. Kjo vlerë mund të ketë ardhur si rezultat i mosdeklarimit të të ardhurave të muajit dhjetor të çdo viti i raportuar në janarin e vitit të ardhshëm apo të ndonjë natyre tjetër që nuk është kuadruar midis Drejtorisë së Shitjes dhe Drejtorisë Tregtare në UK Kavajë SHA. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 29.04.2004, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, SKK nr.5 "Për të ardhurat e shtyra". *(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

5.7.1Rekomandimi: Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Shitjes në UK Kavajë SHA, të marrin masa të argumentojnë dhe të sistemojnë vlerën 1,720,430,068 lekë në programin e kontabilitetit të shoqërisë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.8. Gjetje nga auditimi:

-Në bilancin e vitit 2018 të shoqërisë në zërin "Rezerva të tjera "për vitin 2018 vlera e raportuar në bilanc është: 0 ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është: 1,702,411,755 lekë. Ekziston një diferencë prej 1,702,411,755 lekë. Për vlerën 1,702,411,755 lekë, nuk jepen sqarime në llogarinë e saj, por e sjellin me gjendje të mbartur nga vitet e kaluara.

- Në bilancin e vitit 2018 të shoqërisë për zërin "Fitim /Humbje e vitit" për vitin 2018 vlera e raportuar në bilanc është: -8,968,840 lekë ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është: -10,643,159 lekë . Ekziston një diferencë prej -1,674,319 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, si dhe Ligji nr.10296 datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar, SKK5"Për të ardhurat e shtyra".*(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

5.8.1Rekomandimi:

Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA të marrë masa që të evidentojë dhe analizojë nga bilancet e viteve të mëparshme ecurinë e llogarisë "Fitim/humbje" duke paraqitur arsyet e aktivitetit me humbje si dhe të sistemojë llogarinë "Rezerva të tjera" për vlerën 1,702,411,755 lekë, që në bilancin e vitit 2018 paraqitet me gjendje zero.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.9. Gjetje nga auditimi:. Moskuadrimi i llogarive të ardhura dhe shpenzime gjithsej në shoqërinë UK. Kavajë SHA për vitin 2018 ndërmjet bilancit dhe llogarive të gjendjeve në programin e kontabilitetit Alfa. Llogaria "Te ardhura gjithsej" për vitin 2018 në Pasqyrën financiare te raportuar vlera është: 327,169,258 lekë, ndërsa gjendja e kësaj llogarie ne programin e kontabilitetit është: 326,974,038 leke. Ekziston një diference prej 195,220 lekë. Llogaria "Shpenzime gjithsej" për vitin 2018 ne Pasqyrën financiare te raportuar vlera është: 336,138,098, ndërsa gjendja e kësaj llogarie ne programin e kontabilitetit është:

337,617,198 leke Ekziston një diference prej 1,479,100 leke. Llogaria e te ardhurave ka moskuadrime ne llogarite "Te ardhura Financiare" për vitin 2018 ne Pasqyrën financiare të raportuar vlera është: 32,146,963 lekë, ndërsa gjendja e kësaj llogarie në programin e kontabilitetit është: 31,951,743 leke. Ekziston një diferencë prej 195,220 leke, si dhe ne Llogarinë "Te ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit" për vitin 2018 ne Pasqyrën financiare te raportuar vlera është: 165,726,667 leke ndërsa gjendja e kësaj llogarie ne programin e kontabilitetit është: 165,713,708 leke. Ekziston një diference prej 12,959.00 leke. Persa u përket shpenzimeve diferencat kane ardhur si rezultat i mos raportimit te sakte te blerjeve, llogaria "Shpenzime Lëndë e parë dhe material te konsumueshme" (KMSH) për vitin 2018 ne Pasqyrën financiare te raportuar vlera është: 116,976,428 leke.Në programin e kontabilitetit vlera e blerjeve te riregjistruara për vitin 2018 është:*117 969 255 leke.* Ndërsa ne bilancin e raportuar vlera e blerjeve është: *112,322,413 leke,* Këto moskuadrime kanë sjellë dhe mos kuadrimin e sakte te humbjes ne shoqërinë UK. Kavaje SHA. Kjo ka ardhur si rezultat i mos zbatimit plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 date 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Mos ushtrim plotësisht të veprimtarisë së shoqërisë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 date 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".*(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

5.9.1Rekomandimi:

Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, duhet të evidentojë nga bilancet e viteve të mëparshme si ka qenë ecuria e llogarive të ardhura dhe shpenzime dhe të sistemojë për vitin 2018 dhe në vazhdim klientët që kanë bërë arkëtime, por nuk ju është kontabilizuar detyrimi i tyre ndaj shoqërisë dmth fatura e shitjes.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.10.Gjetje nga auditimi: Nga shoqëria UK Kavajë SHA, ka një mosrakordim të detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit të bilancit të vitit 2018 me llogaritë e gjendjeve të programit të kontabilitetit të shoqërisë, si dhe me deklarimet në drejtorinë e Tatim Taksave Durrës konkretisht për: a. Tatimin në Burim, b. Tatimin mbi të Ardhurat Personale (TAP), c. Sigurimeve Shoqërore /Shëndetësore në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ligji nr.9228 date 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe Ligji nr.10296 date 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".*(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

5.10.1 Rekomandimi:

Drejtoria Tregtare në UK Kavajë SHA, të marrë masa për të evidentuar me saktësi dhe të kontabilizojë duke u mbështetur në dokumentet justifikues dhe dokumentet e bankës: tatimin në burim, tatimit mbi të ardhurat personale (TAP) dhe kontributet sigurimeve shoqërore /shëndetësore të punonjësve.

Vazhdimisht

5.11.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2018 nuk është kryer procesi i inventarizimit të aseteve të shoqërisë nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr.88, datë 27.12.2018 të Administratorit të UKKA SHA, gjithashtu nuk është monitoruar zbatimi i këtij urdhri, konkretisht për Llogarinë Inventar për vitin 2018, gjendja e raportuar në bilanc është

50,723.821 lekë, ndërsa gjendja e kësaj llogarie sipas programit të kontabilitetit është 49,736,256 lekë , pra ekziston një diferencë prej (987,565) lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25 datë 10.5.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, nenin 15 dhe ngarkojnë me përgjegjësi grupin e inventarizimit dhe Administratorin e UK Kavajë SHA për vitin 2018.(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)

5.11.1Rekomandimi:

Administratori i UK Kavajë SHA, të marrë masa për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të Shoqërisë në fund të vitit ushtrimor, sipas procedurave të miratuara ligjore, rezultatet e të cilit të pasqyrohen në bilancin ekonomiko- financiar të Shoqërisë.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

5.12. Gjetje nga auditimi: Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Shitjes në UK Kavajë SHA nuk ka kuadruar llogaritë e debitorëve dhe kreditorëve për vitin 2018. Referuar shërbimeve të kryera ndaj popullatës në lidhje me furnizimin me ujë dhe kanalizime, UK Kavajë SHA i kanë lindur debitorë të cilët për vitet e veprimtarisë të kësaj shoqërie nuk kanë shlyer detyrimet për shërbimin e marrë kundrejt faturimeve të realizuara. Në dokumentet e vëna në dispozicion grupit të auditimit nga Drejtoria e Shitjes janë paraqitur debitorët nga janari – nëntor 2018 dhe debitorët e muajit dhjetor pasqyrohen në janar të vitit 2019. Nga Drejtoria Tregtare pasqyrat e detyrimeve të debitorëve pasqyrohen deri në muajin dhjetor të vitit 2018. Konkretisht të dhënat e debitorëve nga Drejtoria Tregtare në vlerën 317,527,778 lekë, të dhënat e debitorëve nga Drejtoria e Shitjes në vlerën 307,366,000 lekë ku diferenca midis të dhënave nga Drejtoria e Shitjes është 10,161,778 lekë. Moskuadrimi i të dhënave të debitorëve nga Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Shitjes në UK Kavajë SHA ka denatyruar të ardhurën që i takon shoqërisë brenda vitit kalendarik të shoqërisë për periudhën 1.01-31.12.2018 dhe është veprim në kundërshtim me ligjin nr.9228 date 29.04.2008 " Për Kontabilitetin" , me SKK 4 "të ardhura dhe detyrime".*(Trajtuar më hollësisht në faqet 31-40, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

5.12.1Rekomandimi: Drejtoria Tregtare dhe Drejtoria e Shitjes të marrë masa për kuadrimin e të dhënave për debitorët e vitit 2018, referuar shërbimeve të kryera ndaj popullatës në lidhje me furnizimin me ujë dhe kanalizime, duke u bazuar në parimin bazë të kontabilitetit, sipas të cilit të ardhurat dhe shpenzimet evidentohen në momentin kur lind e drejta dhe detyrimi.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

VI. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

-Nga auditimi i dokumentacionit dhe sistemit elektronik të APP, UK Kavajë sh.a **për vitin 2018** ka parashikuar 26 prokurime me fond limit në vlerë 33,393,950 lekë, nga të cilat 18 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në vlerë 11,559,800 lekë dhe 8 procedura prokurimi "Kërkesë për propozim" me fond limit në vlerë 21,834,150 lekë. Gjatë këtij viti janë realizuar 10 procedura prokurimi, nga këto 7 procedura prokurimi blerje të vogla, me fond limit në vlerë 5,578,000 lekë e me vlerë të realizuar 5,031,500 lekë, diferenca midis vlerës së fondit limit dhe asaj të realizuar është 546,500 lekë (9.8% e fondit limit). Gjithashtu janë realizuar 3 procedura prokurimi, "Kërkesë për propozim" me fond limit në vlerë 14,000,000 lekë e vlerë të kontraktuar 8,828,939 lekë, diferenca midis vlerës së fondit limit dhe asaj të realizuar është 5,171,061 lekë(37% e fondit limit). Për vitin 2018 realizimi i prokurimeve kundrejt parashikimit, në vlerën lekë, është në masën 58.6%.

-Nga auditimi i dokumentacionit dhe sistemit elektronik të APP, UK Kavajë sh.a **për vitin 2019** ka parashikuar 30 prokurime me fond limit në vlerë 50,506,825 lekë, nga të cilat 23 procedura prokurimi blerje me vlerë të vogël me fond limit në vlerën 15,286,925 lekë dhe 7 procedura prokurimi "Kërkesë për propozim" me fond limit në vlerë 35,2019,900 lekë. Gjatë këtij viti janë realizuar 10 procedura prokurimi, nga këto 9 procedura prokurimi blerje të vogla, me fond limit në vlerë 7,786,925 lekë e me vlerë të realizuar 6,488,499 lekë, diferenca midis vlerës së fondit limit dhe asaj të realizuar është 1,298,426 lekë (16.7% e fondit limit). Gjithashtu është realizuar 1 procedurë prokurimi "Kërkesë për propozim" me fond limit në vlerë 6,000,000 lekë e me vlerë të kontraktuar 4,299,900 lekë, diferenca midis vlerës së fondit limit dhe asaj të kontraktuar është 1,700,100 lekë (28.3% e fondit limit). Për vitin 2019 realizimi i prokurimeve kundrejt parashikimit, në vlerën lekë, është në masën 27.3%.
Grupi i auditimit ka audituar të gjitha procedurat e prokurimit të realizuara për periudhën objekt auditimi.

6.1 Gjetje nga auditimi:

-Në 3 procedura prokurimi për vitin 2018 në vlerën 8,828,939 lekë dhe 1 procedurë për vitin 2019 në vlerën 4,299,900 lekë, nuk ka gjurmë të studimit të tregut, referim të kontratave të ngjashme, apo të dhëna referuar INSTAT, për të bërë të qartë mënyrën e përllogaritjes së fondit limit të kësaj procedurë, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", i ndryshuar, neni 59 "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës".

-Për një procedurë prokurimi për vitin 2019 "Blerje Karburanti" me vlerë 4,299,900 lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk është përcaktuar kufiri për marzhin e fitimit dhe nuk ka asnjë dokument që argumenton mungesën e përcaktimit të këtij elementi në DST, i cili shërben si kufi për të mbajtur një çmim të arsyeshëm dhe me ekonomicitet për shoqërinë duke minimizuar kostot e panevojshme. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit në vlerën, 2,954,789 lekë "Blerje Karburanti" për vitin 2018, referuar sistemit elektronik të APP, në skedarin e vlerësimit është konstatuar se dy nga anëtarët e KVO-së, nuk e kanë kualifikuar operatorin ekonomik "A..."sh.p.k, megjithatë në kualifikimin përfundimtar ky operator është shpallur fitues i kësaj procedure. Në dosjen shkresore të prokurimit nuk gjendet asnjë gjurmë e cila justifikon kualifikimin e këtij operatori të shpallur fitues, gjithashtu KVO nuk ka dokumentuar me raport përmbledhës të nënshkruar nga çdo anëtar i KVO, vazhdimin e procedurës për miratim nga titullari i AK. Përsa më sipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave.

-Ne 7 procedura me blerje të vogël për vitin 2018 në vlerën 5,031,500 lekë dhe 10 procedura me blerje të vogël për vitin 2019 në vlerën 6,488,499 lekë , në të gjitha rastet e blerjes së

mallrave dhe shërbimeve të planifikuara dhe jo të planifikuara , u konstatua se kërkesa e bërë për mallin apo shërbimin ishte formale pa argumentin e nevojës së kryerjes së shpenzimit nga specialistë të fushës dhe ku shpesh herë kjo kërkesë nuk kishte konfirmimin e magazinierit. Gjithashtu marrja në dorëzim e mallrave referuar procedurave me blerje me vlerë të vogël konfirmonte thjesht marrjen në dorëzim (konfirmim që e bën dhe magazina me fletë hyrjen e

mbajtur) dhe jo marrjen në dorëzim konform specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

- Në të gjitha procedurat e prokurimit dhe procedurat e prokurimit me blerje të vogël për periudhën 2018-2019, dosjet e vëna në dispozicion të grupit të auditimit janë të pasakta nga ana e rregullave të arkivimit, kjo në kundërshtim me ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", dhe në Rregulloren "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH", neni 13.
- Në të gjitha procedurat e prokurimit dhe procedurat e prokurimit me blerje të vogël për periudhën 2018-2019, dosjet e vëna në dispozicion të grupit të auditimit nuk gjenden deklaratat e konfliktit të interesit të nënshkruara nga anëtaret e komisioni të prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me, VKM Nr. 914, date, 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 11.
-Në të gjitha procedurat e prokurimit, blerje me vlerë të vogël për periudhën 2018-2019, janë pasqyruar dhe kanë kryer veprime në sistemin elektronik APP, "Njësi Prokurimi" dhe "Komision Vlerësimi të Ofertave", në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar.
- Në 7 procedura prokurimi për vitin 2018, blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 5,031,500 lekë (pa TVSH) dhe në 7 procedura prokurimi për vitin 2019 , blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 5,586,925 lekë (pa TVSH), konstatohet se: Znj.F.Gj me detyrë Drejtor Tregtar i Shoqërisë UKK është njëkohësisht edhe kryetare komisioni e blerjes me vlerë të vogël, në kundërshtim me ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 22, pika 5.
- Në 1 procedurë prokurimi për vitin 2019 , blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 800,000 lekë (pa TVSH), specifikimet teknike (vizatimet) janë në gjuhë të huaj, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 14, pika 2, paragrafi 3.
- Autoriteti Kontraktor Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kavajë sh.a për periudhën objekt auditimi viti 2018 dhe viti 2019, për çdo artikull mallrash të blerë nën vlerën 100,000 lekë (rreth 234 urdhra prokurimi), ka përdorur ligjin e prokurimit publik pavarësisht vlerës së mallit duke i trajtuar si blerje emergjente të cilat nuk i ka pasqyruar as në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike dhe nga mungesa e një plani ekonomik të detajuar sipas nevojave të çdo sektori, ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.914 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, pika 2,paragrafi 2 ku thotë në mënyrë eksplicite": "Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100,000 lekë deri në 800,000 lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlerë të vogël, siç përshkruhet në nenin 40 të këtyre rregullave. Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100,000 lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë".
- Stafi i organizimit të Procedurave të Prokurimeve në Ujësjellës Kanalizime Kavajë nuk ka kryer asnjë trajnim pranë APP për periudhën objekt auditimi në kundërshtim me LPP (Ligjin për Prokurimin Publik) dhe VKM nr.914 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar.

Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e Autoritetit Kontraktor dhe anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël për periudhën objekt auditimi.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-48, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandimi 6.1.1:Për rritjen e efiçencës në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kritereve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, Autoriteti Kontraktor të marrë masa që të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe me qëllim plotësimin e nevojave të tij.

Vazhdimisht

Rekomandimi 6.1.2:Nga sektori i prokurimit, ose personat e ngarkuar nga Administratori i Shoqërisë, përllogaritja e vlerës së kontratës, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, si dhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, në raport me specifikimet teknike.

Vazhdimisht

Rekomandimi 6.1.3 : Nga Shoqëria t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.

Vazhdimisht

Rekomandimi 6.1.4: Autoriteti kontraktor duhet që në çdo rast nevoje për kryerje shpenzimesh nën vlerën 100,000 lekë pavarësisht nga fakti që nuk do të përdorë procedurë prokurimi, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto objekte të kryhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi.

Vazhdimisht

Rekomandimi 6.1.5: Administratori i shoqërisë të marrë masa për planifikimin e programeve të trajnimit për stafin në lidhje me procedurat e prokurimit dhe përdorimin e sistemit elektronik të APP.

Vazhdimisht

6.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimeve "Kërkesë për Propozim" dhe procedurave blerje me vlerë të vogël, për vitin 2018 dhe vitin 2019 është konstatuar problematika e copëzimit të fondeve.

a. Nga auditimi i dy procedurave të realizuara **në vitin 2018**, konstatohet se janë mallra të të njëjti grupim dhe nga mbledhja e vlerave të përllogaritura për procedurat e kryera me vlerë të vogël respektivisht për procedurën "Blerje hipoklorit" 800,000 lekë dhe 790,000 lekë për procedurën "Blerje hipoklorit kalciumi dhe hipoklorit natriumi", Autoriteti Kontraktor duhet të kishte përdorur një procedurë tenderi mbi kufirin e fondit për procedurat me blerje të vogël, por ndërkohë ka kryer copëtim fondi duke realizuar dy procedura blerje të vogël për të njëjtin grupim mallrash në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me blerje të vogël", i ndryshuar, pika 4 dhe VKM nr.914 "Për rregullat e prokurimit publik" datë 29.12.2014,i ndryshuar. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e Autoritetit Kontraktor për periudhën objekt auditimi dhe anëtarët e komisionit te prokurimit me vlere te vogël sipas urdhrit nr. 03 date 17.01.2018 të titullarit për krijimin e komisionit për prokurimit me vlerë të vogël.

b. Për vitin 2018 Autoriteti Kontraktor përpara se të kryente procedurën "Kërkesë për Propozim" me objekt "Blerje Diesel", është konstatuar se, ka prokuruar një shtesë kontrate

me objekt "Blerje Diesel" të kontratës bazë nr.648, datë 30.06.2017 me operatorin e mëparshëm, me vlerë 532,362 lekë, pa përcaktuar litrat e karburantit, pa përcaktuar as datën e lëvrimit të mallit. Autoriteti Kontraktor ka zhvilluar procedurën Kërkesë për propozim "Blerje Karburanti" me vlerë 2,751,200 lekë pa TVSH por nuk ka përfunduar procedurat për lidhjen e kontratës edhe pse ka publikuar operator fitues. Gjatë periudhës së publikimit të operatorit fitues, Autoriteti Kontraktor ka vazhduar të prokurojë, Blerje me Vlerë të Vogël 600 litra Diesel 10 ppm, me shënimin që ky karburant duhet për nevojat emergjente të ndërmarrjes pa analizë gjendje në magazine, likuiduar me faturën nr.369, datë 18.04.2018 në vlerën 79,625 lekë pa TVSH.Nga Autoriteti Kontraktor, në asnjë rast nuk është paraqitur një analizë e saktë e gjendjes së karburantit/diesel sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, të vërtetuar me dokumentacion mbi lëvrimin e karburantit si dhe nuk pasqyrohet me fleta udhëtimi dhe urdhra shërbimi harxhimi i karburantit nga mjetet e UK Kavajë sh.a, në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30,datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kapitulli III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" Dokumentimi i lëvizjeve pikat 34, 35/b, 38 dhe 39. Përsa më sipër vlera e prokuruar me procedurën e emergjencës, konsiderohet copëtim i fondeve duke realizuar një procedura me blerje të vogël dhe një procedure "Kërkesë për Propozim" ,brenda të njëjtit vit për të njëjtin grupim mallrash në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me blerje të vogël", i ndryshuar, pika 4 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për rregullat e prokurimit publik, i ndryshuar. Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e Autoritetit Kontraktor për periudhën objekt auditimi dhe anëtarët e komisionit te prokurimit me vlere te vogël sipas urdhrit nr. 03 datë 17.01.2018 të titullarit, për krijimin e komisionit për prokurimit me vlerë të vogël.

c. Për vitin kalendarik 2019 është konstatuar copëzimi i fondeve për mallrat, tuba e rakorderi, klor dhe kapakë pusetash, si më poshtë:

-Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se, AK ka zhvilluar procedura për "Blerje Tuba Uji", me fond limit 795,000 lekë (pa tvsh), dhe "Blerje Rakorderi", me fond limit 791,925 lekë (pa tvsh). Këto mallra përfshihen ne te njëjtin grup dhe kanë të njëjtin funksion kryesor dhe duhet te prokuroheshin se bashku. Vlera totale, prokuruar e copëzuar, 1,586,925 lekë (pa tvsh) duhej të prokurohej në një procedure të vetme**.**

-Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për mallin "Klor" AK ka zhvilluar procedura, blerje me vlerë nën 100,000 lekë (pa TVSH), blerje me vlerë të vogël, me fond limit 800,000 lekë (pa TVSH) dhe blerje me vlerë të vogël me fond limit 600,000 lekë (pa TVSH). Vlera totale, prokuruar e copëzuar 1,500,000 lekë (pa tvsh) duhej të prokurohej në një procedure të vetme.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se për mallin "Kapak pusetash" AK ka zhvilluar procedura, blerje me vlerë nën 100,000 lekë (pa TVSH) dhe blerje me vlerë të vogël me fond limit 800,000 lekë (pa TVSH Vlera totale, prokuruar e copëzuar, 900,000 lekë (pa tvsh) duhej të prokurohej në një procedure të vetme. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 41-48, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

6.2.1Rekomandim: Titullari i Ujësjellës Kanalizime Kavajë sh.a, njësia e prokurimit, të marrin masa që në të ardhmen, të shmangë praktikat e copëzimit të fondeve për mallra të së njëjtës kategori.

Vazhdimisht

VII. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit dhe Auditin e Brendshëm

7.1. Gjetje nga auditimi: Grupi audites kreu verifikimet mbi implementimin dhe plotësimin e kërkesave mbi funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale dhe realizimin e objektivave të vendosura, dhe për komponentin e parë te MFK, për mjedisin e kontrollit u konstatua që: Administratori i Shoqërisë UKKa, nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) dhe Këshillin Teknik të Shoqërisë UKKa.Shoqëria UKKa nuk ka hartuar plan biznesi afatgjatë, duke operuar pa program ekonomik për periudhën objekt auditimi. Shoqëria UKKa është e pa orientuar strategjikisht. Mungesa e Planit të biznesit ka ndikuar në përcaktimin e objektivave strategjik, të cilat duhen të jenë specifikë, të matshëm dhe me afate kohore të përcaktuara. UKKa, nuk e ka miratuar statutin e shoqërisë nga Këshilli i Administrimit. Rregullorja e Brendshme mbi Organizimin dhe Funksionimin e Strukturave dhe Detyrave në Ujësjellës Kanalizimin SH.A., Kavajë, e miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit Nr. 97/5 Prot. datë 10.02.2017, është në kundërshtim me përcaktimet e VKM nr. 63 date 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", pasi; a)Rregullorja e Brendshme e UKKa, ka mos përputhje me strukturën organizative të miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 768/4 Prot. datë 02.08.2017; b) Rregullorja i referohet UKD (Ujësjellës Kanalizime, Durrës) dhe jo Ujësjellës Kanalizime, Kavajë; c)Rregullorja i referohet Këshillit Mbikëqyrës dhe jo Këshillit të Administrimit, si organ drejtues në Shoqërinë UKKA. Administratori i shoqërisë për përudhën respektive brenda objektit të auditimit, nuk ka deleguar kompetencat ose detyrat anëtarëve të caktuar të stafit drejtues, sipas objektivave dhe detyrave te shoqërisë, në kundërshtim me nenin 15 të ligjit për MFK. Përgjatë vitit 2018-2019, nr. i përgjithshëm i punonjësve të UKKa, rezulton të ketë rritje në krahasim me numrin e përgjithshëm të punonjësve të miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 768/4 Prot. datë 02.08.2017. Administratori përkatës për periudhën respektive të ushtrimit të funksionit, brenda periudhës objekt auditimi, ka rritur numrin e strukturës organizative me punonjës përtej numrit të përgjithshëm të strukturës së miratuar nga KA, dhe në fund të vitit 2019, Shoqëria UKKa rezulton me 304 punonjës.

-Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kavajë në fund të vitit 2019, rezulton me 25,124 lidhje (abonentë), pra çka tregon që UKKa ka 12.5 punonjës për 1,000 lidhje, duke e renditur UKKa me treguesin më të larte të nr. të punonjësve për 1,000 lidhje krahasuar me standardet dhe mesataren kombëtare të ujësjellës kanalizimeve në vend, që është rreth 4.5-6 punonjës për 1,000 lidhje. Administratori i Shoqërisë UKKa, për periudhën respektive brenda periudhës objekt auditimi, nuk ka kryer vlerësime periodike të stafit të shoqërisë (ngritje ose ulje në detyrë) mbi performancën dhe realizimin e detyrave të punonjësve, mbi bazën e përshkrimeve të detyrave në kontratën e punës dhe rregulloren e përgjithshme.

Sektori i marrëdhënieve me publikun pranë shoqërisë UKKa, trajton ankesat e qytetarëve në lidhje me shërbimin e ofruar. Qytetarët që kanë ankesa për shërbimin e ofruar nga Shoqëria UKKa, paraqiten pranë këtij sektori duke plotësuar formularin e ankesave. Punonjësit e këtij sektori i regjistrojnë ankesat e qytetareve manualisht dhe jo në sistemin informatik "Albilling", i cilin e mundëson regjistrimin e tyre në modulin "regjistrimi i ankesave".

Për vitin 2018 në Shoqërinë UKKa, janë regjistruar 77 ankesa të përgjithshme (kryesisht ankesat janë për mbifaturim) dhe 61 ankesa për probleme inxhinierike. Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 131 ankesa të përgjithshme dhe 116 për probleme inxhinierike. Trajtimi i ankesave të qytetarëve bëhet nga departamente/ drejtori/ sektor përkatës ku është adresuar ankesa.

Shoqëria UKKa, nuk ka zbatuar kërkesat e ligjit për arkivat dhe rregullat e caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave për sistemimin dhe shfrytëzimin e dokumenteve. Nga auditimi u konstatua që: a) dokumentet e arkivuara nuk janë të dokumentuara në regjistrin e

hyrjeve-daljeve; b) nuk janë përpiluar pasqyrat emërtuese në regjistër, në bazë të gjitha kritereve arkivore të cilat janë: të objektit, të autorit, të korrespondentit, të ndarjes territoriale–administrative, të llojit të dokumentit, të kohës; c) pasqyra emërtuese nuk është miratuar nga administratori i shoqërisë.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 48-53, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandime 7.1.1: Administratori i shoqërisë të marrë masa për hartimin dhe miratimin e statutit, rregullores së brendshme dhe plan biznesit afatgjatë.

Brenda 6 mujorit të parë 2020

Rekomandimi 7.1.2: Administratori i shoqërisë të miratoj pasqyrën emërtuese për dosjet e arkivuara dhe të marri masa për regjistrimin e tyre.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

7.2. Gjetje: Në drejtim të vlerësimit për menaxhimin e riskut, u konstatua që: Shoqëria UKKa nuk ka hartuar regjistër risku për identifikimin, kategorizimin, ndjekjen dhe minimizimin e risqeve që mund të shfaqen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

-Shoqëria nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS) të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë një raport vjetor mbi problematikat e hasura. Koordinatori i riskut nuk është emëruar, por funksionet e tij, i kryen Administratori i shoqërisë sipas përcaktimeve në MFK.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 48-53, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandime 7.2.1: Administratori i Shoqërisë në bashkëpunim me Këshillin e Administrimit të marrë masa, për hartimin dhe miratimin e politikave të menaxhimit të riskut.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

7.3. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të komponentit të MFK për "*aktivitet e kontrollit"*, u konstatua që: Shoqëria UKKa nuk ka përgatitur hartën e proceseve dhe gjurmëve të auditit, nuk ka të regjistruar asetet e saj dhe nuk ka evidentuar vlerat e aktiveve afatgjata, të cilat nuk janë të përditësuara në një regjistër të posaçëm në lidhje me kronologjinë e vlerës ndër vite, rivlerësimin, amortizimin etj., probleme të mbartura ndër vite.

-Administratori i shoqërisë nuk ka paraqitur deklaratën e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm të UKKa, si edhe Raportin e Vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Shoqëria UKKa, përdor sistemin informatik "*Albilling*" për faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave. Nga analizimi i raporteve që gjeneron sistemi konstatohet që, ka problematika si në drejtim të numrit të limituar të raporteve që gjenerohen, por dhe në drejtim të cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave. Gjatë analizimit të të dhënave p.sh., duke krahasuar të dhënat e një abonenti mbi bazën e numrit të kontratës, rezulton që në paraqitjen e "*raportit mujor të arkëtimit*" dhe "*raportit mujor me zëra*", rezultojnë të dhëna të ndryshme. Gjithashtu në raportet e gjeneruara nga sistemi informatik *"Albilling",* gjatë eksportimit të të dhënave në formatin "*excel*", ato nuk ruajnë parametra të njëjtë të renditjes për çdo muaj. Sistemi informatik *"Albilling",* nuk ka *"backup"* të bazës së të dhënave, duke cenuar sigurinë e tyre.

UKKa, nuk ka hartuar rregullore në nivel administrimi për përdoruesit e sistemit *"Albilling".*

Në sistemin informatik *"Albilling"* nuk pasqyrohen abonentët pa matësa.

Në rubrikën "raport mbi abonentët" nuk pasqyrohet nr. i abonentëve me dhe pa matësa. Në fund të vitit 2019, nr. i abonentëve familjare pa matësa ishte 17,077, kjo e dhënë është marrë nga Drejtoria e Shitjeve pranë UKKa dhe jo nga sistemi, i cili nuk e pasqyron këtë të dhënë.

UKKa nuk ka laborator për kryerjen e analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike për monitorimin e cilësisë së ujit, në kundërshtim me VKM 379 datë 25.05.2016. Për miratimin e rregullores "Cilësia e ujit të pijshëm".Laboratori i analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike

në ITUN pranë UKKa, nuk funksionon. Sistemi SCAD funksionon vetëm në pikën e furnizimit me ujë, në Çermë të Lushnjës. Ky sistem nuk është i shoqëruar me manual shpjegues, dhe nuk gjeneron raporte mbi treguesit kryesor. Sistemi SCAD nuk gjeneron *log-in* për të evidentuar gjurmimin në kohë të funksionimit të kësaj pike furnizimi të UKKa, me ujë të pijshëm. Sistemi SCAD në ITUN nuk funksionon.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 48-53, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandime 7.3.1: Administratori i Shoqërisë UKKa, të kërkojë nëpërmjet Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme ,përfshirjen në programet e auditimit të NjAB të Bashkisë Kavajë edhe Shoqërinë UKKa.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

Rekomandime 7.3.2: Administratori i Shoqërisë UKKa, të marrë masa për vënien në funksionim të plotë të sistemit të faturimit të ujit *Albilling.*

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

7.4.Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të komponentit të MFK për "*Informacioni dhe komunikimi"*, u konstatua që:

-Në Rregulloren e brendshme të shoqërisë UKKa, nuk është përcaktuar mënyra e komunikimit të informacionit të shkruar/elektronik/verbal, brenda strukturave të UKKa. Komunikimi i brendshëm dhe jashtë institucionit, bëhet me adresa personale dhe jo me e-mail zyrtar. UKKa, nuk posedon faqe Web-i zyrtar. Shoqëria UKKa, nuk ka të publikuar online programin e transparencës**,** në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit". Zyra e marrëdhënieve me publikun, pranë UKKa nuk shfrytëzon sistemin informatik "*Albilling"* për regjistrimin dhe trajtimin e ankesave të qytetareve. Shoqëria UKKa, nuk ka përcaktuar procedura mbi mënyrën e raportimit ditor apo periodik mbi ecurinë dhe realizimin e treguesve ekonomiko financiar të shoqërisë.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 48-53, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandime 7.4.1: Shoqëria të krijoj faqen e web-it zyrtar, ku të pasqyrojë edhe programin e trasparencës, si dhe komunikimi elektronik brenda dhe jashtë institucionit të kryhet me adresë e-mail zyrtar.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

7.5. Gjetje nga auditimi: Në drejtim të vlerësimit të komponentit të MFK për monitorimin u konstatua që Shoqëria nuk ka ngritur Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NJAB), gjithashtu kjo shoqëri nuk është audituar asnjëherë nga struktura e Auditit të Brendshëm të Bashkisë Kavajë. UKKa, nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2018 dhe 2019, në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 28, datë 15.12.2011 "Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësitë publike". (*Trajtuar më hollësisht në faqet 48-53, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandime 7.5.1: Administratori i shoqërisë të marrë masa për ngritjen e Njësisë së Auditit të Brendshëm.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

VIII. Zbatimi i standardeve shtetërore të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura që shkarkohen në mjedis.

8.1 Gjetje nga auditimi: Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime Kavaje" sh.a kryen veprimtarinë me objekt prodhimin, grumbullimin, përpunimin, shpërndarjen e ujit për konsum publik dhe largimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura. Prodhimi dhe furnizimi me ujë të pijshëm i

popullatës, enteve private (biznesit) dhe institucioneve shtetërore është me ngritje mekanike, burimet janë ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore. Uji prodhohet nga, stacioni i pompimit Çermës me gjashtë kaptazhe (puse), stacioni i pompimit Harizaj me tre kaptazhe (puse) si dhe impianti i përpunimit të ujit të pijshëm Maskuria që burim (ujëra sipërfaqësor) ka ujëmbledhësin "Rezervuari i Maskurisë". Stacioni i pompimit të Çermës furnizon depon kryesore që shërben për qytetin e Kavajës dhe depon e Maskurisë gjatë sezonit turistik ku kërkesat për ujë të pijshëm janë të mëdha. Stacioni e Pompimit Harizaj furnizon me ujë të pijshëm depot që shërbejnë për zonën rurale.

-Nga vizita ne terren e grupit te auditimit në Stacionin e Pompit të Çermës dhe kaptazheve (pusçpimet) u konstatua se: kaptazhet (veprat e marrjes së ujit) janë në oborrin e shtëpive private të cilat nuk janë të lidhura me një sistem kanalizimesh për largimin e ujërave të ndotura. Ujërat e ndotura grumbullohen në gropa septike të cilat nuk janë të izoluara. Gjithashtu në oborrin e shtëpive, ku ndodhen kaptazhet (puset e ujit) ka dhe stalla bagëtish që mbarështohen nga pronarët. Për të gjitha puset nuk është realizuar plotësisht mbrojtja higjeno-sanitare e kaptazheve (burimet nëntokësore) veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit të pijshëm", neni 11, shtojca IV "Zonat e mbrojtjes sanitare" pika 2 "Mbrojtja sanitare e burimeve të ujërave nëntokësore"

-Nga grupi i auditimit u konstatua se: dezinfektimi i ujit të pijshëm bëhet me metodën kimike me produktet dezinfektuese, hipokloriti i kalciumit dhe hipokloriti i natriumit. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i natriumit bëhet në mënyrë automatike me dozim, në varësi të prurjeve nga kaptazhet, në stacionin e pompimit Çermë. Dezinfektimi me produktin hipoklorit i kalciumit bëhet në shuarësin e presionit në qytetin e Kavajës si dhe në depon Golem.Nga auditimi i dosjeve të personelit të vëna në dispozicion, administruar nga Departamenti i Burimeve Njerëzore, për punonjësit që kryejnë dizinfektimin e ujit në periudhën objekt auditimi, Depo/shuarësi i presionit Kavajë, Specialisti i Pompimit Çermë dhe Specialisti i Depos Golem, konstatohet se nuk gjenden dëshmi të gjendjes shëndetësore të tyre, në kundërshtim me VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit te pijshëm", neni 17. Gjithashtu konstatohet se nuk janë kryer analizat e përbërjes fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm për çdo pus, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit.

Rekomandime 8.1.1: Administratori i Shoqërisë duhet të marrë masat e nevojshme që analizat e përbërjes fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm për kaptazhet, të kryhen në mënyrë periodike dhe në varësi të ndotjes që krijohet brenda zonës 1, për të përcaktuar trajtimin kimik të ujit si dhe kryerjen e analizave te produkteve dezinfektuese nga ana e ISHP, sipas legjislacionit ne fuqi (VKM Nr. 379, datë 25.05.2016, "Për miratimin e rregullores Cilësia e Ujit të Pijshëm", neni 14, pika 4), para se ato të përdoren për trajtimin e ujit te pijshëm.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-58, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Vazhdimisht

Rekomandime 8.1.2: Administratori i Shoqërisë dhe organet drejtuese duhet të marrin masat e nevojshme që punonjësit, të cilët kryejnë dezinfektimin e ujit të pijshëm dhe janë në kontakt me ujin e pijshëm të jenë të pajisur me dëshmi të gjendjes shëndetësore sipas rregullores për pajisjen me librezë shëndetësore profesionale.

Menjëherë

Rekomandime 8.1.3: Shoqëria në bashkëpunim me ISHP të hartojë një rregullore (metodikë) të kryerjes të analizave fiziko-kimike dhe bakteriologjike të ujit të pijshëm, në burimet e ujit dhe sistemin shpërndarës, gjithashtu hartimin e një protokolli se si duhet të veprohet në rastet

e ndotjes, marrjen e masave në mënyrë rigoroze dhe të menjëhershme, për mbrojtjen e shëndetit publik.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

8.2 Gjetje nga auditimi: Shoqëria e "Ujësjellës Kanalizime Kavajë" Sh.a. kryen shërbimin e largimit të ujërave të ndotura për qytetin e Kavajës dhe zonën e plazhit Golem. Largimi i ujërave të ndotura nga qyteti i Kavajës bëhet me vetërrjedhje dhe për zonën Golem me ngritje mekanike nëpërmjet gjashtë stacioneve të pompimit pa presion. Sistemin i kanalizimeve mbledh ujërat e ndotura të familjareve, bizneseve private dhe aktiviteteve industrialeve dhe trajtohen nga impianti i pastrimit te ujërave të ndotura. Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotura (ITUN) në Kavajë, është i pari impiant i këtij lloji i ndërtuar në Shqipëri pas viteve 90, ka filluar të funksionojë që nga Tetori i vitit 2005. Vendndodhja e ITUN është në fshatin Qerret, në një distancë 0,6 km larg bregut të detit dhe afërsisht 6 km larg nga qendra e qytetit të Kavajës. Impianti përdor për trajtimin e ujërave të ndotura metodën biologjike, konkretisht metodën e trajtimit me filtër biologjik, të llojit filtër me pikim. Në vitin 2015 kanë përfunduar punimet për zgjerimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura që vijnë nga zona Plazh Golem, për të patur një funksionim fleksibël për të përballuar një shkallë të gjerë prurjesh dhe karakteristikash të ujit të ndotur.

Nga grupi i auditimit në ITUN u konstatua se impianti nuk i kryen të gjitha proceset për pastrimin e ujërave të ndotura, konkretisht:

-Trajtimi paraprak, kryen procesin e eliminimit të mbetjeve dhe copërave të madha, rërëmbledhësi për eliminimin e materialit të trashë në suspensë dhe yndyrëmbledhësi për largimin e vajrave dhe yndyrës. Pajisjet që kryenin këtë proces janë në gjendje pune por kërkojnë mirëmbajte të tyre për vazhdimësinë e trajtimit të ujërave të ndotura.

-Trajtimi primar përfshin largimin e pjesshëm të lëndëve në suspensë dhe lëndëve organike me anë të metodave fizike të tilla si sedimentimi, flotimi dhe sitimi. Për të përmirësuar trajtimin primar ose ndryshe trajtimi me fotosinteze përdoret flokulimi i para-ajruar. Në dekantuesin primar, ajrosja, largimi i llumit dhe kalimi i materialit për t'ju nënshtruar proceseve të tjera kryhet nga dy pajisje lundruese (draga) të cilat lëvizin me telekomande. Nga grupi i auditimit u konstatua se këto dy pajisjet lundruese dhe aparaturat (pompa, përzierësi dhe tubat) ishin për një kohë të gjatë jashtë funksionit, këtë e tregonte korrozioni i tyre, e për rrjedhojë proceset e tjera të trajtimit nuk kryheshin.

-Trajtimi sekondar kryhen largimin i lëndëve organike të tretura dhe koloidale, si dhe i lëndëve të ngurta në suspensë që e kanë kaluar trajtimin primar. Nga grupi i auditimit u konstatua se ky proces nuk kryhej për arsye se pompat dhe tubacionet janë jashtë funksionit.

-Trajtimi terciar e kalon nivelin e trajtimit tradicional sekondar për të larguar sasi të rëndësishme të azotit, fosforit, metaleve të rënda, lëndëve organike të biodegradueshme, baktereve dhe viruseve. Në këtë proces trajtohet materiali nga dekantuesi primar pasi janë veçuar materialet e ngurta. Nga grupi i auditimit u konstatua se ky proces nuk kryhej për arsye se pompat dhe tubacionet janë jashtë funksionit.

-Trajtimi i llumit i cili përmban lëndë të ngurta organike dhe inorganike që janë larguar nga rrjedha e ujit me anë të dekantuesit primar dhe lëndët organike të prodhuara gjatë trajtimit sekondar biologjik dhe të larguara me anë të dekantuesit sekondar, trajtohet në mënyra të ndryshme. Nga grupi i auditimit u konstatua se llumi nuk trajtohej. Gjithashtu u konstatua se, llumi dhe materialet e ngurta nga dekantuesi primar nuk është larguar për një kohë të gjatë duke zvogëluar sasinë përpunuese e duke dëmtuar bazamentin e tij.

Shkarkimi i ujërave të ndotura, pas dekantimit mekanik në ITUN Qerret, derdhen në detin Adriatik. Bazuar në kushtin që trajtimi i ujërave të ndotura është përdorimi i metodave fizike, kimike dhe biologjike, trajtim i cili mungon në ITUN Qerret.

Ne ITUN ka sistem të kontrollit "SKADA" që shërben për komandimin e gjithë procesit në mënyrë automatike si dhe gjeneron të dhënat e nevojshme. Nga grupi i auditimit u konstatua se sistemi SCADA është jashtë funksionit si dhe shoqëria nuk ka staf specialist për përdorimin e tij. Laboratori i ITUN duhet të kryej analizat e ujërave të ndotura, në nyje të ndryshme të procesit, sipas skemës funksionale dhe metodës biologjike që është projektuar. Analizat që duhet të kryhen janë vlerat e NKO-së (Nevoja Kimike për Oksigjen) dhe të NBO-së (Nevoja Biokimike për Oksigjen) të shprehura në mg/l O_2 si dhe lënda e ngurtë pezull e shprehur mg/l. Nga grupi i auditimit u konstatua se laboratori nuk kryen analizat e kërkuara, në staf nuk ka punonjës laborant sipas strukturës si dhe reagentët që gjendeshin në laboratorin e impiantit ishin të skaduar. Nga ish laborantja Znj. J.Gj nuk janë kryer analizat e ujit të ndotur në të gjitha fazat dhe nuk ka mbajtur regjistra të saktë për shkarkimin e ujërave në mjedisin pritës. Gjithashtu nga grupi i auditmit u konstatua se, të gjitha pompat janë jashtë funksionit, ka çarje të tubacioneve të filtrimit, pajisjet elektrike kanë probleme të theksuara dhe pajisja për kryerjen e procesit filtrim me pikim janë jashtë funksionit.

Për sa më sipër, ITUN Kavajë nuk kryen proces të plotë të trajtimit të ujërave te ndotura, kryen procesin paraprak dhe atë primar jo të plotë, kështu që nuk jep rezultatin e pritshmërisë së investimit, nuk plotëson normat dhe standardin e cilësisë që duhet të plotësoj uji i trajtuar përpara se të derdhet në trupat ujore pritëse, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011"Për mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr.177, dt. 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse", si dhe direktivën e Bashkimit Evropian 91/271/EEC. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-58, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandim 8.2.1: Administratori i Shoqërisë, të krijojë një grup pune me specialist të fushës përkatëse për evidentimin e problemeve në ITUN. Gjithashtu të evidentohen nevojat e kërkesat, dhe të hartohet një plan pune i detajuar, sipas të gjitha proceseve, për vënien në efiçensë të plotë të ITUP në një kohë sa më të shkurtër.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

Rekomandim 8.2.2:Të vihet në funksionim laboratori në ITUN, sipas standardeve shtetërore, dhe të kryhen në mënyrë rigoroze e të vazhdueshme analizat e ujit të ndotur që shkarkohet në mjedisin pritës.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

Rekomandim 8.2.3: Nga ana e shoqërisë të evidentohen dhe të krijohet një regjistër për të gjitha subjektet komerciale dhe industriale që shkarkojnë ujin e ndotur në sistemin publik të kanalizimeve. Nga ana e shoqërisë të kërkohet/monitorohet kryerja e analizave të ujërave të ndotura, nga vetë subjektet komerciale dhe industriale, në zbatim të standardeve shtetërore, për të ulur koston e përpunimit të ujërave të ndotura në ITUP. Në rast të moskryerjes së analizave të merren masa administrative ndaj këtyre subjekteve, sipas legjislacionit në fuqi.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

8.3 Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 deri 06.09.2018 operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Kavajë ka kryer veprimtari të pa licensuar në të gjitha kategoritë, A,B,C e D, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i

ndryshuar. Për kryerjen e veprimtarisë të pa licensuar, në të gjitha kategoritë, nga operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Kavajë, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU me Vendim Nr. 42, datë 13.06.2018 ka dënuar me gjobë në shumën 300,000 lekë për ushtrimin e veprimtarisë pa licensë dhe në shumën 100,000 lekë për mospagimin e detyrimeve financiare ndaj ERRU, brenda afateve kohore të përcaktuara nga ky institucion.Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se për mospagim të detyrimeve financiare ndaj ERRU, Përmbaruesi Gjyqësor G.F me shkresën Nr. 65/42 Prot. datë 02.07.2018, ka nxjerrë " Urdhër për vënien sekuestro konservative" në zbatim të Urdhrit Ekzekutues Nr.5583/U datë 03.07.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në shumën 5,346,470 lekë. Nga dokumentet financiare të vendosura në dispozicion konstatohet se detyrimi i mbartur ndaj ERRU, deri në përfundim të auditimit, është 5,779,600 lekë. Shoqëria e UK Kavajë është e licensuar nga ERRU (Enti Rregullator i Ujit) me Vendimin Nr. 65, datë 06.09.2018, me mbarim afati 05.09.2022. sipas licencës operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Kavajë autorizohet të kryej veprimtarinë përkatëse për kategoritë, A-*për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik*, B-*për përpunimin e ujit për konsum publik*, C-*për largimin e ujërave të ndotura*. Nga grupi i auditimit u konstatua se, për kategorinë D-*për përpunimin e ujërave të ndotura*, operatori sh.a Ujësjellës Kanalizime Kavajë kryen veprimtari të pa licensuar ne Impiantin e Përpunimit të Ujërave të Ndotura. Mos licensimi për kategorinë nga ana e ERRU është si rezultat se shoqëria UK Kavajë nuk është pajisur me Leje Mjedisore për ITUN kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 10,431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", seksioni 2, neni 29, pika 1*(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-58, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Rekomandim 8.3.1: Administratori i Shoqërisë, Këshilli Administrimit të marrin masa për përgatitjen e raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pajisje me Leje Mjedisore për ITUN që është kusht paraprak për licensimin e shoqërisë nga ana e ERRU për përpunimin e ujërave të ndotura

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

Rekomandim 8.3.2: Nga ana e shoqërisë të arrihet në një marrëveshje me ERRU, për shlyerjen e detyrimeve financiare dhe ato të prapambetura, duke shmangur bllokimin e llogarive bankare të cilat për rrjedhojë vendosin shoqërinë në vështirësi financiare.

Brenda 6 mujorit të parë të vitit 2020

C. <u>MASA PËR SHPËRBLIM DËMI</u>

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i listëpagesave për periudhën objekt auditimi 2018-2019 u konstatua një tejkalim i strukturës së shoqërisë nga ajo e miratuar me vendim të Këshillit Administrativ deri në 150 punonjës mbi strukturë (gjatë muajve muajve; tetor, nëntor, dhjetor, 2019 numri total i punonjësve ka arritur mbi 315 punonjës nga 152 punonjës që ka në strukturë e miratuar) duke i shkaktuar shoqërisë për vitet 2018-2019 një **dëm ekonomik pa mundësi arkëtimi në paga në shumën 79,388,728 lekë** dhe për efekt zinxhir në sigurime shoqërore vlera e dëmit ekonomik pa mundësi arkëtimi është **10,414,628 leke** dhe e TAP prej **3,180,845 lekë.** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me strukturën e miratuar nga Këshilli i Administrimit i UKKa SH.A, Pika "b" e Nenit 134, neni 154 "Të drejtat dhe detyrimet" ligj nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", statutin tip të shoqërisë së UKKa SH.A, në zbatim të VKM nr. 63 datë 27.1.2016, *"Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura"*, rregulloren e brendshme e UKKa Sh.a dhe kontratat individuale të punës. Për këto veprime mban përgjegjësi ish Administratori

i UK Kavajë SHA z.B.T për periudhën 15.08.2019-31.12.2019. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

1.1Rekomandime: Shoqëria dhe Drejtoria e Financës duhet të marrë masa për shqyrtimin e e **dëmit ekonomik pa mundësi arkëtimi** në vlerën totale **92,984,201 lekë**, të ardhur si pasojë e punësimeve mbi strukturë, për evidentimin e përgjegjësive, për shmangien e kostove të cilat mbartin risk të lartë për efekt negativ financiar në të ardhmen pasi shoqëria figuron me humbje që prej vitit 2015 dhe kryerjen e menaxhimit efikas për rritjen e rentabilitetit të shoqërisë.

Brenda 6 mujorit të parë 2020

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit për vitin 2018 dhe vitin 2019 u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës.
Kartelat për tërheqjen e karburantit janë nënshkruar nga titullari i UK Kavajë për periudhën objekt auditimi ose personi i autorizuar në formë verbale nga Titullari i UK Kavajë SHA, sipas periudhës objekt auditimi. Automjetet e UK Kavajë SHA, nuk janë të pajisura me sistemin GPS, nuk kontrollohen km e përshkuar referuar normativave të harxhimit të përcaktuara nga patenta shoqëruese e mjeteve dhe për mjetet e përdorura nuk janë të miratuara normativat e konsumit/100km për këtë qëllim, si dhe nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina. Nga verifikimi i gjendjes së karburantit sipas evidencës nga programi Alpha Platinium në datën 18.02.2020, në zyrën e financës në UK Kavajë SHA për periudhën 2018-2019 nuk rakordon vlera hyrje e Naftës sipas kartelës nr.01306 dhe vlera dalje e Naftës sipas kartelës nr.01306, sipas sasive të tërhequra gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit në Ujësjellës Kanalizime Kavajë për vitin 2018 dhe vitin 2019, nuk dokumentohet me urdhërdorëzim, fletëkërkesë dhe plan të shpërndarjes të kartelës limit shpenzimi i naftës për vitin 2018 prej 4,457,238 lekë për 31,752 litra dhe shpenzimi i naftës për vitin 2019 për 3,726,099 lekë për 25,946 litra. **Për rrjedhojë vlera 8,183,337 lekë, përbën dëm ekonomik të mundshëm për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, dhe nqs nuk paraqitet dokumentacioni i mësipërm duhet të dëmshpërblehet nga** ish Administratorët e UK Kavajë SHA z.H.T për periudhën 01.01.2018-1.08.2019, z.E.D për periudhën 2.08.2019-13.08.2019, Administratori i UK Kavajë SHA z.B.T për periudhën 15.08.2019-31.12.2019, përgjegjësit e shpërndarjes së karburantit znj.R.B për periudhën 11.03.2019-31.07.2019, znj.F.Gj për periudhën 21.07.2019- 31.08.2019, z.M.SH për periudhën 21.08.2019-31.12.2019 dhe z.N.C me detyrë magazinier, për periudhën 1.01.2018-31.12.2019. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 28-31, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

2.1Rekomandime: Nga Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, të ndiqen të gjitha hapat ligjore dhe administrative për arkëtimin e vlerës **8,183,337 lekë** e cila përbën dëm ekonomik të mundshëm për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, dhe nqs nuk paraqitet dokumentacioni i mësipërm duhet të dëmshpërblehet nga ish Administratorët e UK Kavajë SHA z.H.T për periudhën 01.01.2018-1.08.2019, z.E.Dpër periudhën 2.08.2019-13.08.2019, Administratori i UK Kavajë SHA z.B.T për periudhën 15.08.2019-31.12.2019, përgjegjësit e shpërndarjes së karburantit znj.R.B për periudhën 11.03.2019-31.07.2019, znj.F.Gj për periudhën 21.07.2019- 31.08.2019, z.M.SH për periudhën 21.08.2019-31.12.2019 dhe z.N.C me detyrë magazinier, për periudhën 1.01.2018-31.12.2019.

Brenda vitit 2020

3.Gjetje nga auditimi : Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Kapak Pusetash" në sistemin elektronik në skedarin "Njoftimi i Fituesit" konstatohet se OE "A.M.U" me ofertën më të ulët është publikuar fitues me datën 02.09.2019 ora 11:43 dhe OE në vendin e dytë është publikuar fitues me datën 02.09.2019, ora 13:11, pra nuk është pritur dy orë për të publikuar fitues OE të renditur në vendin e dytë. Ky veprim është në kundërshtim me kërkesën e vetë AK në DST ku thuhet se OE i shpallur fitues duhet të konfirmojë pjesëmarrjen brenda dy orëve. Në dosje nuk gjenden dokumente që justifikojnë veprimin e mësipërm. Mosrespektimi i afatit të përcaktuar për të konfirmuar pjesëmarrjen nga OE i publikuar fitues "A..." ka sjellë që, diferenca midis ofertës së OE "A.M.U" me vlerë 695,400 lekë (pa TVSH)" dhe OE fitues "E..."me vlerë 789,000 lekë (pa TVSH), **konsiderohet dëm në buxhetin e shoqërisë UK Kavajë SHA, në vlerën 93,600 lekë (pa TVSH), dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit e prokurimit për blerje me vlerë të vogël znj.F.Gj, z.M.SH dhe z.E.S.** *(Trajtuar më hollësisht në faqet 40-48, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

3.1Rekomandime: Nga Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, të ndiqen të gjitha hapat ligjore dhe administrative për arkëtimin e **vlerës 93,600 lekë (pa TVSH)** e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA, **dhe duhet të dëmshpërblehet nga anëtarët e komisionit e prokurimit për blerje me vlerë të vogël znj.F.Gj, z.M.SH dhe z.E.S.**

Brenda vitit 2020

D.I <u>MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE</u>.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit publik për vitin 2019, blerje me vlerë të vogël, u konstatua mungesa e plotësimit të kritereve të veçanta të vendosura në DST nga Komisioni i Prokurimit me vlerë të vogël. Mosplotësimi i kritereve të veçanta në procedurat e prokurimit është si më poshtë:

a. Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Kompjuter dhe Printera", konstatohet se likuidimi i mallit është bërë sipas faturës tatimore, Nr. 178, datë 04.03.2019, me vlerë 450,000 lekë (pa TVSH), për llogari të operatorit ekonomik fitues "F...". Magazinimi i mallit ka fletë-hyrje Nr. 33, datë 04.03.2019. Gjithashtu, konstatohet se, në asnjë dokument të marrjes dhe te daljes nga magazina, nuk gjenden të shënuara numrat serial të pajisjeve të përfituara në këtë procedurë, kështu që gjurmimi i tyre bëhet i pa mundur, për rrjedhojë, grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve, veprim në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave, Nr. 30, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Referuar DST, në specifikimet teknike është kërkuar që për mallrat e prokuruara duhet të paraqitet garanci, me afat kohor minimumi 2 vjet, nga OE fitues. Në dosje, gjendet fleta e garancisë e lëshuar nga OE "FASTECH", datë 04.03.2019.Në fletë garanci nuk janë të shënuara Nr. serial i pajisjeve të përfituara nga kjo procedure, si dhe nuk janë përshkruar kushtet e garancisë në rast se do të nevojitet. Për sa më sipër, garancia e ofruar nuk mund të jetë me efikasitet të plotë, në rast të problemeve që mund të kenë pajisjet për periudhën 2 vjeçare. Mosplotësimi i kërkesave të mallit të prokuruar sipas specifikimeve teknike te DST, si edhe mungesa e numrave serial në faturën tatimore dhe në garancinë e paraqitur, **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet, në vlerën 450,000 lekë.**

b. Në DST për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Tuba Uji", është kërkuar që mallrat duhet të shoqërohen me dokumentin teknik përkatës, ndër to edhe:

- Certifikata e origjinës së prodhimit të materialit të PE nga prodhuesi (B, S, B, E ose ekuivalent) e shoqëruar me tipin e materialit, llojin dhe të dhënat teknike.
- Certifikata e testimit të tubave dhe pjesëve speciale nga prodhuesi. Ovaliteti i tubave nuk duhet të jetë me i madh se 1.5 %.

Nga auditimi i dosjes konstatohet se të dy certifikatat e mësipërme mungojnë, kështu që OE "2...", është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Mos shoqërimi i mallit të prokuruar me certifikatat e kërkuara në DST që vërtetojnë plotësimin e specifikimeve teknike sipas standardeve, konsiderohet **shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 695,000 lekë.**

c. Në DST për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Rakorderi" është kërkuar që, mallrat të shoqërohen me dokumentacionin teknik përkatës:

- Certifikata e origjinës së mallit nga prodhuesi i materialeve.
- Certifikata e origjinës së prodhimit të materialit të PE nga prodhuesi (B, S, B, E ose ekuivalent) e shoqëruar me tipin e materialit, llojin dhe të dhënat teknike të përshkruara.

Nga auditimi i dosjes së procedurës së prokurimit, blerje me vlerë te vogël, me objekt "Blerje Rekorderi", konstatohet se certifikata e origjinës së mallit nga prodhuesi i materialeve mungon në dosje, dhe certifikata e origjinës së prodhimit të materialit PE, është në gjuhë të huaj, kështu që, OE " T..." është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Mos shoqërimi i mallit të prokuruar me certifikatat e kërkuara në DST, që vërtetojnë plotësimin e specifikimeve teknike sipas standardeve, konsiderohet **shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 670,000 lekë.**

d. Në dokumentet e procedurës së prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Tonera", është kërkuar që: "Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara se të shpallet fitues, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor (në rastet kur kërkohet), dokumentet si më poshtë:

•Certifikatë qe vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, ISO 9001-2008/ISO 9001-2015.

•Certifikatë OHSAS -18001-2007(ose ekuivalente të vlefshme) për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurimit në punë. Nga auditimi i dosjes, konstatohet se OE i shpallur fitues nuk i plotëson kriteret e mësipërme, kështu që OE "I...", është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Mos shoqërimi i mallit të prokuruar me certifikatat e kërkuara në DST, që vërtetojnë plotësimin e specifikimeve teknike sipas standardeve, **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 660,000 lekë.**

e.Në DST për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Matësa Uji", kërkohen të plotësohen kriteret e më poshtme:

•Vërtetimin se OE i shpallur fitues, duhet të ketë shlyer të gjitha taksat (qendrore dhe vendore) Vërtetim nga OSHEE se objekti nuk ka detyrime të pashlyera.

Matësi i Ujit: (Të ofrojë mundësinë dhe të jete kompatibël me teknologjinë e Leximit Automatik të Matësi), Vulat: (Të kenë logon "Ujësjellës Kanalizime Kavajë", 6 numra serial unik të njëpasnjëshëm në pjesën e përparme të trupit (pjesa femërore). Çelësat e bllokuesve: (Njeri krah i çelësit duhet të jetë i veshur me material plastik ose qeramike).Nga auditimi i dosjes, konstatohet se OE i shpallur fitues, nuk i plotëson kriteret e mësipërme, kështu që OE

"A...", është kualifikuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006,"Për prokurimin publik", i ndryshuar. Mosplotësimi i kërkesave të mallrave (matësa uji, vula dhe çelësave të bllokuesve) të prokuruar sipas specifikimeve teknike të DST,vlera e përfituar, **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 750,000 lekë (pa TVSH).**

f. Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Klor", sipas kualifikimit përfundimtar, dokumentuar me procesverbalin Nr.1 datë 25.07.2019 konstatohet se OE fitues "A..." renditet në vendin e 11 (njëmbëdhjetë). Shpallja fitues i OE "A..." është në kundërshtim me udhëzimin Nr.3, datë 8.01.2018, "Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", ku përcaktohet se: "Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël do të marrë në konsideratë për realizimin e objektit të prokurimit vetëm operatorët ekonomikë të renditur deri në vendin e 10 (dhjetë) të klasifikimit", i ndryshuar. Për sa më sipër kjo procedurë prokurimi duhej të anulohej. Mos anulimi i procedurës së prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Klor" vlera e përfituar nga OE "A...", **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 800,000 lekë (pa TVSH).**

g. Në procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Kaseta Matësash", nga auditimi i sistemit elektronik të APP, në skedarin "Njoftimi i Fituesit", OE "D..." është publikuar fitues në datë 01.07.2019, ora 09:47,sipas procesverbalit Nr.1,datë 01.07.2019, i cili nuk ka konfirmuar pjesëmarrjen, kështu që është kaluar në OE të radhës, por konstatohet se, OE "A..." i renditur në vendin e dytë, është publikuar fitues në datë 01.07.2019, ora 10:09, kjo në kundërshtim me afatin e përcaktuar nga vetë AK në DST. Operatori ekonomik i renditur i pari, duhet të konfirmoje pjesëmarrjen pranë autoritetit kontraktor brenda 2 orëve nga momenti i publikimit njoftimit të fituesit në Sistemin e Prokurimit Elektronik. Gjithashtu, afati i publikimit midis vendit të tretë, të katërt dhe të pestë, si dhe vendit të gjashtë me të shtatë, nuk është respektuar nga AK. Në dosje nuk gjenden gjurmë që justifikojnë këto veprime të komisionit të vlerësimit. Mosrespektimi i afatit të përcaktuar për të konfirmuar pjesëmarrjen nga OE i publikuar fitues "D..." ka sjellë që, diferenca midis ofertës se OE "D..." me vlerë 468,000 lekë (pa TVSH)" dhe OE fitues "A..." me vlerë 749,999 lekë (pa TVSH), **konsiderohet shpenzim i fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën 281,999 lekë.** *(Trajtuar më hollësisht në faqet 40-48, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

1.1Rekomandime:

-Të merren masa për analizimin dhe evidentimin e përgjegjësive për përzgjedhjen e OE fitues, vendimmarrje e cila ka sjellë si pasojë fitues një OE që ka patur mangësi në dokumentacion, që nuk është evidentuar nga ana e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me vlerë të vogël.

Brenda 6 mujorit të parë 2020

1.2Rekomandime:

-Për procedurën e prokurimit, blerje me vlerë të vogël, me objekt "Blerje Kompjuter dhe Printera", AK ti kërkojë OE fitues "F..." të paraqesë një garanci, për mallrat e përfituara, ku të shënohet numri serial për çdo pajisje, gjithashtu kjo garanci të shoqërohet me kushtet e saj.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i proceseve gjyqësore rezulton se për periudhën objekt auditimi, konstatohet një numër i madh procedura gjyqësore e sekuestro konservative bankare të UKKA, si debitore ndaj OSSHE sh.a, Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, Komisionerit për të drejtën e informimit, ERRU dhe punonjësve të larguar nga puna. Gjatë kësaj periudhe, janë larguar nga puna 210 punonjës (*duke përfshirë 79 punonjës së ristrukturimit të datë 02.08.2017)*. Në UKKA SHA, nuk ka një dokumentacion të rregullt për

numrin e saktë të procedurave gjyqësore për procedurat e zhvilluar/përfunduara dhe procedurat në proces (vlerën monetare të likuiduar për secilën procedurë).Vendime e formës së prerë në proceset gjyqësore përgjatë vitit 2018 -2019 për të cilat kërkohet dëmshpërblim kanë **vlerë totale 10,892,567 lekë e cila përbënë efekt negativ financiar për buxhetin e shoqërisë.** Për punonjësit është dhënë masa pushim nga puna si pasojë e thyerjes së disiplinës në punë, për mosparaqitje dhe shpërdorim detyre. Për vitin 2019 nga ana e UKK Sh.a Administratorit të saj janë kryer pushime kolektive nga puna në periudhën Shtator – Dhjetor 2019 ku janë larguar në total 96 veta dhe përkatësisht 21 në Shtator, 27 në Tetor, 22 në Nëntor dhe 26 në Dhjetor. Gjithashtu në vitin 2017 në periudhën Shtator-Nëntor 2017 janë larguar 81 veta nga puna. Nga verifikimi i procedurave për largim nga puna u konstatua se nuk janë zbatuar procedurat e parashikuara nga Kodi i Punës.
Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 "*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*" pika 3, neni 155 dhe neni 148.
2.1Rekomandime: Shoqëria dhe Drejtoria e Financës duhet të marrë masa për shqyrtimin e **efektit financiar** në vlerën totale **10,892,567 lekë**, të ardhur si pasojë e mos-ndjekjes së procedurave ligjore në largimin e punonjësve nga puna, për evidentimin e përgjegjësive, si dhe nga Sektori Juridik të merren masa për ndjekjen e të gjitha çështjeve gjyqësore, në të gjitha shkallët e gjykimit për shmangien e kostove shtese nga proceset gjyqësore në proces të cilat mbartin risk të lartë për efekt negative financiar në të ardhmen. Shoqëria duhet të marrë masa të analizojë në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbarimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

Brenda 6 mujorit të parë 2020

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dhënies së shpërblimeve rezulton se shoqëria edhe pse figuron me humbje gjatë vitit 2018 dhe 2019, përveç se ka punësuar persona mbi strukturë duke i shkaktuar dëme të mëtejshme shoqërisë gjithashtu ka shpërndarë edhe shpërblime për punonjës të saj.Shpërblimet për vitin 2018 kanë vlerë **efekti negativ financiar 130,000 lekë** kurse për vitin 2019 kanë vlerë **efekti negativ financiar 806,088 lekë.** Në rast se shoqëria figuron me humbje nuk shpërndan shpërblim. Gjithashtu nuk ka shpërblim për punë jashtë orarit, siç është shpërblyer E.L. Puna jashtë orarit paguhet sipas Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë dhe pasqyrohet në pagën mujore të personit i cili ka punuar jashtë orari, në referencë të listëprezencës mujore. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", Neni 6 Kompetencat e organeve kolegjiale 1. Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave**,** në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës; b) ***masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor***, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*
3.1Rekomandime: Këshilli i Administrimit dhe Titullari i shoqërisë UKKA SHA, të marrin masa që të rishqyrtojnë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitet 2018 dhe 2019 në vlerën **936,088 lekë**, shpërblime të dhëna pas daljes së rezultatit financiar vjetor negativ, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës për vlerën e mësipërme, e cila përbën **efekt financiar negativ** për Buxhetin e shoqërisë dhe ka rënduar edhe më tepër kostot e shoqërisë në kushtet që ajo figuron me humbje që prej vitit 2015.

Brenda 6 mujorit të parë 2020

D.II <u>DETYRIME NDAJ TË TRETËVE</u>

D.II.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i gjobave dhe kamatvonesat në sistemin tatimor si dhe gjobave kamatvonesat mbi detyrimet e papaguara të energjisë elektrike rezulton se shoqëria UKKA SHA, nga mungesa e likuiditetit dhe keq menaxhimi aktualisht ka **gjoba dhe kamatvonesa në shumën totale 96,096,211 lekë.** Nga auditimi i sistemit tatimor deri në Shkurt 2020, rezultojnë gjoba dhe kamatvonesa **në vlerën 8,637,236 lekë** si gjobë për pagesa të vonuara, nga të cilat 8,305,094 lekë janë gjoba për mospagesa të TVSH në kohë reale, 270,850 lekë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, 40,000 lekë për tatim fitimin dhe 21,292 lekë për tatimin në burim vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar**. Shoqëria nuk është në gjendje të paguajë detyrimet për TVSH, penaliteti i së cilës rritet çdo ditë. Aktualisht interesat e regjistruara në sistemin tatimor janë në shifrën **3,787,461 lekë**, vlerë e cila përbën **efekt negativ financiar** ndër të cilat 3,719,389 janë interesat vetëm për mospagimin në kohë të detyrimit për TVSH dhe 68,072 lekë interesa për pagesa të vonuara të sigurimeve shoqërore dhe tatimit në burim.Shoqëria nuk është në gjendje të paguajë faturat e energjisë elektrike me detyrim principal 173,708,004 lekë dhe gjoba e kamatvonesa në shumën **83,671,514 lekë**, të cilat gjithashtu përbëjnë **efekt negativ financiar.** Penalitetet e mësipërme llogariten sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar, Sanksionet, Neni 114 Mospagimi në afat i detyrimit tatimor apo i kontributit.

D.II Rekomandime: Shoqëria, Këshilli i Administrimit dhe Drejtoria e Financës të marrë masa dhe të kryejë në mënyrë më efiçente menaxhimin e veprimtarisë së përditshme si dhe të shqyrtojë efektin negativ nga gjobat dhe kamatvonesat në shumën **96,096,211 lekë.** Shoqëria UKKA SHA , të marrë masa për uljen e numrit të punonjësve që ka mbi mbi strukturë, të punësojë punonjës të kualifikuar, të konsiderojë ndryshimin e politikave tregtare dhe të menaxhojë me efektivitet asetet për rritjen e rentabilitetin të shoqërisë.*(Trajtuar më hollësisht në faqet 10-28, të Raportit Përfundimtar të auditimit)*

Brenda 6 mujorit të parë 2020

E. MASA DISIPLINORE

Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas personave përgjegjës i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit si dhe Administratorit të Shoqërisë, që mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme të Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA si dhe në Kontratën Individuale të Punës ,të marrë masat disiplinore si më poshtë:

I. Nga "Vërejtje" deri në "Paralajmërim për ndërprerje të kontratës së punës", për:

1.znj. F.Gj, aktualisht me detyrë Drejtore e Shitjes dhe Ish Drejtore Tregtare në UKKA SHA, për periudhën objekt auditimi 2018 – 2019:

- Për moszbatim të VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" neni 13, pika 3 (germa ë), neni 18, pika 7 (germa ç, dh dhe i), dhe nenin 20, pika 2 c, ç, dhe d); Rregullores së brendshme të Ujësjellësit Kavajë SHA ,: pjeset - "Miratimi i Programit te Zhvillimit; ligjit nr. 25 dt. 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe

pasqyrat financiare" Nenin 17 i (Raporti i ecurisë së veprimtarisë), pikat 1, 2; lidhur me planifikimin dhe zbatimin e programit ekonomik.

- Për mos hartimin nga Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë, të programeve afatmesme dhe afatgjata, të planeve 5-vjeçar për përmirësimin e performancës dhe plan të biznesit, nevojave për të ardhura dhe analiza e tarifave/strategjitë e çmimeve në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës – Kanalizime; si edhe të planit të buxhetit për shoqërinë për vitet 2018 dhe 2019; mos zhvillimin e analizave të realizimit të planit ekonomik. (Shih trajtimin ne Raportin Përfundimtar të Auditimit nga faqe 8 ne faqe 10)
- Për moszbatim të ligjit nr.9228,datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, udhëzimin nr.14 date 28.12.2006 , i ndryshuar me urdhrin nr.26 datë 27.12.2007 ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, neni 33/1"; Udhëzimi nr. 30 dt. 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, lidhur me mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin e pasqyrave financiare, etj.
- Për mos hartimin dhe mosdorëzimin e pasqyrave financiare brenda afatit, mos kuadrimin e zërave të kontabilitetit me pasqyrat financiare dhe mos pranimi i bilancit të veprimtarisë për vitin 2018 nga dega e thesarit Kavajë; mos kontabilizimin e zvogëlimit të kapitalit nga shoqëria UK. Kavajë SHA, sipas detyrës së lënë nga ekspertët kontabël.
- Për mosrakordim në bilanc i veprimeve me arkë dhe bankë dhe me faturimet ndaj klientëve; mos rakordimin e llogarisë "Hua Bankare", si dhe moskryerje të analizës së llogarive; moskuadrimi i debitorëve dhe kreditorëve midis degës shitjes dhe degës së financës për vitin 2018.
- Mosllogaritjen e amortizimit të aktiveve afatgjata materiale (Ndërtesa, Impiantë, Makineri Pajisje, Mjete Transporti); moskryerjen e inventareve fizike vjetore të aktiveve Shoqërisë.(trajtuar më hollësisht ne faqe 31 dhe faqe 39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
- Në cilësinë e anëtares së komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, për zbatimin e procedurave, blerje me vlerë të vogël për vitin 2018-2019 në kundërshtim me, Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar, Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", dhe në Rregulloren "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH", Udhëzimi e Ministrisë së Financave Nr.30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"(trajtuar më hollësisht në faqe 40-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
- Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit të mbajtura nga përgjegjësja e shpërndarjes së karburantit znj. F.Gj për periudhën 21.07.2019- 31.08.2019,u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30,datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kapitulli III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" Dokumentimi i lëvizjeve pikat 34, 35/b, 38 dhe 39. "(trajtuar më hollësisht në faqe 28-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.z.M.Sh, me detyrë Kryeinxhinier në UKKA SHA :

- Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit të mbajtura nga përgjegjësi i shpërndarjes së karburantit z.M.Sh për periudhën 21.08.2019-31.12.2019, u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30,datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kapitulli III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" Dokumentimi i lëvizjeve pikat 34, 35/b, 38 dhe 39. "(trajtuar më hollësisht në faqe 28-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)
- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla të realizuara në vitin 2019, për zbatimin e procedurave, blerje me vlerë të vogël për vitin 2018-2019 në kundërshtim me, Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar, Ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", dhe në Rregulloren "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH", Udhëzimi e Ministrisë së Financave Nr.30 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"(trajtuar më hollësisht në faqe 40-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në Akt Konstatimin Nr.5, datë 21.02.2020)
- Furnizimi i popullatës me ujë të pijshëm jo me cilësi sipas stadardeve të kërkuara, largimi dhe përpunimi i ujërave të ndotura jo sipas normave të lejuara të shkarkimeve në mjedisin pritës si dhe mos licensimi i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kavajë sipas legjislacionit në fuqi për periudhën e audituar, në kundërshtim me Ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit te pijshëm" ,Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligji nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr.177, dt. 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse", Direktiva e Bashkimit Evropian 91/271/EEC(trajtuar më hollësisht në faqet 54-58 të Raportit Përfundimtar dhe Aktkonstatimit nr.13, datë 21.02.2020).

3. z.N.C me detyrë Magazinier në UKKA SHA;

-Nga auditimi i dokumentacionit për mbajtjen e karburantit të mbajtura nga Magazinieri i UKKA SHA për periudhën 01.012018-31.12.2019, u konstatua se në çdo praktikë të tërheqjes së karburantit nga magazina e UK Kavajë SHA, nuk argumentohet sasia e karburantit të tërhequr nga magazina, nuk ka të bashkëlidhur një urdhër shërbimi për çdo mjet, nuk ka fletë udhëtimi, as programin e punës, në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" si dhe me udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30,datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kapitulli III "Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre" Dokumentimi i lëvizjeve pikat 34, 35/b, 38 dhe 39. "(trajtuar më hollësisht në faqet 28-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

II. Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas personave përgjegjës i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit si dhe Administratorit tëShoqërisë, që mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i

ndryshuar, Rregulloren e Brendshme të Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA si dhe në Kontratën Individuale të Punës ,të marrë masat disiplinore si më poshtë, për anëtarët e njësive të prokurimit , komisioneve të vlerësimit të ofertave, komisioneve të prokurimit me vlerë të vogël për procedurat e prokurimit të realizuara në vitin 2018 dhe vitin 2019, sipas shkallës së përgjegjësisë dhe procedurave në të cilat janë konstatuar me mangësi dhe shkelje :

"Vërejtje" për:

1. z.R.M
2. z.G.Xh
3. z.E.T
4. znj.A.Y
5. znj.J.Gj
6. z.E.S
7. z.M. M
8. znj.E.Gj
9. z.S.K
10. z.Xh.A
11.znj.B.X
12.zB.D
13.znj.E.S
14.z.R.V

-Në 3 procedura prokurimi për vitin 2018 në vlerën 8,828,939 lekë dhe 1 procedurë për vitin 2019 në vlerën 4,299,900 lekë, nuk ka gjurmë të studimit të tregut, referim të kontratave të ngjashme, apo të dhëna referuar INSTAT, për të bërë të qartë mënyrën e përllogaritjes së fondit limit të kësaj procedurë, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", i ndryshuar, neni 59 "Përllogaritja e vlerës limit të kontratës".

-Për 1 procedurë prokurimi për vitin 2019 "Blerje Karburanti" me vlerë 4,299,900 lekë në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk është përcaktuar kufiri për marzhin e fitimit dhe nuk ka asnjë dokument që argumenton mungesën e përcaktimit të këtij elementi në DST, i cili shërben si kufi për të mbajtur një çmim të arsyeshëm dhe me ekonomicitet për shoqërinë duke minimizuar kostot e panevojshme. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar.

-Në procedurën e prokurimit në vlerën, 2,954,789 lekë "Blerje Karburanti" për vitin 2018, referuar sistemit elektronik të APP, në skedarin e vlerësimit është konstatuar se dy nga anëtarët e KVO-së, nuk e kanë kualifikuar operatorin ekonomik A...sh.p.k, megjithatë në kualifikimin përfundimtar ky operator është shpallur fitues i kësaj procedure. Në dosjen shkresore të prokurimit nuk gjendet asnjë gjurmë e cila justifikon kualifikimin e këtij operatori të shpallur fitues, gjithashtu KVO nuk ka dokumentuar me raport përmbledhës të nënshkruar nga çdo anëtar i KVO, vazhdimin e procedurës për miratim nga titullari i AK. Përsa më sipër kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Ligjin 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave.

-Ne 7 procedura me blerje të vogël për vitin 2018 në vlerën 5,031,500 lekë dhe 10 procedura me blerje të vogël për vitin 2019 në vlerën 6,488,499 lekë , në të gjitha rastet e blerjes së mallrave dhe shërbimeve të planifikuara dhe jo të planifikuara , u konstatua se kërkesa e bërë për mallin apo shërbimin ishte formale pa argumentin e nevojës së kryerjes së shpenzimit dhe

ku shpesh here kjo kërkesë nuk kishte konfirmimin e magazinierit. Gjithashtu marrja në dorëzim e mallrave referuar procedurave me blerje me vlerë të vogël konfirmonte thjesht marrjen në dorëzim (konfirmim që e bën dhe magazine me fletë hyrjen e mbajtur) dhe jo marrjen në dorëzim konform specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë.

- Në të gjitha procedurat e prokurimit dhe procedurat e prokurimit me blerje të vogël për periudhën 2018-2019, dosjet e vëna në dispozicion të grupit të auditimit janë të pasakta nga ana e rregullave të arkivimit, kjo në kundërshtim me ligjin Nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", dhe në Rregulloren "Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH", neni 13.
- Në të gjitha procedurat e prokurimit dhe procedurat e prokurimit me blerje të vogël për periudhën 2018-2019, dosjet e vëna në dispozicion të grupit të auditimit nuk gjenden deklaratat e konfliktit të interesit të nënshkruara nga anëtaret e komisioni të prokurimit me vlerë të vogël, në kundërshtim me, VKM Nr. 914, date, 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 11.
-Në të gjitha procedurat e prokurimit, blerje me vlerë të vogël për periudhën 2018-2019, janë pasqyruar dhe kanë kryer veprime në sistemin elektronik APP, "Njësi Prokurimi" dhe "Komision Vlerësimi të Ofertave", në kundërshtim me Udhëzimin nr.3, datë 08.01.2018 "Për përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël", i ndryshuar.
- Në 7 procedura prokurimi për vitin 2018, blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 5,031,500 lekë (pa TVSH) dhe në 7 procedura prokurimi për vitin 2019 , blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 5,586,925 lekë (pa TVSH), konstatohet se: Znj. F.Gj me detyrë Drejtor Tregtar i Shoqërisë UKK është njëkohësisht edhe kryetare komisioni e blerjes me vlerë të vogël, në kundërshtim me ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, neni 22, pika 5.
- Në 1 procedurë prokurimi për vitin 2019 , blerje me vlerë të vogël, me vlerë të prokuruar 800,000 lekë (pa TVSH), specifikimet teknike (vizatimet) janë në gjuhë të huaj, në kundërshtim me VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 14, pika 2, paragrafi 3.
- Autoriteti Kontraktor Shoqëria Ujësjellës Kanalizime Kavajë sh.a për periudhën objekt auditimi viti 2018 dhe viti 2019, për çdo artikull mallrash të blerë nën vlerën 100.000 lekë (rreth 234 urdhra prokurimi), ka përdorur ligjin e prokurimit publik pavarësisht vlerës së mallit duke i trajtuar si blerje emergjente të cilat nuk i ka pasqyruar as në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike dhe nga mungesa e një plani ekonomik të detajuar sipas nevojave të çdo sektori, ka vepruar në kundërshtim me VKM nr.914 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, pika 2,paragrafi 2 ku thotë në mënyrë eksplicite": "Për prokurimet, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, është nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 800 000 (tetëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor mund të përdorë procedurën për prokurim me vlerë të vogël, siç përshkruhet në nenin 40 të këtyre rregullave. Për objektet, ku përfshihen mallra dhe shërbime të ngjashme, vlera e përllogaritur e të cilave, brenda një viti kalendarik, nuk është më e madhe se 100 000 (njëqind mijë) lekë, autoriteti kontraktor nuk i nënshtrohet procedurave të prokurimit. Në çdo rast, pavarësisht nga fakti që nuk do të prokurohen, planifikimi i këtyre objekteve dhe vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen respektivisht në regjistrin e parashikimeve dhe në regjistrin e realizimeve të procedurave të prokurimit publik. Pagesat për këto objekte bëhen sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe faturat e lëshuara në këto raste kanë vlerën e kontratës së lidhur, kur palët nuk kanë nënshkruar një të tillë". (Trajtuar më hollësisht në raportin përfundimtar në faqet 40-48 dhe në aktkonstatimet nr.4, nr.5, nr.7, nr.8, nr.9, nr.10, datë 21.02.2020)

III.Për shkeljet e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, sipas personave përgjegjës i propozojmë Asamblesë së Përgjithshme, Këshillit të Administrimit si dhe Administratorit tëShoqërisë, që mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, Rregulloren e Brendshme të Ujësjellës Kanalizime Kavajë SHA si dhe në Kontratën Individuale të Punës ,të marrë masat disiplinore:

"Vërejtje" për:

1.z.R.V
2.z.G. Xh
3.z.I. K
4.z.S.P
5.z.F.Gj
6.A.D
7.z.I.K
8.znj.J.Gj

-Për furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm jo me cilësi sipas stadardeve të kërkuara, largimi dhe përpunimi i ujërave të ndotura jo sipas normave të lejuara të shkarkimeve në mjedisin pritës si dhe mos licensimi i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Kavajë sipas legjislacionit në fuqi për periudhën e audituar në kundërshtim me ligjin nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 379, datë 25.05.2016 "Për miratimin e rregullores cilësia e ujit te pijshëm", Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligji nr. 10 431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", VKM Nr.177, dt. 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse", Direktiva e Bashkimit Evropian 91/271/EEC.(Trajtuar më hollësisht në faqet 53-58 të raportit përfundimtar).

I.V Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional

a.Për ish drejtuesit për të cilët nuk kemi adresim institucional për marrëdhënie pune në administratën publike, masa disiplinore e propozuar nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar do të ishte "Ndërprerje e Marrëdhenieve të punës", sipas shkallës së përgjegjësisë dhe konkretisht për dyfishimin e numrit të punonjësve të UKKA SHA (për periudhën Gusht-Dhjetor 2019), për shkak se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Kavajë SH.A dhe për pasojë masa disiplinore ndaj tij quhet e ezauruar, përkatësisht për:

1.z.B.T , ish Administrator i UKKA SHA

b.Për ish punonjësit për të cilët nuk kemi adresim institucional për marrëdhënie pune në administratën publike, masa disiplinore e propozuar nga ana jonë, në bazë të shkeljeve të konstatuara në raportin përfundimtar do të ishte "Vërejtje me paralajmërim" deri në "Ulje në Detyrë",sipas shkallës së përgjegjësisë, për shkak se kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Kavajë SH.A dhe për pasojë masa disiplinore ndaj tyre quhet e ezauruar, përkatësisht për:

1.z.H.T , ish Administrator i UKKA SHA
2.z.E.D, ish Administrator i UKKA SHA
3.znj.R.K, ish Drejtoreshë Juridike në UKKA SHA
4.znj.B.X, ish Drejtoreshe Tregtare në UKKA SHA

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200[1]) e shpenzimeve:

Opinion i kundërt [3].

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret që lidhen me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura dhe menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë, i mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë rezultuan mospërputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret) të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të kundërt.

Nga auditimi i përputhshmërinë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi të shoqëruara me një dëm të mundshëm ekonomik në vlerën 8,183,337 lekë, dhe efekte negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike në vlerën 205,216,066 lekë.

Baza për opinionin e përputhshmërisë.
Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë". Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.208, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit,
Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të kundërt.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të UKKA-së:

[3] *Sipas Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, kapitulli V, pika 5.4,* ***Konkluzionet/ opinionet e kundërta****: Kur audituesit konkludojnë se ka devijime materiale, opinioni i shprehur është ose i kundërt (N.q.s. devijimet janë materiale dhe të përhapura):*
Audituesi shpreh një konkluzion të kundërt kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, janë materiale sa që të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.

Drejtimi "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë është përgjegjës për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria e subjektit.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Konkluzion:

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) dhe rregullshmërisësë KLSH-së, i kryer në subjektin -Shoqëria "Ujësjellës Kanalizime" Sh.a Kavajë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënie e ***opinionit të kundërt.***

1. ISSAI 4100 – *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.*

2. ISSAI 4200 - *Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.*

3*. Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së".*

Shkurtime

KLSH	Kontrolli I Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NJP	Njësia e Prokurimit
AK	Autoriteti Kontraktor
DT	Dokumentet e Tenderit
LPP	Ligji prokurimit publik
RRPP	Rregullat e prokurimit publik
SKK	Standarte Kombëtare Kontabiliteti

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Anekset:

Aktkonstatim nr.1 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.2 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.3 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.4 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.5 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.6 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.7 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.8 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.9 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.10 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.11 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.12 datë 21.02.2020
Aktkonstatim nr.13 datë 21.02.2020

Shënim :*Aktkonstatimet sa më sipër, janë protokolluar në UK Kavajë më datë 21.02.2020.*